



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 17
QERSHOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
17. JUNA 2010. GODINE**

**QERSHOR -JUNI
2010**

E enjte, 17 qershor 2010, ora 10:00

Drejtton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se seancat fillojnë në orën 10:00 dhe debatet e lira të deputetëve janë deri në 10:30.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në bazë të nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar deri në 5 minuta, diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta.

Në bazë të nenit 47.3, deputetëve të lajmëruar dhe të cilët kanë mbetur pa diskutuar, u jepet fjala në fillim të mbledhjes plenare të radhës.

Nga seanca e kaluar kanë mbetur pa diskutuar këta deputetët: Riza Smaka dhe Gjylnaze Sylja. Nuk janë asnjëri. Vazhdojmë.

Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komuniteti egjiptas i Kosovës është pjesë e rëndësishme e shoqërisë kosovare, të cilët po bëjnë përpjekje që ta zënë vendin meritore në shoqërinë e Kosovës. Edhe pjesëtarët e këtij komuniteti janë konsumatorë të shërbimeve që i afrojnë PTK-ja, KEK-u dhe ndërmarrjet tjera publike. Fakti se prej 3000 të punësuarve në PTK dhe 7600 të punësuarve në KEK, asnjëri prej tyre nuk i takon komunitetit egjiptas, nuk është e drejtë dhe e pranueshme. Ky fakt nuk është pasojë se nuk kemi njerëz të kualifikuar ose nuk kemi pasur interesim për punësim në këto ndërmarrje, por për faktin se jemi të anashkaluar. Unë mund t'ju siguroj juve se më dhjetëra herë në PTK dhe në KEK kanë aplikuar njerëz të kualifikuar, me përgatitje superiore, pra, njerëz që kanë përfunduar universitetin aty ku e kanë përfunduar edhe kolegët e tyre shqiptarë dhe gjithmonë janë anashkaluar. Unë ju siguroj juve se nga radhët e komunitetit egjiptas kemi mjaftë inxhinierë, ekonomistë, juristë të kualifikuar dhe shumë, me qindra me shkollë të mesme që mund ta ushtrojnë profesionin e postierit dhe të inkasantëve të rrymës.

Punësimi i 5 deri 10 pjesëtarëve nga radhët e komunitetit egjiptas në PTK dhe KEK dhe në ndërmarrje tjera publike, veçanërisht të atyre me përgatitje superiore, nuk do të zbusë papunësinë shumë të shprehur në radhët e komunitetit, por ne si komunitet do të ndiheshim më të integruar, ku edhe pjesëtarët e komunitetit të jemi pjesë e stafit të ndërmarrjeve publike dhe se nuk do të ndihemi vetëm si ofrues të shërbimeve, por do të ndiheshim si pjesë e këtyre ndërmarrjeve publike.

Pjesëmarrja e komuniteteve pakicë në ndërmarrje publike është e garantuar edhe me ligj, është aneksi i dy të tretave të komuniteteve dhe neni 4.4.4 Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e drejtave të komuniteteve. Unë si përfaqësues legjitim i komunitetit egjiptas, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke qenë mjaftë i shqetësuar për këtë fakt, kërkoj nga Qeveria që këto çështje të trajtohen në radhë të parë si çështje humanitare e pastaj edhe obligim ligjor. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në marrëveshje me ju, për të mos u futur më vonë si informatë, ashtu jemi marrë vesh që vetëm t'ju informoj që prej sot Grupit Parlamentar të LDK-së i bashkëngjitet zoti Adem Salihaj dhe njëkohësisht është i propozuar nga grupi ynë në dy komisione, në Komisionin për Tregti, Industri dhe Telekomunikacion dhe në Komisionin për Mbikëqyrje të FSK-së, vetëm si informatë që mos ta lëmë më vonë, për shkak të procedurave. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ismail Kurteshi.

ISMAIL KURTESHI: Kabinet qeveritar,

Zonja dhe zotëri deputetë,

Kur Serbia i shpalli zgjedhjet lokale në Mitrovicë dhe Artanë e në fushatë vinin pa kërkuar leje politikanë, si radikali Tomisllav Nikoliq, të përcjellë nga eskorta e armatosur, e pastaj edhe në ditën e zgjedhjeve të organizuara nga Serbia, më 30 maj, as EULEX-i e as institucionet vendore nuk ndërmorën asnjë veprim konkret për ta penguar këtë akt kundërkushtetues që cenoi rëndë sovranitetin e vendit. Me atë rast zoti Piter Feit pat deklaruar se është kundër zgjedhjeve në veri të Kosovës, por mbajtjen e tyre nuk do ta pengojë. Kurse Qeveria e Kosovës deklaroi se koncepti demokratik i qeverisjes përjashton përdorimin e forcës.

Por, më 12 qershor Organizata Ndërkombëtare Human Rights Watch ka konstatuar se Policia e Kosovës ka përdorur forcë të tepruar gjatë operacionit të porositur nga gjykatësit e EULEX-it, me rastin e arrestimit të Albin Kurtit.

Zotërinj të nderuar,

Unë nuk po e kuptoj se a ka ndryshuar në parim koncepti demokratik që përjashton përdorimin e forcës apo ky koncept po ndërrohet nga rasti në rast dhe kështu po hiqet dorë nga parimi bazë i Kushtetutës së Kosovës mbi trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Sido që të jetë, është shqetësues fakti se në vendin tonë po tolerohen veprime antikushtetuese e në të njëjtën kohë po dënohen veprime që lejohen në çdo vend demokratik. Unë jam i sigurt se kështu nuk jetësohet slogani aq shumë i përsëritur, “askush mbi ligjin” që garanton funksionim të shtetit ligjor, aq shumë të nevojshëm për ne. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Fabrika e llamarinës së zinkuar “Llamkos“ është privatizuar me metodën e spinoffit special, në vitin 2004, nga një kompani bullgare, e cila e aktivizoi këtë fabrikë dhe punoi me sukses katër vjet me radhë, por që dy vjet kjo fabrikë e ka ndërprerë prodhimin plotësisht, ndërsa punëtorët e saj kanë mbetur pa paga. Me këto ndodhi veç jemi njoftuar vazhdimisht. Pas dështimit të spinoffit special, në këtë fabrikë, megjithatë ekzistonin ende shpresa dhe kjo ishte në privatizimin e serishëm të kësaj fabrike, derisa për këtë fabrikë vazhdimisht ka pasur të interesuar për të blerë atë.

Nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit jemi të informuar se 10 ofertues kishin shprehur interesimin e tyre për ta blerë këtë fabrikë, mirëpo, javën e fundit kur pritej të hapeshin ofertat, investitorët u larguan të gjithë. Tani pyetja është: Çka po ndodh me “Llamkosin”, gjithë ai numër i interesuarve përnjëherë u tërhoqën nga gara? Zyrtarët e AKP thonë se “Llamkosi” tani ndodhet në fazën e

arbitrazhit rreth pretendimeve të kreditorëve tjerë dhe kur e dimë që investitorët, natyrisht që nuk dëshirojnë të kenë probleme me blerësit e mëhershëm, atëherë AKP-ja as që është dashur të shpallë tenderin pa i qartësuar mirë raportet e saj me ish- blerësin. E gjithë kjo vetëm sa e ka dëmtuar imazhin e “Llamkosit” dhe largimin e investitorëve nga “Llamkosi”, edhe pse për të ishin të interesuara kompanitë me renome botërore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryetar!

Pata kënaqësinë të shpreh sot, me rastin e dy -vjëtorit të hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si shtet i pavarur dhe sovran, të shpreh kënaqësinë time edhe si deputet që kjo kushtetutë, me gjithë problemet e shumta, dëshmoi për dy vjet se është në gjendje të menaxhohet me njerëz të institucioneve dhe institucionet e Kosovës, pavarësisht se pozita e asaj është shumë e vështirë në pjesë të cilat e kanë përcjellë që nga fillimi Kosovën si shtet. Me këtë rast dua të them se Kushtetuta e Republikës së Kosovës për dy vjet arriti që në gjirin e vet përmes institucioneve të saj të fuste në koordinim edhe pakicën serbe, e cila realisht e pranon Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Dhe më lejoni ta them momentin e tretë, se tri vjet pas themelimit të çdo kushtetute është një traditë që ato të rishqyrtohen. Besoj që edhe në vitin e tretë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka një hapësirë të mjaftueshme për ta shikuar amendamentimin e saj në pjesët ku Kosova çkyçet përfundimisht nga si shtet i mbikëqyrur, por të jetë si shtet plotësisht i pavarur dhe sovran. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në pasditen e ditës së martë, të datës 15 qershor 2010, u shua tragjikisht jeta e korifeut të artit kinematografik në përmasa botërore, Bekim Fehmiut. U shua jeta e ikonës së kinematografisë të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar në gjithë Evropën Juglindore. Pa diskutim që lajmi i hidhur i këtij kolosi për vdekjen e tij, pra, ngriu buzëqeshjen në buzë të komunitetit artistik gjithë andej rruzullit botëror dhe sidomos goditi bashkëkombësit e tij.

Bekim Fehmiu, aktori që arriti të shkelë deri në Hollivudin e famshëm, ka qenë dhe do të jetë akoma më gjatë për një kohë njeri i papërsëritshëm sa i përket artit kinematografik. Luajti në mbi 40 filma të metrazhit të gjatë dhe la qindra role tjera në teatro. Luajti përkrah aktorëve me renome botërore si Ava Gardner, Robert Shou, Irene Papas, Klaudia Kardinale e të tjerë. Vdiq në mënyrën më tragjike, i vetmuar në muajt e fundit të jetës së tij, i sëmurë rënd. Jeto i vetmuar, siç kanë jetuar zotat në maje të Olimpët.

Do të ishte shumë krenare për këtë Kuvend dhe shumë e ndershme që të mbante një minutë heshtje për vdekjen e aktorit të madh, i propozoj Kryesisë së Kuvendit dhe kryetarit të Kuvendit. Njëkohësisht, propozoj që ditën e varrimit të tij, siç e la amanet ai, që në Lumbardhë t'i hidhet trupi i tij, në Lumbardhin e Prizrenit, të shpallë presidenti i shtetit ditë zije, këtë ditë për vdekjen e aktorit të madh. Njëkohësisht, propozoj që presidenti i shtetit ta dekorojë me çmimin më të lartë për kontributin e tij në fushën e kinematografisë botërore.

Është e domosdoshme, zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë, që politika një herë e mirë të mësohet dhe mos t'i shoh me syrin e politikës njerëzit e mëdhenj që i bënë nder kombit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Se u intrigova pakës këtu dhe mbeta gati pa filluar. Ajo që duhet të flasim sot është për të vazhduar aty ku e ka lënë deputetja Gjylnaze Sylja, javën e kaluar. Realisht, ka qenë duke folur në emër të Grupit, por nuk i është lejuar dhe është tepër e qartë që kur vetëm një deputet prej grupit e kërkon fjalën, atëherë flet në emër të grupit, se s'ka qysh të jetë ndryshe. Edhe tjetra është që nuk besoj që ndokush ka dilemë që Gjylnaze Sylja flet në emër të Grupit të AAK-së, nuk ka në emër të kujt të flasë tjetër.

Po vazhdoj vetëm aty ku ka mbetur deputetja Sylja, tema është te thyerja e Kushtetutës për rindërtimin e "Rilindjes". Është thënë edhe në Raportin e progresit dy viteve më përpara, se gjatë rishikimit të buxhetit në vitin 2008, i është ndarë shuma për renovim të "Rilindjes" kontraktin përkundër faktit që Kuvendi i Kosovës ka votuar kundër, tani ky është vetëm një aspekt i kësaj çështje.

Aspekti tjetër i cili është tepër me rëndësi është se "Rilindja" ka filluar të rindërtohet me pretekstin e nxjerrjes së institucioneve të Kosovës nga objektet me qira, do të thotë, ka premtuar kryeministri i Kosovës se nuk do të ketë me institucione në objekte me qira. Çka na del tash është se edhe për "Rilindje" institucionet e Kosovës paguajnë qira. Mendoj se duhet për ta përsëritur, edhe një herë të themi që edhe për "Rilindje" institucionet e Kosovës paguajnë qira, që do të thotë krejt ajo çka kemi folur ne si opozitë në atë kohë qëndron edhe krejt çka ka thënë Qeveria, nuk qëndron. Kjo ka qenë ajo për të cilën ka filluar të flasë deputetja Sylja edhe është ndërprerë edhe mendoj se kryetari i Kuvendi, me plotë të drejtë shpeshherë e zgjat kohën e fjalës për deputetë për një ose dy minuta edhe zgjatja e kohës e ka qëllimin që deputeti i cili po flet, të arrijë ta përfundojë atë që ka filluar ta thotë, që ndoshta nuk ka pasur elokuencë të mjaftueshme për një moment të caktuar dhe e ka zgjatur më tepër fjalën se që duhet. Edhe mendoj se ka qenë krejt në rregull, përpos se ajo ka folur në emër të Grupit që edhe t'i lejohet që ta përfundojë mendimin e vet. Në fund të fundit, në demokraci edhe nëse nuk na pëlqen ajo çka e thotë opONENTI, rregulla bazë ose esenca bazë, baza e krejt kësaj pune është për të pasur guxim për ta dëgjuar edhe atë që thotë diçka që s'na pëlqen. Edhe mund të them që fillimi i fundit i një sistemi demokratik kishte për të ardhur në momentin kur dikush për shkak të fuqisë momentale provon t'ia ndalë fjalën dikujt që flet diçka që atij s'i pëlqen. Nuk kemi mbërri deri aty, nuk po dua të aludoj, por po them se nëse i ndalet fjala dikujt vetëm për shkak se nuk i pëlqen ajo që po thotë, atëherë kemi të bëjmë me një veprim antidemokratik. Mendoj se gjithë ne duhet pasur kujdes për të mos arritur aty.

Çështja e fundit është se është e vërtetë që ne thirrmi në Rregullore, po prapëseprapë demokracia nuk është vetëm rregullore, është edhe sjellje jona. Ne krijojmë shtigje kur flasim këtu në Kuvend të Kosovës, shtigje të cilat dikush tjetër mundet t'i ndekë po të njëjtat. Mendoj se nuk na duhet në asnjë mënyrë të krijojmë shtigje të cilat ndoshta për pak muaj dikush tjetër në vend tuajin ka për ta lexuar njëjtë, zoti kryetar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sa për sqarim, deputet i nderuar,

Deputetja ka qenë e lajmëruar në seancën e kaluar si deputete. Në seancën e kaluar nuk ka qenë e lajmëruar në emër të Grupit. Po të ishte lajmëruar me kohë në emër të Grupit, mua s'më pengon jo vetëm ta dëgjoj mendimin e kundërt, por edhe atëherë vërtet kur deputetja ose deputeti s'është hiq në të. Kështu që nuk ka problem për ta dëgjuar edhe mendimin e kundërt edhe kur s'ia qëllon, por realisht ka qenë mbetje nga seanca e mëparshme. Prandaj, kur të doni, në emër të Grupit çdo seancë 5 minuta i ke Ardian Gjini.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë dua sot ta ngre një çështje që ishte premtim po edhe vendim i Qeverisë lidhur me ndërprerjen e pagave të profesorëve të Universitetit që kanë kaluar moshën e pensionit. Konkretisht ministri i Arsimit është këtu. Zoti ministër, ka qenë edhe premtim elektorale, por edhe vendim institucional dhe unë konsideroj që nuk është ndonjë ngarkesë e madhe buxhetore për Qeverinë që ata njerëz që kanë kontribuar me vite dhe në fakultete të caktuara janë kuadro deficitarë, sepse ose kanë arritur nivele asistentësh apo edhe profesorë të asocijuar, që nuk po mund t'i mbulojnë lëndët në katedrat e caktuara të disa fakulteteve. Andaj është mirë, pasi që është premtuar dhe është marrë një vendim, që ata njerëz të futen në listën e pagave, sepse konsideroj që është legjitime, është e drejtë edhe është humane. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë detyrohem t'ua lexoj nenin 47 të Rregullores, pikën e parë. “Në fillim të mbledhjes para miratimit të rendit të ditës, pasi të kenë njoftuar kryetarin e Kuvendit, deputetët përkatësisht grupet parlamentare mund të diskutojnë për çështje të ndryshme që konsiderojnë se duhet të bëhen publike në mbledhjen plenare. Në këtë rast, një deputet nuk mund të flasë më shumë se 3 minuta, ndërsa diskutuesi në emër të grupit parlamentar mund të flasë deri në 5 minuta. E lexova këtë për t'u treguar se deputeti që na kritikoi për seancën e kaluar, s'ka të drejtë.

Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

Ka kohë që në opinion flitet për fillimin e negociatave me Serbinë. Dikush, si bie fjala Qeveria, këto negociata parapëlqen t'i quajë bisedime, kurse disa të tjerë i quajnë rinegociata. Qeveria i quan bisedime për çështje teknike, kurse disa të tjerë shprehin dyshime se këto bisedime nuk do të jenë teknike, por politike, pra do të jenë negociata të reja apo rinegociata për statusin politik dhe integritetin territorial. Në këtë kontekst shumë kosovarë besojnë se këto bisedime janë në kuadër të 6 pikave të Ban Ki Munit, të cilat sipas tyre tashmë ka kohë që po implementohen në Kosovë. Këtij qëndrimi po i kontribuojnë goxha shumë edhe përfaqësuesit ndërkombëtarë, si bie fjala ambasadori Gilfoni, i cili kohë më parë pati deklaruar se ne do të bashkëpunojmë me secilin në veri, duke aluduar edhe në udhëheqësit e strukturave ilegale. Andaj, unë do ta pyesja Qeverinë të na shpjegojë se çka janë ato çështje teknike për të cilat niveli më i lartë strategjik qeveritar, pra kryeministri apo presidenti i Kosovës dhe kryeministri apo presidenti i Serbisë do të mund të bisedojnë, sepse kjo shumë kosovarëve u intereson. T'ju them të drejtën, e nderuara Qeveri, unë duke pasur parasysh këtë drojë reale të qytetarëve të Kosovës, më 4 dhjetor të vitit 2008, e keni në transkript, në faqen 8 dhe 9, zotit kryeministër i pata bërë një pyetje, ai në atë seancë, ndër të tjera, më pati rekomanduar që të mos ndikohemi nga deklaratat e Jeremiqit apo, siç pati thanë, po e citoj: “Dëshiroj t'ju ftoj sinjerisht të mos ndikoheni nga deklaratat e Jeremiqit dhe askujt tjetër”, pastaj pati vazhduar në faqe 9, me ” të mos ndikoheni nga shtypi i Beogradit, të mos ndikoheni nga deklaratimet e Beogradit, të mos frustroheni prej kërcënimeve dhe mesazheve frikësuese të Jeremiqit”, për të përfunduar me “Beogradi gënjen, gënjen dhe gënjen gjithmonë për Kosovën dhe 6 pikshin e Ban Ki Munit e shpalli të vdekur”. Por, tash po shihet se megjithatë Beogradi nuk e paska pasur edhe krejt këtë çështjen e rinegociatave apo bisedimeve apo të 6 pikëshit. Me fjalë të tjera, po ta shikosh hollë e hollë, Beogradi nuk paska gënjyer bash, bash.

Madje edhe mediat e afërta me Qeverinë tashti faqet e para i stolisin me artikuj si Hashim Thaçi dhe Boris Tadiq do t'i drejtojnë bisedimet teknike Prishtinë – Beograd, por ama Qeveria, zoti kryeministër,

ende nuk na ka shpjeguar se për cilat çështje teknike do të bisedojnë? Bie fjala, në sferën e gjyqësisë, cilat çështje teknike do t'i bisedoni, sepse për aq sa dimë, çështje teknike do të ishte bie fjala sa gjykatës do t'i ketë Gjykata në Graçanicë, apo sa kompjuterë do t'i ketë ajo gjykatë, sa tavolina pune, sa kerre e tjera e tjera? Apo në sferën e policisë do të ishte si bisedë teknike, bie fjala, sa policë do të kishte Stacioni Policor i Graçanicës, sa nëpunës e çështje të ngjashme? Pra, ngjashëm do të ishin edhe fusha të tjera si biseda teknike, por nuk ma thotë mendja mua që një kryeministër dhe një president i një shteti bisedojnë për këto gjëra teknike, ata mund të bisedojnë, bie fjala, për t'ju dhënë më shumë autonomi komunave me shumicë serbe apo tema të ndryshme....

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mirë që është futur kjo pikë e rendit të ditës kështu edhe rregull në Rregulloren e re të Punës së Kuvendit. Unë për deri tash sa kam dëgjuar ka veç, jo ngritje të çështjeve, po deklaramë të çështjeve, jo informime, por dezinformime të opinionit dhe, si të them, të fillojë afirmimi për vetveten. Unë e kam përcjellë edhe nuk është çështja e parë që shtrohet çështja e "Rilindjes". Një fakt që është meritore dhe e di edhe ky Kuvend, në rishikim të buxhetit të vitit 2009 ky Kuvend ka votuar për pjesën, për mjetet ose alokimin që quhet për renovimin e "Rilindjes." Para kësaj, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ka bërë një kërkesë për rialokim sipas ligjit jashtë procesit të rishikimit, të cilën Kuvendi nuk e pat miratuar dhe ka pasur afat vetëm një muaj brenda kërkesës së parë dhe futjes të kësaj kërkesë në pjesën e rishikimit të buxhetit. Prandaj, ky Kuvend me votën e vetë shikoni procesverbalet, ka votuar që mjetet të ndahen për renovimin e "Rilindjes" dhe si objekt t'i destinohet institucioneve të Republikës së Kosovës. Në qoftë se kemi deklaruar se nuk duhet të paguajmë qira dhe duhet të shfrytëzohen objektet publike që i kemi për veprimin e institucioneve tona, atëherë nuk di kujt dhe pse i pengon kjo çështje ose pse përsëritet dhe ripërsëritet tash e 3 vjet çështja e "Rilindjes". Mos të bëhemi bajat në të njëjtat çështjet, merrni shikoni vendimet që i ka nxjerr ky Kuvend me rishikim të buxhetit për vitin 2008.

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,
Ministra dhe deputetë të nderuar,

Në këtë rast paraqitem në emër të Grupit të AKR-së. Përderisa, aktualisht pa ndalur atakohet paga e deputetit të zgjedhur me mandat burimor, me autoritet dhe me integritet moral, në funksion të legjislativit, dot dhe po thuaj se asnjëherë nuk apostrofohen pagat, paratagrat, privilegjet enorme, me asgjë të justifikuar, ndër të tjera, po e zëmë, në Bankën Qendrore të Kosovës, ku drejtori e ka pagën sa 2 herë që e ka kryetari i shtetit. Në Trustin e Pensioneve, ku nga paraja e pensionistit të mjerë e të nëpërkëmbur, merren paga jashtëzakonisht ekstra enorme, me asgjë racionale, në Postë e në përgjithësi në ndërmarrje publike, ku paraja publike disponohet arbitrarisht, ajo është para e buxhetit, ani pse ato janë ndërmarrje publike e tjera.

Tjetër, Qeveria pa shmangshëm duhet të përcaktojë kritere të objektivizuara racionale, proporcionale me kapacitetet financiare vendore dhe me kërkesat për ushtrimin e punëve, aktiviteteve, funksioneve të bordistëve dhe të menaxherëve të ndërmarrjeve publike, të agjencive dhe të gjitha institucioneve të financuara me dhe nga paraja buxhetore, përkatësisht publike dhe ashtu, ndër të tjera, të krijohet një rend i logjikshëm, i pranuar dhe deri diku se s'po them absolutisht apo jo, i arsyetuar i atyre të ashtuquajturve kompensime.

Përfundimisht sipas kriterëve të sanksionuara duhet të sigurohet edhe marrja e ekstra profiteve të entiteteve biznesore të favorizuara në treg, jo në saje të punës, po në saje të pozitive monopoliste. Natyrisht, ato para do të duhej të alokoheshin në buxhetin e varfër të vendit tonë.

Dy, rrudhja unilaterale, arbitrare e kufijve të Kosovës në pjesën perëndimore të saj bëhet provokativisht edhe për të krijuar fakt të kryer. Dihet ç' është fakti i kryer në diplomaci dhe në historinë e diplomacisë. Sa herë janë caktuar kufijtë në disfavor të atyre që kanë pasur të drejta legjitime në saje të faktit të kryer. Për shtetin fqinj që gjatë demarkacionit dhe rektifikimeve kufitare eventuale të kishte pozitë apriori të favorizuar gjithnjë në disfavor të tërësisë territoriale të vendit tonë. E theksoj këtu, ju lutem, rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244, ani pse kem averzion me baza apo ... e lëmë anash ajo është në fuqi, ama me

KRYETARI: Faleminderit!

Është kryer koha e paraparë, ju kisha lutur të lexoni në tërësi Rregullën 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ose Nenin 47.

Për seancën e radhës kanë mbetur: Mimoza Ahmetaj, Abdyl Ymeri, Drita Maliqi.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Edhe një herë ju përkujtoj që seancat ose kjo pikë e rendit të ditës fillon në orën 10:00 dhe përfundon në 10:30.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 4 qershor 2010.

Pyes, a keni vërejtje në procesverbal?

Në sallë kemi 74 deputetë.

Pasi s'ka vërejtje në procesverbal, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 4 qershor 2010,

Vazhdojmë me pyetjet parlamentare.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Fatmir Limaj. Deputeti shkoi. Vazhdojmë.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

DRITON TALI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Kjo pyetje ka të bëjë me seancën, domethënë është vazhdimi i pyetjes parlamentare të seancës së 28 janarit lidhur me tenderin për pajisjen e shkollave me teknologji informative, i cili fillimisht iu dha konzorciumin Inter Ardia, Elfwak, Canantis Tiko, me çmim shumë më të lartë se ofortuesi më i lirë. Shuma ishte rreth 24 milionë euro e publikuar në "Kohën Ditore", kurse sipas shifrave që i dhatë në atë seancë, dallimi ishte 15.613.200 euro më e shtrenjtë, nëse pra shumëzohen 28.081 euro, çmimi fitues për kabinet, me 1200 kabinete, siç deklaruar ju në atë seancë, edhe pse më parë kishit deklaruar se për shkollat që kanë mesatarisht nga 30 nxënës në klasë, parashihej që të kishte nga një kabinet, ku dy nxënës ta shfrytëzojnë një kompjuterë, kurse për shkollat më të mëdha parashihej që të ishin më shumë se dy kabinete apo njësi, në gjuhën e tenderit, që domethënë se nuk ishin 1200 njësi, që përafërsisht për 1200 shkolla sa janë, por më tepër rreth 1842 kabinete, që i bie të jetë tenderi rreth 24 milionë euro më i shtrenjtë, ashtu pra siç edhe u publikua në "Kohën Ditore." Sidoqoftë, ky tender pastaj u anulua. Ju, i nderuari ministër, nuk ma dhatë përgjigjen se a u mor dikush në përgjegjësi, qoftë për gabimet e bëra apo keqmenaxhimin marramendës apo qoftë edhe për korrupsionin e mundshëm. Andaj, ju pyes përsëri: A është marrë dikush në përgjegjësi apo jo, nëse po kush dhe nëse jo, pse jo? Po

ashtu, më duhet të shtoj se ju thatë që ky tender është anuluar më 10 dhjetor 2009, nuk del të jetë ashtu, sepse në ueb faqen zyrtare të KRPP-së, Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, thuhet se ky tender është anuluar më 17 dhjetor 2009, domethënë një ditë pasi ishte bërë publike në” Kohën Ditore” artikulli ”loja me miliona të shtetit”, Pra, më 16 dhjetor, siç është publikuar ai artikull. Dhe po të njëjtën ditë, pra më 17 dhjetor, kur ju tentuat ta demantoni “Kohën Ditore” me një artikull shumë të zbehtë. Ju thirrreni në një letër të cilën tentoni ta përdorni si argument, por është në ...

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Enver Hoxhaj.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zotërinj zëvendëskryeministra, kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kjo është një pyetje në të cilën unë përgjigjem për herë të dytë, kuptohet që jam në dispozicion që të jap përgjigje edhe për herë të tretë e katërt. Më lejoni të them që në seancat e fundit kam qenë për vizita jashtë dhe nuk kam mund, i nderuari zoti deputet Tali, të jap një përgjigje të prerë .

Së dyti, kompania nuk është përzgjedhur, por ka qenë në proces të përzgjedhjes dhe, së treti, nuk është nënshkruar ndonjë kontratë dhe asnjë marrëveshje, së katërti, është anuluar me rekomandim të organit të shqyrtimit të prokurimit publik dhe në bazë të këtij organi është anuluar si e tillë. Dhe, së fundi, procesi tashmë ka filluar që ta shpallim përsëri tenderin, me qëllim që çdo shkollë në Republikën e Kosovës të pajiset me qendra kompjuterike, meqë teknologjia informative është instrument shumë i fuqishëm për modernizim të procesit mësimor. Dua t’ju informoj që nga fillimi në proces kanë qenë të përfshirë ekspertë ndërkombëtarë. Unë personalisht ju ftoj që të vini dhe t’i shihni të gjithë dokumentet në dispozicion, nëse keni dëshirë t’i shihni dhe në të njëjtën kohë dua t’ju informoj që së bashku me Komisionin Evropian, i cili po ashtu është një projekt i IP-ës, që synon që t’i pajisë shkollat në Republikë të Kosovës me teknologji informative. Ne gjatë vitit 2010, 2011 dhe 2012 do të fillojmë procesin e pajisjes së shkollave me teknologji informative. Unë po ashtu ju kam sjell juve një listë në të cilën thuhet tekstualisht që kompania e cila ka qenë në procesin e përzgjedhjes, që nuk është përzgjedhur, absolut nuk është më e shtrenjta dhe ma merr mendja që këto dokumente të cilat unë i kam do të jenë në dispozicionin tuaj.

Sa i përket pyetjes tuaj, mendoj që ka instanca të tjera të cilat konstatojnë a ka pasur shkelje të ligjit apo jo dhe nëse këto instanca konstatojnë, unë si ministër jam në dispozicion që ta lus administratën e shtetit që të marrë masa edhe për një proces të tillë, i cili padyshim nga fillimi ka qenë transparent.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet,a ke pyetje shtesë?

Fjala deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Së pari, zoti ministër, po edhe ministra tjerë, mësoni një herë për të dhënë përgjigje në atë që pyeteni, mos jepni propagandë, po sidoqoftë, kjo nuk është hera e parë që akuzoheni për tender. E dini shumë mirë, para dy vjetëve rastin me “Dardaninë”, pasi veç dha propagandë, ku ishin në pyetje 2 milionë euro të keq menaxhuara, sidoqoftë atë letër për të cilën flitni që e keni dërguar në ESHP, ESHP-ja thotë se s’e kemi marrë, dikush është kah rrenë. Pastaj, ju thirrreni në një letër, e cila s’është e protokoluar kurrkund hiq, domethënë as s’ka vulë, pra është, mund të shkruhet pas 2 – 3 dite apo 5 dite, po i humbin milionat e ku t’iu besojmë në këso sende. Po shkoni po i bëni fals emrat e kompanive në tenderë nga 200 milionë e s’po mi bëni mua fals 2 – 3 fleta. Sido që të jetë, mirë thatë se janë organet të cilat do ta mbikëqyrin, shpresoj se e mbikëqyrin me theks të posaçëm EULEX-i,

shpresoj se nuk është kah na jep më fjalë a t'i zë peshqit e mëdhenj, peshqit e vegjël, po do të veprojë së shpejti, shumë shpejt, shpresoj.

KRYETARI: Deputet, ke kujdes në fjalorin parlamentar!

Vazhdojmë. Deputetja Njomza Emini, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi apo për ministrin Besim Beqaj. Ministrin s'e kemi këtu, mirëpo është zëvendëskryeministri.

Deputete, mund ta bësh pyetjen!

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Pyetja: Kanë kaluar 8 muaj nga publikimi i Raportit të Progresit nga Komisioni Evropian. Cilat janë të arriturat kyçe në pikat e ngritura në raport nga ana e Qeverisë si fusha e prokurimit dhe politizimi i administratës? Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, e ke fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit zonjusha Emini, për pyetjen.

Kam provuar të jap një përgjigje të tillë edhe në Komisionin për Integritet Evropian, do të provojë që të jap prapë. Lidhur me fushën e prokurimit publik ka qenë një ndër sfidat apo dobësitë që ka mund t'i thotë dikush në Raportin e Progresit, kemi marrë disa masa.

E para ka qenë identifikimi i problemeve që dalin nga fusha e prokurimit publik, pastaj ka qenë dhe është përgatitja e Ligjit për prokurimin publik që do të përfundojë brenda muajit qershor dhe do të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ngritja e performancës së tërësishme në fushën e prokurimit publik, ku kemi bërë shumë takime të përbashkëta, përfshirë edhe kryetarin e Kuvendit, kryeshefat apo drejtorët e agjencive të prokurimeve publike dhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian.

Në fushën e politizimit të administratës që e theksoni ju, ne kemi qenë të kujdesshëm në këtë fushë, duke ndarë sistemin e shërbyesve civilë me ata që kanë të bëjë me të emëruarit politikë. E dini që Kuvendi i Republikës ka miratuar Ligjin për shërbyesit civilë, që është një garanci më e madhe në këtë drejtim dhe po ashtu dua të them që nuk kemi ndonjë rast të theksuar në këtë drejtim, nëse do të ketë jemi të gatshëm të marrim masa adekuate. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë. Urdhëro.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Shumë shpejt do të publikohet edhe Raporti i progresit, nëse mund të themi për të arriturat që kanë dalë, do të thotë që do të dalin nga Raporti i progresit. A mendoni ju që ky raport do të jetë më i mirë se raporti i kaluar?

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Është krejt normale që një deputete e pozitës të bëjë një pyetje të tillë sugjестive. Faleminderit! Unë mendoj që vetë pyetja e juaj tregon që ne presim më datën 15 qershor kemi dorëzuar Komisionit Evropian imputet tona, përgatitjet tona për Raportin e progresit për vitin 2010, ju e keni vërejtur që edhe në Kuvend janë procedura shumë ligje me prioritet që kanë bërë në fushën e raportit të progresit, kemi bërë përmirësime dhe në performancën e punës së Qeverisë dhe dikastereve të tjerë, por presim që

edhe segmente të tjera përfshirë edhe ato që nuk janë në kompetencat e Qeverisë, sistemi i drejtësisë, agjencitë e pavarura, po këtu, pse jo edhe Kuvendi dhe të tjerët të kenë performancën më të mirë. Unë jam shumë i bindur që ky raport do të jetë në këtë vit më i mirë se sa në vitin e kaluar, por gjithsesi me sfida që do të mbestin deri në anëtarësimin e plotë në Unionin Evropian. Raporti i mirë dhe i plotë dhe pozitiv do të jetë pasi të hymë në Unionin Evropian, deri atëherë do të ketë sfida. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Si duket, deputetja s'është ambientuar që ka kaluar në pozitë.

Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministren Justina Pula- Shiroka. Ministria s'është këtu, a do ta lexoni pyetjen, deputet? Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

RIZA SMAKA: Zotëri ministër Shala,

Çfarë është ballansi, jo bilanci, ballansi i pagesave dhe ballansi tregtar në vendin tonë dhe çfarë janë trendët zhvillimore referuar ecurive zhvillimore të tyre? Kjo është pyetje shumë e shkurtër nga droja latente se regjia do të ma ndërpres edhe atë periudhë që ma ka garantuar Rregullorja. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë ministra,

I nderuar zoti deputet Smaka,

Të nderuar të pranishëm deputetë dhe media,

Të dhënat për balancin ashtu siç e quajti profesori të pagesave për vitin 2009 ka vazhduar të jenë negative ku të hyrat neto dhe transferët kanë vazhduar të kenë një trend negativ, pra po flas për vitin 2009, ashtu më duket edhe ishte pyetja.

Vlerësimet tregojnë se të hyrat neto kanë vazhduar këtë rënie më të shpejtuar të transferët rrjedhëse. Në vitin 2009 llogaria rrjedhëse ka pasur një ngritje prej 7,22%, përkatësisht nga 602,4 milionë, në 645,9 milionë euro, në krahasim të vitit 2008 dhe projeksionet për vitin 2010, pra tregojnë se kjo shifër pritet të rritet deri në 661 milionë, pra trendi është pozitiv sa i përket transfereve dhe rritjes së bilancit të pagesave. Llogaria financiare gjatë vitit 2009 ka pësuar një rënie për 5% nga 452,8 milionë, në 431,8 milionë dhe kjo është ndikuar kryesisht nga ulja e investimeve direkt në Kosovë gjatë vitit 2009, ndërsa llogaria kapitale në vitin 2009 ka pasur një ngritje, fatmirësisht për 15%, përkatësisht nga 462,8 milionë e 533,5 milionë euro. Ndërsa, nëse i referohemi vlerësimeve për tregtinë e jashtme, sa unë e kuptova kjo ishte edhe theksi i juaj profesor përgjatë periudhave 2007 – 2008, shihet trend i zhvillimit të importeve, ka qenë më i hovshëm, ndërsa në vitin 2009 ky trend i zhvillimeve tregtare, qoftë për shkak të krizës globale, qoftë për rrethana të tjera ka pësuar një rënie dhe në krahasim me vitet paraprake diferenca ka qenë rreth 23%.

Sa i përket bilancit tregtar për vitin 2009, po ashtu mund të flasim për ngritje të deficitit tregtar dhe rënie të eksporteve, por që tempojat nga vitet paraprake e trendit është filluar të ngadalësohet në periudhën e dytë të vitit 2009, kryesisht ka qenë si pasojë e krizës globale. Mirëpo, të dhënat e fundit mbi tregtinë e jashtme për periudhën janar – prill të vitit 2010 dhe kjo konsideroj duhet të na gëzojë të gjithëve, dëshmojnë për një rritje të theksuar të eksporteve të mallrave dhe nëse krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit 2009, pra janar – prill, rritja e eksporteve është 120%, përkatësisht, shprehur në shifra edhe pse janë shifra simbolike është në 78 milionë, krahasuar pra me vitin 2009, që ishte vetëm 35 milionë në këtë periudhë.

Kurse sa i përket importeve niveli i importeve në përgjithësi ka filluar të jetë në nivelin e njëjtë apo me një

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Në përgjigjen kompetente të ministri Shala.
Do të kisha aluduar vetëm kështu shkurt, që të bëjë Qeveria atë që mund ta bëjë, ta stimulojë prodhimin vendor edhe me atë ta stimulojmë eksportin se eksporti ynë është po e zëmë, përafërsisht 100 milionë, ndërsa importet janë një miliard e 100 milionë, është një ballans tmerrësisht i disfavorshëm për vendin tonë. Unë fola kështu me grosso modo, në vija të trasha. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. Doni ta lexoni pyetjen, deputet? Regjia, fjalën deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Deri pak më parë ishte këtu, u mbyt edhe ai duke ikur, është pyetja për 6 hektarë tokë që i kanë vjedhur prej QKU-së, pse s'po vjen për t'u përgjigjur, unë s'e di, ndoshta s'po i doker interesant zotit Bukoshi.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Naim Rustemi, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, që ma dhe fjalën, se e kam lexuar herën e kaluar, por zëvendëskryeministri nuk u përgjigj si është e mundshme për ta ndryshuar ligjin me udhëzim administrativ? Po e shfrytëzoj tash rastin që të na shpjegojë në çka e kanë bazuar nga aspekti ligjor udhëzimin administrativ për amendamentimin e Ligjit për prokurorinë publike, kur e di zëvendëskryeministri se nuk ka të drejtë as formularët as formën për t'ia ndryshuar? Pse ia ka marrë këtë përgjegjësi KRPP-së, ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin e prokurimit publik. Mundësisht zëvendëskryeministër të ma japë përgjigjen, të jesh specifik ku jeni bazuar.

KRYETARI: Zëvendëskryeministër Kuçi e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!
Zoti Rustemi kam provuar edhe herën e kaluar njëllor debati që kemi pasur të përbashkët për të dhënë përgjigjen. Tash do të jem pak më specifik edhe pse në politikë nuk është mirë për të kërkuar prej njerëzve shumë të jesh shumë specifik.

Qeveria e Republikës së Kosovës në funksion të realizimit të programit të saj dhe me qëllim të sigurimit të fondeve publike dhe burimeve publike të përdoren në mënyrë ekonomike dhe efikase nga gjithë autoritetet e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur, më 26 maj 2010, ka nxjerrë një vendim administrativ numër 2/126, me të cilin ka miratuar udhëzimin administrativ për nënshkrimin e kontratave publike me vlerë të mesme dhe vlerë të madhe.

Udhëzimi administrativ është miratuar në mbështetje të kompetencave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 4, paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë të vitit 2007. Po ashtu ky udhëzim administrativ është nxjerrë duke pasur parasysh nenet 5 dhe 24.4 të Ligjit për prokurim publik. Sqarime shtesë tash që janë të karakterit pak më politik. Mendoj që nuk i është humbur e drejta, se këtu e keni pasur ... herën e kaluar, askujt i cili e ka bërë nënshkrimin e kontratës deri më tani. Prapë do të jenë përgjegjësit e prokurorimeve publike ata që do t'i nënshkruajnë kontratat, dhe nënshkrimi i tyre është valid, por në nenin 24.4 të këtij

Ligjit të prokurimit publik thuhet : në kontratat ceremoniale mund të bëhet nënshkrimi edhe i të tjerëve”. Ne e kemi shfrytëzuar këtë mundësi juridike, jemi duke përgatitur Ligjin për prokurim publikë, bashkë me Komisionin Evropian sipas standardeve më të larta, besojmë dhe do të procedojmë në Kuvend në qershor të këtij viti.

Unë jam i bindur që këtu nuk është zbehur përgjegjësia, por është rritur përgjegjësia. Shpeshherë, besoj ju zoti Rrustemi edhe të tjerët keni qenë të kujdesshëm që të na tërhiqni vërejtjen që të jemi të kujdesshëm në përdorimin e parasë publike dhe të kemi përgjegjësinë jo vetëm drejtorët apo shefat e prokurorimeve publike, por edhe të tjerët përfshirë edhe ministrat dhe sekretarët permanentë. Dhe pak sa shaka po ju them, këtu është rritur përgjegjësia dhe këtu nuk i ka rënë mirë vetëm ministrave dhe sekretarëve permanentë, por njerëzve që mendojnë ta ruajnë parandë publike, besoj që iu ka ra mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, Urdhëro!

NAIM RRUSTEMI: Më duhet të flas, sepse atë që e tha zëvendëskryeministri nuk është e qëndrueshme, sepse as me nenin 93 të Kushtetutës së Kosovës nuk i jepet e drejta për ta amendamentuar ligjin me udhëzime administrative, sepse KRPP-ja është agjenci e pavarur dhe nxjerr udhëzime vetë KRPP-ja, askush tjetër, por me këtë ju e treguat se Qeveria e udhëheq Kuvendin, sepse amendamenton ligje pa pasur të drejtë dhe unë e di që ju e dini këtë punë se me gjithë atë alamet tituj po këtë qëllimisht e keni bërë. Edhe nuk është kjo çështje ta ngritsh përgjegjësi ndaj parasë publike është ta rrënosh sistemin. Unë e kam bërë pyetjen që ju të jeni të vetëdijshëm së më e madhe është dëmi gjatë rrënimit të sistemit se sa përpjekja për vendosur ligjin në vend. Kështu që pyetja ime do të jetë për seancat e ardhshme: Kur do ta tërhiqni këtë udhëzim administrativ se krejt çka thatë nuk është e qëndrueshme ajo, edhe ju e dini këtë shumë mirë?

KRYETARI: Zëvendëskryeministër,

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit për konstatimet tuaja për shkallën e vetëdijesimit tim dhe besoj që pajtohem aty. Por ajo çka dua të them, zoti Rrustemi, besoj që nuk është çështje që e ka tanguar dhe tangon ligji, e them me përgjegjësi të plotë. Ajo çka është, po them, neni 24.4 e Ligjit për prokurim publik, mund ta lexoni, nëse dëshironi do t’ua jap edhe një kopje, ku e shihni që jep mundësinë e nënshkrimit e gjërave të tilla. Përndryshe, pyetjes tuaj për seancën tjetër po i përgjigjem sot, nuk do të tërhiqet ky udhëzim administrativ po do të sillet ligji në Kuvend dhe ju do ta miratoni këtë ligj. Përndryshe, si konsultë, ndoshta juridike, po ua jap tash, zoti Rrustemi, keni të drejtë që ta ngritni çështjen në organet kompetente, a është vendimi i ligjshëm apo jo? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetë, keni durim.
Deputetja Elhame Hetemi, pyetje për ministren Edita Tahiri.

ELHEME HETEMI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Zonja ministre,

Para disa ditësh shefi i ICO-s, Piter Feit, ka thënë se për regjistrim të popullatës Kosova duhet të bashkëpunojë me Serbinë.

Zonja ministre, më intereson të di se për çfarë bashkëpunimi bëhet fjalë dhe pse duhet të bëhet kjo?
Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryetar,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,
E nderuara deputete Hetemi,

Kosova në këtë fazë ka para vetes një projekt kapital, siç është regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave dhe si një shtet i ri me Kushtetutë dhe me sovranitet të plotë, sigurisht që të gjitha politikat e brendshme dhe të jashtme i mbështet mbi këtë bazë. Ne synojmë një regjistrim që do të dalë me rezultate të tilla që do të kenë legjimitet vendor dhe ndërkombëtar. Në këtë kuadër legjimiteti vendor nënkupton që të kemi rezultate të pranueshme dhe të kënaqshme për gjithë qytetarët dhe komunitetet e Kosovës. Ndërsa, sa i takon legjimitetit ndërkombëtar, dëshirojmë që rezultatet tona të kenë njohje ndërkombëtare. Për sa i takon pyetjes direkte, më lejoni të them se Kosova për punë të saja si shtet nuk ka nevojë bashkëpunimi me asnjë shtet tjetër, përveç një bashkëpunimi konstruktiv që ka me partnerët ndërkombëtarë. Ndërsa, ajo çka ka deklaruar zoti Feit, unë dua ta interpretoj ndoshta si një apel Serbisë që të mos pengojë këtë pjesë të serbëve, pra që ende nuk janë të integruar që të marrin pjesë aktivisht në regjistrim, sepse regjistrimi është një projekt jopolitik, përndryshe shumë e qartë është, pra pozicioni i Kosovës është shtet dhe punët e veta i qon vetë përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete, a ke pyetje shtesë? Nuk ke, faleminderit!
Vazhdojmë. Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Haki Demolli.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar, kolegë deputetë,

Në Gjykatën e Qarkut në veri të Mitrovicës vazhdon të zvarritet rikthimi i gjyqtarëve e prokurorëve vendorë, kurse atje drejtësia ndahet vetëm nga 3 gjyqtarë të EULEX-sit, që është e pamundur të mbulohen me mbi 3000 dosje që presin prej vitesh të shqyrtohen. Pyetja: Zoti ministër, çka po bëni ju edhe Ministria e Drejtësisë në këtë drejtim për krijimin e kushteve për gjyqtarët dhe prokurorët vendorë që të rikthehen në objektin e gjykatës në veri? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër e ke fjalën.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar kryetar,
Të nderuar zëvendëskryeministra, kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,

Sa i përket pyetjes së deputetit, do të kisha theksuar së pari se thjeshtë, funksionimi apo mos funksionimi i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës është bërë një problem i përgjithshëm politik.

Së dyti, do të kisha theksuar se konform Kushtetutës së Kosovës, kjo çështje është kryesisht në kompetencë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës e jo në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë, mirëpo pavarësisht këtij fakti, Ministria e Drejtësisë është e përkushtuar që t'i koordinojë punët me strukturat vendore dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të funksionalizohet kjo gjykatë dhe të fillojë punën sa më shpejtë që është e mundur.

Sa për informim tuajin, i nderuari deputet, do të kisha theksuar se aktualisht në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë janë duke punuar 5 gjyqtarë të EULEX-sit, të cilët kanë zgjidhur diku rreth 11 lëndë, ndërsa kanë një mori lëndësh të pazgjidhura para vetes. Në anën tjetër Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka propozuar dhe presidenti ka emëruar 9 gjyqtarë, 8 prej të cilëve janë të përkatësisë etnike shqiptare, kurse një i përkatësisë etnike serbe, dhe në të njëjtën kohë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka deleguar edhe një gjyqtar serb nga Gjykata Komunale në Gjykatën e Qarkut.

Megjithatë problemet ekzistojnë dhe janë duke punuar në drejtim të krijimit të një trupe, në të cilën do të jenë gjithësisht 6 gjyqtarë, 2 gjyqtarë të përkatësisë shqiptare, 2 gjyqtarë të përkatësisë etnike serbe, dhe 2 gjyqtarë të EULEX-it, kështu që pritet që së shpejti të funksionalizohet edhe kjo gjykatë dhe të fillohet me zgjidhjen e problemeve të cilat paraqiten para saj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Nuk ke. Faleminderit!

Vazhdojmë, po para se t'ia jap fjalën deputetit për pyetje, ju njoftoj që kërkesat ose pyetjet parlamentare që i drejtoni, duhet t'i bëni mbi bazën e nenit 45 të Rregullores së re të Punës dhe jo mbi rregullën 26 të Rregullores së kaluar. Tani lexoni Rregulloren edhe nenin 45, mendoj që edhe nenin 47 është mirë që t'i marrim, do të thotë, t'i bëjmë të gjitha pyetjet, të gjitha angazhimet mbi bazën e këtyre dy neneve që janë në rregullore.

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Ministër, këtë pyetje isha i detyruar pas bisedave shumë të shpeshta me njerëz që janë nga bota e biznesit dhe tregtarë të vegjël dhe të mesëm, që t'ua drejtoj për shkak se arkat fiskale dhe shtypësit fiskal që shiten në Kosovë, janë shumë të shtrenjta, e tejkalojnë çmimin 100%. Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka autorizuar tregtarë të regjistruar dhe printerë fiskalë. Sipas Udhëzimit administrativ 12/2009 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike, neni 12.2 ku thuhet se: "Pas autorizimit të tregtarëve të parë të që nënkupton regjistruar dhe printerët fiskalë, për vitin e parë Komisioni nuk do ta autorizojë, pa kaluar 12 muaj, pas së cilës periudhë Komisioni do të shqyrtojë çdo kërkesë, së paku një herë në 6 muaj. Ju keni autorizuar tregtarët e "parë" a janë 10, 20, i pari është një. Çfarë grumbulli, çka do të thotë për ju i parë, se kështu e keni vendosur në udhëzim administrativ, nuk ju kam kuptuar pse, po tash po e kuptoj, kur janë dalë printerët që në Maqedoni kushtojnë 500 euro, këtu 1000 euro, po e kuptoj pse e keni bërë të parët?

Pyetja ime është: "Sa është numri i të parëve, apo i pari dhe a mund të shpjegoni sepse këto pajisje kanë çmimin shumë të lartë"?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari deputet Rustemi,

Procesi i licencimit të certifikuesve të arkave fiskale dhe të operatorëve, janë dy procese, janë certifikuesit dhe operatorët. Ka qenë synimi dhe premtim ynë që ne t'i bëjmë këto me qëllim që të fiskalizohet çdo biznes në Kosovë, në shtetet e ndryshme ka zgatur shumë, janë zgjedhur metoda dhe mënyra të ndryshme. Ne kemi menduar që së pari është formuar një komision i pavarur nga ekspertë të Ministrisë, Administratës Tatimore dhe ekspertë jashtë institucioneve publike të Kosovës, përkatësisht qeveritare për të përgatitur udhëzimin administrativ i cili besoj është vlerësuar shumë pozitivisht edhe nga institucione relevante ndërkombëtare. Dhe është shpallur kërkesa për të shprehur interesin ku janë paraqitur dhjetë ofertues, prej tyre 3 janë parakualifikuar të cilët, dy prej tyre janë kërkuar, në fakt të gjithë janë kërkuar që t'i aprovojnë arkat fiskale në bazë të specifikave që janë kërkuar, vetëm dy kanë kaluar testin sipas informatave unë që i kamë diku në janar sa di unë, dhe tani them, Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka shpallur të paktën 3 ose 4 herë për certifikues dhe tani ka shpallur tenderin i cili është i hapur sa di unë para një javë dite, ndoshta edhe 4 – 5 dite për operatorë tjerë. Dhe ne duhet të jemi të hapur, dua t'ju shpjegoj se ne do të jemi të hapur në proces derisa të ngopet tregu me ta, a do të jenë 3, a do të jenë 5, të gjithë ata të cilët i plotësojnë kushtet? Është e vërtetë dhe unë jam i shqetësuar personalisht që çmimi është pak më i lartë, specifikat janë mjaftë të dallueshme duhet 3 – 4 gjuhë të futen. Pra, edhe aspektet subverike janë të ndryshme nga shtetet në region. Disa shtete

në regjion i subvencionojnë këto dhe prandaj mbas është edhe një element pse çmimi është më i lartë. Pajtohem në parim se sa më pak konkurrues, çmimi të jetë më i lartë, prandaj, ne kemi hapur këtë treg dhe do ta lëmë të hapur deri sa të ngopet tregu, a do të jenë 3, a do të jenë 4, a do të jenë 5, ne konsiderojmë që ja kam lënë një grupi të pavarur ekspertësh nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Administrata Tatimore, për ta vlerësuar këtë dhe unë jam shumë mirënjohës për ngritjen e këtij shqetësimi nga ana e juaj, sepse konsideroj që është në të mirë të gjithë atyre që edhe të qytetarëve të Kosovës? Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: Po, normalisht se kam pyetje shtesë.

Së pari, do ta kisha pyetur ministrin a janë të shqetësuar edhe ata miqtë të njëjtë ndërkombëtarë, kur ju kanë inkurajuar aq shumë për këtë formë të organizimit me ofrimin e arkave fiskale dhe shtypësve fiskal? Sa për humor e thashë këtë, sepse do të jem i pastër para opinionit publik që ta dinë që nuk po flasim për 100 mijë euro, por po flasim për treg ndoshta 50 milionë euro dhe mundësia, në rregull, 15 milionë realisht do të ishte, po me dhjetëra miliona euro. Dhe nuk po flasim për një gabim të lëshuar teknik, siç ka ndodhur me rastin e Udhëzimit administrativ të Qeverisë së Kosovës, por po flasim për gabime të qëllimshme, për gabime të qëllimshme me tendencë manipulimi me operatorë dhe tregtarë të autorizuar për shitjen e arkave fiskale dhe shtypësve fiskal. Kjo ishte pyetja: Kur do t'i ndreqni dhe pse nuk e respektuat udhëzimin administrativ që ju vetë e keni nxjerrë, 12 muaj ...

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Procesi i fiskalizimit do të zgjatë shumë dhe unë edhe këtu e kam thënë disa herë. Ne kemi kaluar një fazë testuese, e cila konsideroj ka qenë mjaftë e dobishme për t'i identifikuar problemet dhe testuar gjithë tregun. Administrata Tatimore vetëm tani ka filluar që t'i imponojë, pra instalimin e obligueshëm dhe deri më tani ka qenë vullnetar faktikisht, bile e kemi zgjatur mandatin, e kam fjalën që mos të jetë i obligueshëm thjeshtë për t'i tejkaluar këto dhe problemet. E thamë dhe po e përsëris, ky proces do të jetë i hapur dhe jo me presionin e askujt, po në konceptin e filozofisë që kemi ne, nuk ka monopole, nuk ka duopole, ka treg të hapur për çdo licencim. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, Naimi kishte probleme me konkurrencën dhe çmimin.

Deputeti Rexhep Hoti, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. A do ta lexosh pyetjen deputet? Jo.

Deputeti Rexhep Hoti, pyetje për ministrin Blerand Stavileci, ministri s'është këtu, do ta lexoni pyetjen? Nuk do. Vazhdojmë. Mos u ankoni pastaj.

Deputetja Mimoza Ahmeti, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. A doni ta lexoni pyetjen, deputete? Jo. Faleminderit!

Deputetja Mimoza Ahmetaj, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Ministrin e kemi këtu.

Fjala deputetes Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër,

Pas bisedave apo korrespondencave të shumta që keni pasur me kreun e ICO-s, zoti Piter Feit, në lidhje me kthimin e mjeteve të privatizimit dhe të pensioneve, Qeveria është zotuar se deri në fund të vitit do t'i kthejë këto mjete në Kosovë me qëllim të investimit të tyre në ekonominë e Kosovës. Pyetja është: Cilët janë mekanizmat e nevojshëm financiar që ne duhet t'i krijojmë, apo t'i adaptojmë ato ekzistues në mënyrë që këto mjete të mund të kthehen dhe të investohen në ekonominë e Kosovës.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, e nderuar deputete!

Komunikimet janë të përditshme dhe mbase shpeshherë këto po debatohen edhe nëpër media në mënyrë të shtrembëruara, të drejtën të them, shpeshherë me qëllim, apo pa qëllim, apo pa informim dhe është e drejtë e secilit ta shtrembërojë ta sforcojë, ta komentojë ashtu siç është, mandat i Qeverisë së Kosovës dhe konsideroj të gjitha institucioneve që ia dëshirojnë të mirën e këtij vendi është që të gjitha mjetet publike të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Mjetet e privatizimit, mjetet e Trusit të Pensioneve janë të përcaktuara goxha hollë nëse mund ta them ashtu me pakon e Ahtisarit, dhe ICO-ja ka rolin e vet të cilin ne po përpiqemi ta zgjedhim në mënyrë më pragmatike të mundshme. Unë edhe dje kam pasur një takim dhe takimet janë të përditshme disa prej të cilave po dalin nëpër media në formë të shtrembëruar, ekziston një disponim pozitiv nëse mund të them që të gjejmë forma të përsheptimit të kthimit, kushtimit të kthimit të investimit të këtyre parave për zhvillimin ekonomik të vendit të zgjedhjes dhe përsheptimit të procesit të likuidimit të aseteve të cilat Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit apo Agjencioni Kosovar i Privatizimit tani është në mandat të plotë për të menaxhuar dhe zhvilluar këto projekte.

Unë jam shumë optimist që gjatë verës dhe shumë shpejtë disa nga amendamentimet e disa ligje të cilat janë iniciuar do të mundësojnë përsheptimin e këtyre proceseve të cilat janë në administrim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Në anën tjetër Ministria e Ekonomisë dhe Financave në bashkëpunim me Bankën Qendrore është duke përmbyllur po thuaj se fazën e legjislacionit sekondarë për emitimin ose përgatitjen e Kosovës si shtet të emitojë ... të Thesarit, përkatësisht letra me vlerë në të cilat mund të investohen këto para. Në mënyrë që këto para të jenë në funksion edhe të atyre që janë titullin e pash edhe do korrespondenca të disa aktorëve tjerë politikë. Neve nuk doja t'i lija hapësirë askujt që të keqinterpretojë se dikush nga Kosova dëshiron ta shtrembërojë, ta cenojë pakon e Ahtisarit, është e kundërta. Nga ajo që është mandatar me pakon e Ahtisarit dëshirojmë të nxjerrim pragmatizmin më të madh për funksionimin më të shpejtë të vendit dhe funksionin e këtyre parave.

Prandaj, 2 – 3 amendamente që do të bëhen në Ligjin e Dhomës Speciale, në Ligjin e Agjencionit Kosovar të privatizimit dhe në Ligjin e likuidimit të cilat jemi duke i diskutuar me ICO-në, besoj do të jenë në funksion të kësaj dhe në anën tjetër Banka Qendrore e Kosovës së bashku me Ministrinë e Financave, përkatësisht Thesarin, deri diku do të përgatiten për emitimin e letrave me vlerë. Këto janë dy nëse mund të them paralele në të cilat jemi duke punuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Urdhëro!

MIMOZA AHMETAJ: Jo ndoshta pyetje shtesë, por më tepër për ta sqaruar ishte pikërisht pyetja që e bëra me qëllim të sqarimit të informatave më në detale, për të mos lënë hapësirë në mediat në forma të ndryshme që shkruajnë për një çështje të tillë të rëndësishme. Faleminderit, ministër!

KRYETARI: Mediat e bëjnë punën e tyre.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala, është pyetja e fundit.

DRITON TALI: Zoti ministër,

Kohë më parë Qeveria pati vendosur që të angazhojë një kompani konsulente, e cila do të shërbejë si këshilltar strategjik në privatizimin e PTK-së. Siç dihet, ekziston edhe një kompani konsulente e transaksionit, siç i thuhet Tevko, e cila paguhet 1.150.000 euro, dhe ka për bakshish, siç e dini, ia keni dhënë 0,39% të vlerës së shitjes së PTK-së, për shkak se siç e keni arsyetuar, kjo firmë jep kontribut në proces. Nuk e kam të qartë pse edhe një këshilltar strategjik, sa do të kushtojë ky këshilltar strategjik, çka është këshilltari strategjik, sa do t'i jepni bakshish këtij këshilltari strategjikë, veç edhe të kisha lutur paraprakisht, mos mu përgjigj duke i falënderuar miqtë tanë ndërkombëtarë, edhe NATO-n, por mu përgjigj në pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Driton, e di, bakshishet janë 10%. Urdhëro, ministër e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Unë gjithsesi do t'i falënderoj miqtë ndërkombëtarë, do t'i falënderoj të gjithë njerëzit e qëllimit të mirë që i dëshirojnë këtij vendi të mirën, dhe s'do të ndalem së falënderuari të gjithë ata që kanë kontribuar që ne sot të debatojmë edhe çështje strategjike.

Sa i përket çështjes së transaksionit, përkatësisht këshilltarit të transaksionit të ashtuquajtur strategjik, konsideroj që është praktikë e mirë në rastet kur kemi për asete strategjike që të dëgjohet edhe mendimi i dytë i ekspertëve në këtë lëmi, dhe konsideroj që kjo është absolutisht në frymën e praktikave më të mira, sidomos kur kemi të bëjmë me projekte kaq të mëdha, siç është Postë-Telekomunikacioni i Kosovës. Dje Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur dhe do ta sjell në propozim këtu për të diskutuar që 75% të aksioneve të kësaj ndërmarrje publike do të hedhen në privatizim dhe besoj që ky proces do të jetë tepër i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për rritjen e këtij sektori.

Sa i përket, edhe një herë ti kthehem kësaj, nuk mund të paragjykoj se sa do të jetë ky, procesi është ende i pambyllur, është tenderi i hapur. Ne kemi tentuar faktikisht para ca dite dhe nuk ka pasur përveç dy kompanive të parakualifikuara, njëra ka pasur probleme në kualifikimin teknik dhe është mbetur vetëm me një dhe kemi përsëritur dhe ftoj, e shfrytëzoj rastin që të ftoj këndo, duke iu përfshirë edhe juve si ekspertë ose ndonjë kosovar që ka ekspertizë në këtë drejtim, të paraqitet për interes për të këshilluar Qeverinë në këtë proces tepër të rëndësishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë, apo koment shtesë?

DRITON TALI: Jo, veç desha që edhe herëve tjera zoti ministër të na kursej, se populli e di, qytetarët e Kosovës e dinë se je patriot i madh, rrjedh prej një familje patriotike dhe aty s'ka dyshim, domethënë, krejt kjo dihet në mënyrë publike dhe s'ke nevojë të shesësh këtu.

KRYETARI: T'i vazhdohet koha!

DRITON TALI: Po kthehem te kjo, unë do t'iu propozoja edhe qytetarëve të Kosovës që ta angazhojnë një këshilltar strategjik për Qeveri, se gjë në dynja s'është kah na vyen kjo qeveri. Shtrohet pyetja, çka bën ti në atë Qeveri atje si ekspert, pse të paguhen edhe një milionë e sa do të paguhet këshilltari strategjik dhe do të jepen bakshish, siç u tha këtu, 10%? A ke ndjenjë për paranë e qytetarit, po të pyes, të Kosovës, a është para e tjetërkujt e s'është e xhepit tënd, ato tuajat i ke investuar tjetërkund.

KRYETARI: Mos dil jashtë kuadrit të pyetjes!
Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Është sinqerisht e kotë të debatohet me tone të tilla dhe paragjykime të tilla. Unë veç dua të them që sigurojmë qytetarët e Kosovës dhe të gjithë ata të interesuar, pa

ekzagjerime dhe pompozitete, çfarë i bëjnë disa nga deputetët këtu prezentë dhe absolutisht pa ndonjë qëllim të përkufizuar që vështirë është të definohet, që ky proces do të përmbyllet brenda këtij viti. Ju lus që të jemi mbështetës të proceseve të zhvillimit ekonomik. Çështja e këshilltarëve është praktikë e të gjitha vendeve në regjion, mënyra e përzgjedhjes është përcaktuar me ligj, çështja e përzgjedhjes së kualiteteve është çështje e kriterëve dhe ne besojmë se do ta arrijmë cakun të cilën e kemi arritur. Faleminderit, shumë!

(Reagim nga salla)

KRYETARI: Faleminderit!

Unë i kisha lutur deputetët e pavarur, e kuptoj që nuk është lehtë të jesh deputet i pavarur, por respektoni njëfarë rendi e rregulli. Do të thotë, nuk ka më pyetje parlamentare. E falënderoj ministrin për përgjigjet. Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qasje në dokumente publike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë projektligjin.

Zëvendëskryeministër, e ke fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Duke paraqitur para jush për miratim në lexim të parë Projektligjin për qasjen në dokumentet publike, përgatitur nga Zyra e Kryeministrit, theksoj se ky projektligj është hartuar duke u bazuar në strategjinë legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2010 dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e Punës së Qeverisë, numër 02/2007.

Të them në fillim se Ligji për qasje në dokumente publike do ta shfuqizojë ligjin numër 2003/12 për qasje në dokumente zyrtare. Ky ligj është harmonizuar me Kushtetutën dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare, të cilat janë pjesë direkt e zbatimit në Republikën e Kosovës si dhe në veçanti është marrë parasysh Konventa e Këshillit të Evropës për qasje në dokumente zyrtare e vitit 2009 dhe vetë parimet ndërkombëtare mbi të drejtën për qasje në informata.

Po ashtu, ky projektligj do të eliminojë ose më mirë të them do të plotësojë të gjitha zbrazëtirat nga ligji i mëparshëm.

Qëllimi i këtij ligji është që secilit person t'i garantohet dhe mundësohet e drejta pa diskriminim mbi çfarëdo baze për të pasur qasje, natyrisht pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara apo të pranuar nga autoritetet publike në vendin tonë.

Qasja e lirë në dokumentet publike, të cilat i mbajnë autoritetet publike, mundëson që qytetarët të jenë më mirë të informuar, kurse nëpunësit e autoriteteve publike më përgjegjës, gjë që pakëson rrezikun nga keqpërdorimi i fuqisë dhe siguron respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut e që përkon edhe

me synimet dhe përpjekjet e Qeverisë dhe institucioneve tjera të vendit tonë dhe kështu bën që avancimi i të drejtave të njeriut dhe ngritja e transparencës të ketë kontinuitet.

Ky ligj zbatohet mbi të gjitha autoritetet publike si dhe për të gjitha dokumentet që mbahen, hartohen apo pranohen nga autoritetet publike.

Hartimi i projektligjit është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria për Integritet Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria e plotë me asquis communautaire dhe se për zbatimin e këtij ligji nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore.

Aprovimi i këtij projektligji paraqet një hap përpara në avancimin e të drejtave të njeriut si dhe ngritjen e transparencës në Republikën e Kosovës.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju propozoj që ta miratoni në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Kryetari i Komisionit a e do fjalën? Jo. Vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare. Sipas radhës kush e do fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Fjalën e ka Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligjin të cilin po e shqyrtojmë qasja në dokumente publike është një projektligj shumë i nevojshëm për forcimin e institucioneve demokratike dhe demokratizimin e shoqërisë.

Qasja në dokumentet publike bën të mundur që vendimmarrjet të jenë transparente dhe institucionet të përmbushin një kriter themelor për funksionimin demokratik të tyre.

Ky projektligj normon një të drejtë duke qartësuar mundësinë, formën në qasjen në dokumentet publike. Duke parë si shumë të nevojshëm një projektligj të tillë i cili do të përmbushë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah projektligjin në parim duke dhënë kontributin e vet në komisionet parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kush e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni t'i përshëndes të pranishmit qeveritarë, këtu, zëvendëskryeministrin, ministrat,

Edhe Grupi ynë parlamentar do ta mbështesë në parim këtë projektligj. Për detajet eventuale ne do të japim kontributin tonë gjatë procesit të shqyrtimit të këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës, deputetja Melihate Tërmkolli, e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Për fillim një saktësim rreth këtij projektligji, në arsyeshmërinë dhe qëllimet e tij është thënë se duhet të harmonizohet me dispozitat kushtetuese dhe unë mendoj që ky Parlament ka një obligim që me një

rezolutë ose një akt tjetër t'i harmonizojë të gjitha ligjet ekzistuese që janë në fuqi me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dhe një aspekt tjetër, i cili është i pasaktë dhe nuk qëndron në këtë projektligj është mungesa thotë e funksionalitetit të versionit paraprak të një ligji, në fakt është fjala për ligjin ekzistues, sepse ne kemi një ligj dhe nuk një version paraprak, por ka një ligj. Ajo që dua të them është një dukuri që e ka kapluar këtë Qeveri, dukuria që qeveria aktuale kur nuk do ose nuk mund t' i zbatojë ligjet të cilat janë në fuqi, atëherë i qaset hartimit të ri të ligjeve, në kohën kur Kosova i ka këto ligje, ligjet të cilat i ka miratua po ky Parlament i Kosovës dhe nuk janë rregullore të UNMIK-ut. Qeveria ka mund t' i ndryshojë ato ligje, sepse natyrisht ka mundësi që ligjet të ndryshohen, ka edhe nevojë shumë nga ato ligje edhe të ndryshohet, mirëpo Qeveria për të blerë kohë, për të arsyetuar moszbatimin e ligjeve që janë në fuqi, atëherë po bën ligje të reja. Dhe, një nga ato ligjet shumë karakteristike është pikërisht ky ku kemi një mungesë tepër të madhe nga ana e Qeverisë në funksion të zbatimit të këtij ligji, ka kërkesa jashtëzakonisht të mëdha dhe madje edhe reagime të shumta të qytetarëve të Kosovës që është mbase ndër qeveritë e cila më së paku ka lejuar dhe ka pranuar qasje në dokumentet, atëherë në ligjin që është ende në fuqi, dokumentet zyrtare, tash është ndryshuar në dokumentet publike.

Ky projektligj mund të them që ka mangësi bukur të madha, sepse nuk, mos të hyjë tash në detale për secilën pikë që mund të diskutohet, por vetëm në qëllimet e ligjit thotë që kanë të bëjnë me dokumentet që mbahet, hartohen ose pranohen. Askund nuk thuhet dokumentet të cilat i nxjerrë një institucion i caktuar, një institucion mund të hartojë një dokument, por ai dokument mos të jetë i miratuar. Prandaj, në këtë kuptim ka edhe probleme esenciale theksoj.

Ky ligj ka shpikur edhe një administratë në nivelin rajonal që me Kushtetutë të Kosovës nuk kemi administratë në nivelin rajonal dhe nuk e ka shpjeguar si duhet, sepse mbase e kanë menduar për administratën në ndërmarrjet publike që ka, disa janë rajonale, por në aspektin territorial shtetëror ne nuk kemi organizim rajonal, kemi organizimin në nivel të shtetit dhe nivelin komunal.

Më tepër projektligji ka të bëjë me teknikat për qasje në dokumente se sa në realizimin e të drejtës së qytetarit për qasje në dokumente zyrtare dhe mund të them me bindje të plotë që nuk garanton ky projektligj qasje të mirëfilltë të qytetarëve në dokumentet publike. Është një obligim i pashpjegueshëm që në projektligj i është dhënë institucionit të Avokatit të Popullit, për ta detyruar në këtë mënyrë qytetarin që të sillet në një rreth vicioz, atëherë kur institucionet publike nuk e realizojnë obligimin e tyre ndaj qytetarit të shkojnë te Avokati i Popullit dhe Avokati i Popullit, prapë kthehet te institucionet publike. Dhe thjesht është një sjellje në një rreth, pra vicioz dhe qytetari do të mbetet pa u njoftuar me dokumentin dhe pa e realizuar të drejtën e tij të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Mbase mund të bëhet ndonjë amendamentim edhe pse kemi parë praktika që në këtë Parlament ka nevojë për shumë ligje që të amendamendohen që nga fillimi ose në fakt të bëhen ligje që nga fillimi. Kam frikë që edhe ky ligj do të jetë në grupin e atyre ligjeve që duhet t' i bëjë nga fillimi dhe po ashtu kemi praktikën kur bëhen mirë, atëherë nga fillimi po nga ky Parlament ato ligje i devalvon dhe i degradon për t' i vënë në funksion të interesave të Qeverisë aktuale.

Unë do të doja që institucionet dhe duhet të shpresoj që komisionet funksionale, ndoshta do ta kenë kurajën që të bëjnë amendamente për ta bërë një ligj të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AKR-së, fjalën e ka deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar Projektligjin për qasje në dokumente zyrtare dhe ka vërejtur se ka disa paqartësi ose mos precizitet sa i përket të dhënave ose sekretit shtetëror, atij zyrtar gjithashtu, nuk është në masën e duhur as sanksionimi për mospërfilljen e këtij projektligji. Gjithashtu ka gjetur vërejtje sa i përket procedurave, ka paqartësi dhe në parim e përkrah projektligjin, do të japë kontributin e vetë në komisionet gjegjëse.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Synavere Rysha e ka fjalën.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë do të shpreh qëndrimin e grupit tim për Projektligjin për qasje në dokumente publike.

E konsiderojmë si një projektligj i një rëndësie të veçantë dhe e mbështesim në parim. Mendojmë se zbatimi i këtij projektligji në praktikë, pra mundësia e qytetarëve për qasje në dokumente publike, do të rrisë në masë të madhe transparencën dhe qytetarët do të kenë mundësi të informohen me dokumente të ndryshme që hartojnë institucionet dhe autoritetet publike.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji janë vërejtur disa dobësi apo zbrazëti përbrenda tij të cilat disa nga këto veç u thanë, mirëpo janë edhe disa dobësi të cilat duhet të eliminohen. Sidomos, vërehet dobësia të kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare. Aty thuhet se qytetarët do të kenë qasje në dokumentet zyrtare dhe kërkesa e tyre do të shqyrtohet dhe trajtohet në një afat sa më të shkurtër kohorë, mirëpo nuk precizohet se sa do të jetë ai afat kohorë, prandaj do të ishte mirë që të jetë një periudhë sa ditore ose javore sa do të presin qytetarët për t'u pajisur me dokumente publike.

Mandej mosrealizimi i të drejtës për qasje në dokumente zyrtare u tha edhe nga kolegët, mbetet vetëm institucioni i fundit ankesat të Avokati i Popullit, që mendoj edhe kjo çështje duhet të rregullohet me masa të tjera ndëshkuese, sepse kjo mbetet shumë e lehtë apo thjesht është e vështirë të zbatohet në praktikë.

Është edhe pjesa e fundit ku thuhet Qeveria miraton aktin nënligjorë për zbatimin e tij në një afat më së largu deri një vit pas hyrjes në fuqi të projektligjit. Edhe këtu mendojmë se afati njëvjeçar për nxjerrjen e akteve nënligjore është jashtëzakonisht i gjatë kur kemi parasysh se kemi të bëjmë me akte shumë, të paktën në brendinë e projektligjit shihet se kemi të bëjmë me akte nënligjore se si procedura do të rregullohen për kërkesa dhe trajtime të qytetarëve për të pasur të drejtë qasje në dokumente zyrtare dhe akti tjetër nënligjor parashihet të jetë taksat që faktikisht taksat e kanë karakterin më tepër simbolikë se sa një karakter tjetër dhe ato janë dy dokumente që duhet të rregullohen, ndoshta me një periudhë njëmuajore jo një periudhë njëvjeçare.

Sido që të jetë, ne e mbështesim në parim e thashë edhe në fillim dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Pozdrav zameniku premijera i ministru!

Mi mislimo da se ovde radi o zakonu koji reguliše jedan važan segment odnosa na relaciji građanin – institucija i on se odnosi u stvari vrlo često u postupcima kada građani imaju potrebe za raznim dokumentima putem kojih dokazuju svoje tvrdnje ili ih ostvaruju ili pokušavaju da ostvare neko pravo pred upravnim i pravosudnim institucijama.

Ovaj Nacrt zakona ustvari pogađa suštinu i smatramo da će biti sporodljiv u praksi, ali imamo naravno i neke primedbe. Na primer, član 17. gde na jedno mesto, citiram ovaj član: „Ne daje garanciju za slobodnu upotrebu svog vezika”, jer pogodnija je formulacija ako se u mesto reči “na njihovom odgovarajućem jetiku” postavi nova formulacija “na svome jeziku”, ova stoga što izraz “na njihovom odgovarajućem jetiku” nije potpuno preciziran, dakle širokog je značaja.

Takođe, zakon u nekim delovima je nejasan u pogledu forme iz razloga korišćenja termina koji nisu korišćeni u klasičnim formama zakona ovog podnevljena, na primer “javni autoritet” u mesto da se stavi možda drugačije formulacije – jave ili državne institucije i tako dalje. No, u svakom slučaju, mi ga u načelu prihvatamo, mi ga u načelu prihvatamo i radi se ipak o solidonom predlogu Nacrta zakona. Hvala vam!

Drejtimin e seancës e merr anëtarë të Kryesisë, zotëri Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit, Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, zotëri Miletij. Deputetët Miletij, fjalën. Çka ka, kartela diçka s’po i funksionon, si duket. Fjalën deputetët Miletij, SLS, regjia. Hoçete odve?

PETAR MILETIĆ: Nisam baš planirao da izlazim za govornicom za dve rečenice, ali evo. Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke podržaće u načelu ovaj nacrt zakona. Naše neke primedbe koje se tiču upotrebe jezika i pisma prilikom pristupa javnim dokumentima podnećemo kroz funkcionalne komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në radhë është në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, zotëri Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zotëri kryesues i Kuvendit!

Mi kao Parlamentarna grupa za Integraciju ćemo takođe podržati ovaj zakon. Reći ću takođe nekoliko stvari u vezi sa ovim zakonom. Tačno je da ovaj zakon ispravlja neke nedostatke, praznine, nepravilnosti, ne funkcionalnosti vezane za prethodni zakon. Takođe, veoma je bitno da on omogućava učešće građana u procesu odlučivanja, u najmanju ruku uvid ili praćenje tog procesa odlučivanja putem jednog transparentnog odnosa koji će se izgraditi ako bog da na ovaj način. Nadamo se da će ovaj zakon biti onaj koji će i u stvarnosti biti funkcionalan a ne samo ostati onaj zakon koji će vrlo malo biti sproveden.

Takođe, želim da isteknem da već u članu 1. jasno je navedeno da Zakon garantuje svakom licu mogućnost uvida u sve dokumente javnog autoriteta i to je nešto veoma dobro, što treba i zakonski omogućiti, odnosno formulisati. Takođe, u članu 1.3. je jasno navedeno sve vrste, sve mogućnosti uvida u javnu dokumentaciju koja je pojedinačno opisana i odnosi se na dokumenta bila da su pisana ili elektronska, potom fotografije dokumenata, snimci, kopije, detaljno je dakle opisano sve mogućnosti uvida u javnu dokumentaciju, što je zaista ohrabrujuće za jednu dobru i učinkovitu kosovsku administraciju.

U članovima 5 i 6. se govori o odgovornostima službenika, odgovarajućih službenika koji će biti zaduženi za ovo i odgovorni za ovo pitanje i jedinice koji će biti formirane, i takođe zahtevima tražioca na način koji će biti formulisani.

Takođe, želim da isteknem da član 12. jasno nabraja izuzetke vezano za pravo na uvid i tačno je da treba napraviti određene izuzetke u slučaju ako se radi o nacionalnoj sigurnosti, ako se radi o važnoj krivičnoj istrazi ili eventualnom poremećaju te krivične istrage, potom o eventualnom povređivanju privatnosti određenih osoba i to su zaista one mogućnosti kada treba učiniti izuzetke vezano na pravo uvida u dokumentaciju.

Ali ovde želim istaći član 13. koji govori na jedan, po nama, kontradiktoran način, jeste član koji se svakako treba ispraviti ili se treba izbrisati, zato što član 13. suprotno članu 1. koji kaže da sva lica imaju pravo na uvid u javnu dokumentaciju, sada to značajno redukuje ili onemogućava time što se umeće jedna formulacija da kaže da zahtev će biti odbijen ako je nejasan ili ako je neopravdan. Mislim da ove formulacije nisu u redu i ako građanin ove zemlje traži uvid u neki dokument, onda je to veoma jasno, ... načina da zahtev može biti nejasan ili da zahtev bude neopravdan. Jednostavno, to je u suprotnosti sa jasnom definicijom koja praktično izuzima sve vrste apsolutne mogućnosti da zakon garantuje svakom licu, nije moguće da zakon isto vreme garantuje svakom licu uvid u sve dokumente, a na drugoj strani da ga ograničava ili redukuje na ovaj način kako je to navedeno.

Dakle, uz ova ograničenja koja sam naveo vezano za pojašnjenja prava građanina na uvid u javnu dokumentaciju, mislimo da je zakon prihvatljiv i mi ćemo ga, ponavljam to, kao Parlamentarna grupa za integraciju podržati. Hvala lepo!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të grupeve parlamentar diskutimet u kryen. Tani vazhdojmë me paraqitjen e deputetëve. Në radhë është deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Falënderoj, që po ma jep me të njohshëm vazhdimisht fjalën.

Bazuar në nevojën që ka rifreskimi i Ligjit për qasje në dokumente publike pasi që i njëjti në të kaluarën është treguar joefikas, ligj i cili në vazhdimësi është i ekspozuar kritikave, qoftë nga shoqëria civile apo edhe nga media, ndoshta edhe për arsye të neglizhencës dhe papërgjegjësisë së ulët të zyrtarëve institucional ndaj të cilëve janë parashtruar kërkesat. Mendoj se Projektligji për qasje në dokumente publike duhet mbështetur, bashkë me vërejtjet dhe sugjerimet që po paraqes në vijim.

Vërejtja e parë, neni 4 pika 2 thuhet: “Dokumentet janë të hapura për publikun në bazë të kërkesës së drejtpërdrejtë, në bazë të kërkesës të bërë me shkrim ose në formë elektronike, me përjashtim të informacioneve të kufizuara me ligj. Çka nënkuptohet kur thuhet kërkesës së drejtpërdrejtë, kërkesë gojore apo diçka tjetër? Në vijimësi të projektligjit forma e vetme e pranuar nga organi që e lëshon dokumente e kërkuar është ajo me shkrim, në të kundërtën kërkesa refuzohet. Nëse është kështu, pse është dhënë kjo kërkesës së drejtpërdrejtë? Kjo pjesë duhet sqarua ose larguar tërësisht nga teksti i propozuar.

Vërejtja e dytë, neni 5 pika 3: Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarin pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të kërkesës në qasje në dokumentet zyrtare duhet të vlerësojë se cila është njësia përkatëse brenda autoritetit publik që duhet ... Pas marrjes së dokumentit nga njësia përkatëse brenda autoritetit publik, këto dokumente në pajtim me legjislacionin në fuqi ia dërgon kërkuarit të dokumentit. Në këtë pjesë duhet saktësuar afatet kohore ... apo njësia përkatëse duhet të veprojë në realizimin e detyrave e pranishëm me ligj për shembull, brenda 24 orëve ose 48 orëve nga marrja e

kërkesës, me kusht kur kërkesa nuk ka defekte, kërkesit të dokumentit i dorëzohet dokumenti i kërkuar ose në rastin e defektit të kërkesës t'i kumtohet një gjë e tillë dhe t'i rekomandohet për procedura të tjera.

Vërejtja e tretë, neni 6 pika 2: “Kërkesi i ndonjë dokumenti nuk është i obliguar që të japë arsye për të pasur qasje në dokument”. Kjo pjesë duhet ndryshuar, sepse është e pakuptimit që kërkesi të mos paraqesë arsyet për të pasur qasje në një dokument të caktuar. Kjo praktikisht mund të shkaktojë kaos. Më shumë se kaq kjo pjesë është në shpërputhje me pikën 3 të nenit 6 ku thuhet: “Nëse kërkesa nuk është sa duhet e saktë autoriteti publik kërkon nga kërkesi që të qartësojë kërkesën dhe i ndihmon kërkesi që ta bëjë këtë. Mungesa e arsyes në kërkesën për qasjen e dokumentit zyrtar e nenit 6 pika 2 e bën kërkesën jo të saktë sa duhet. neni 6.3 që i vë këto dy nene në kundërshtim me njëra tjetrën.

Vërejtja e katërt, neni 7 pika 1, në pjesën ku thuhet: “Kurdo që është e mundur duhet të specifikohet hapësira kohore, nuk duhet krijuar hapësira të interpretimit të shumëllojshmërisht të ligjit. Në rastin konkret propozuesi i projektligjit duhet të ketë parasysh këtë fakt dhe t'i evitojë këto lëshime duke dhënë këtë afat të saktësuar brenda të cilave duhet vepruar.

Vërejtja e pestë, neni 7, po ashtu duhet shkurtuar afati prej 15 dite, ku brenda së cilës autoriteti publik duhet të nxjerrë vendim për lejimin e qasje në dokumente zyrtare. Bashkë me qasje në dokumente zyrtare, të interesuarve u duhet ofruar edhe fleksibiliteti në to. Ky afat duhet shkurtuar, sepse praktikisht nuk krijohet kurrfarë komplikacioni, përveç se detyron zyrtarët me më shumë angazhim. Njëjtë duhet vepruar edhe me afatin 7 ditor tek neni 8 pika 1.

Vërejtja gjashtë, neni 9, mos përgjigja e autoritetit publik. Autoriteti publik domosdoshmërisht duhet t'i përgjigjet kërkesit, qoftë pozitivisht, qoftë negativisht mënyrës si e parasheh propozuesi këtë pjesë mundëson krijimin e .. që të ndikojnë shumë negativisht në implementimin e ligjit, kjo pjesë duhet ndryshuar domosdo.

Vërejte shtatë, neni 12.1.4, pjesa që i referohet hulumtimeve disiplinore. Çka nënkuptohet me hulumtimet disiplinore në këtë rast. Nëse bëhet fjalë për hulumtimet disiplinore të zyrtarëve të lartë politik institucional, pse të ketë kufizime në këtë pikë, përkundrazi qasja në këto dokumente do të ndikon pozitivisht në ngritjen e përgjegjësisë dhe performancës së çdo zyrtari publikë.

Në lidhje me ligjin në fjalë propozoj. Një, çdo shërbim në favor të qasjes së dokumentit zyrtarë të jetë falas, respektivisht të mbulohet nga institucioni prej nga kërkohet dokumenti. Në këtë mënyrë do të mbështetet kërkesi i dokumenteve zyrtare dhe... do të mbështetet implementimi i vetë ligjit, dhe ligji që të jetë funksional dhe efikas në shërbim të atyre për të cilët është hartuar.

Dhe krejt në fund propozoj që në kuadër të çdo autoriteti shtetëror të instalohet masa që do ta parandalonte abuzimin, refuzimin e paarsyeshëm dhe afatet e pakufishme kohore ndaj çdo parashtruesi të çdo kërkesë, që ky ligj të jetë i aplikueshëm nuk mjafton vetëm Avokati i Popullit apo inicimi gjyqësorë i rasteve në baza individuale ndaj shkelësve të tij.

Autoritetet shtetërore edhe me këtë ligj do të duhej t'i specifikonin masat disiplinore që do të ndërmerreshin në rastet të evidentimit të çfarëdo lëshimi në këtë fushë. Në këtë drejtim duhet pasur më shumë kujdes. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po ashtu siç u tha edhe nga parafolesit, kjo nuk është një çështje që po rregullohet për herë të parë. Në legjislaturën e parë, respektivisht në vitin 2003, Ligji për qasjen në dokumente zyrtare ka qenë dhe e mbaj qëndrimin të fuqishëm se ka qenë ndër ligjet më të mira që i ka hartuar legjislatura e parë. Ju e dini që në atë legjislaturë nuk ka pas opozitë, gjitha partitë kanë qenë kanë bashkëqeverisur, dhe asistencë teknike që na është dhënë nga Instituti Demokratik Amerikan dhe OSBE-ja për këtë ligj ka qenë shumë faktikisht jetike për ta bërë një ligj për qasje në dokumente zyrtare. Historia e zbatimit të këtij ligji normalisht ka ngecur, siç ka ngecur edhe ndërtimi i institucioneve të Kosovës. Vetëm në vitin 2006 kemi dy udhëzime administrative që janë miratuar për zbatimin e këtij ligji dhe në vitin 2008, po ashtu një udhëzim administrativ sa i përket forcimit të transparencës përmes qeverisjes elektronike, respektivisht faqeve të internetit.

Pra, unë i jap një vërejtje prezantuesit të këtij ligji, sepse ky ligj nuk është një ligj i ri, siç paraqitet si projektligj i ri, po është një ndryshim dhe plotësim i Ligjit për qasje në dokumente zyrtare i vitit 2003/12. Domethënë, duhet të ndërtojmë një praktikë të tillë në rast se ligji pëson ndryshime 50%, atëherë mund të quhet ligji i ri, po në rast se ligji nuk ka pësuar ndryshime rrënjësore, atëherë të mos quhet ligj i ri, por të quhet ndryshime dhe plotësim të ligjit dhe të shenjëzohen, pjesët, nenet apo paragrafët të cilat janë ndryshuar për t'i dhënë mundësi legjislativit që të hulumtojë ndryshimin se a është ndryshimi adekuat, a është kompatibil me standarde ndërkombëtare dhe rrethana të reja që janë krijuar në Kosovë?

Unë e kuptoj që pas pavarësisë së Kosovës, themelimit të shtetit të ri, janë ndërtuar institucione të cilat nuk kanë qenë në periudhën e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse, janë ndërruar emrat nga Ombdusperson në Avokat i Popullit, kemi Gjykatën Kushtetuese e të tjera e të tjera, por këto nuk janë ndryshime esenciale dhe mendoj që këto duhet t'u bëhen me dije deputetëve në shejëzimet që mund t'i ketë propozimi i ri për ndryshim dhe plotësim.

Unë mendoj që ka çështje të cilat duhet të rishikohen në procedura të mëtutjeshme parlamentare që t'i analizojmë, sepse në ligjin e parë është bërë një dëgjim publik dhe mund të them që ligji i parë ka qenë që është bërë dëgjim publik në 2003, me gjithë faktorët e interesuar. Ky ligj ka hasur në kundërshti të opinionit publik, sepse nuk është zbatuar në përpikëri dhe institucionet që kanë qenë dashur të ndërtohen si zbatues të këtij ligji nuk kanë qenë efikase t'iu dhanë përgjegjësi qytetarëve në bazë të kërkesave të tyre.

Unë mendoj që prezantuesi ka bërë një gabim se e cilëson qasje në dokumente publike. Dua të jetë emri që ka qenë, qasje në dokumente zyrtare se në rast se flasim për dokumente publike ato janë të publikut dhe nuk ke nevojë të bësh ligj se si t'u qasen njerëzit në ato, sepse ato duhet të jenë transparente përmes ueb sajteve elektronike dhe duhet të figurojë çdo gjë, dhe dokumenti zyrtar është diçka tjetër, dokumenti publik është diçka tjetër. Edhe në përkufizimet që i hasim në këtë ligj nuk flitet për dokumente publike, por flitet çdo kund për dokumente zyrtare. Prandaj, unë mendoj me aprovimin e propozuesit, Komisioni funksional duhet ta lejojë t'ia lë emrin të cilën e ka pas ky ligj, sepse ashtu i shkon dhe nuk mund të ketë tjetër emër, është gabim faktikisht t'i jepet tjetër emër.

Unë mendoj që kapacitetet që duhet të ndërtohen, posaçërisht në qasjen e drejtpërdrejtë në formën elektronike, duhet të rriten. Është bërë një hapë i mirë nga Ministria e Shërbimeve Publike me miratimin e udhëzimit administrativ 2008/7 nga Ministria e Shërbimeve Publike për rritjen e transparencës dhe standardizimit të faqeve të internetit, por kjo duhet të vazhdojë. Ne kemi një pasqyrë jo të mirë në Ueb sajtet e institucioneve të Kosovës të gjitha institucioneve publike. Ndodh që në arkivat e institucioneve shuhet historia institucionale e institucioneve të reja të Kosovës dhe kjo është gabim i madh. Qytetari duhet ta dijë si ka qenë ligji në 2003, si ka qenë në 2010, qytetari duhet ta dijë

si ka qenë udhëzimi paraparak si është udhëzimi tash, qytetari duhet t'i di vendimet që janë marrë atëherë, dhe vendimet që merren tash. Kuptohet ato dokumentet të cilat nuk konsiderohen si dokumente që mund të cenojnë integritetin, të cenojnë sigurinë kombëtare, të cenojnë privatësinë e individit të qytetarit apo aspekteve tjera komerciale të ndërmarrjeve dhe të bizneseve.

Unë mendoj që janë disa çështje që duhet të sqarohet ose të evitohen nga nenet e propozuara. Sa i përket shembull neni 6, kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, neni 6.2 thotë: Kërkuesi i ndonjë dokumenti nuk është i obliguar që t'i japë arsyet për t'u qasur në ndonjë dokument zyrtarë, unë mendoj që në bazë të arsyeve duhet t'i jepet dokumenti i kërkuar. Po ashtu pika 4, kërkuesi i ndonjë dokumenti ka të drejtë për të mbajtur anonim ndaj palëve të treta. Unë mendoj që duhet të ketë përjashtime, palë e tretë mund të konsiderohet edhe institucioni gjyqësor prokurorial ose policor, i cili mund t'i hulumtojë rastet të cilat mund të vinë si pasojë e ndonjë veprimi që ka marrë dikush nga baza private për t'u qasur në këto dokumente dhe ka pasuar me ndonjë vepër penale ose ndonjë rrezikim të lirisë dhe të drejtave të qytetarit dhe unë mendoj që nuk duhet të ndalohej, nëse flasim për transparencë, atëherë nuk duhet të mohohet transparenca edhe kur dikush e kërkon një shërbim.

Tek përjashtimi i të drejtës në qasje të dokumentit zyrtar, unë mendoj se tek neni 1, çdo kërkues ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike, e thotë: Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për këto qëllime dhe vazhdojnë. Mendoj duhet të përkufizohet: çdo qytetari i Kosovës, domethënë qytetari i Kosovës, të përkufizohet në një, dhe kërkues të tjerë të institucioneve dhe në çfarë procedura ata mund të kenë qasje në këto dokumente. Dhe kjo fjala proporcionalisht të hiqet, sepse nuk ka nevojë konsideroj.

Dhe neni 12.6 dhe 7 privatësia dhe interesat tjera legjitime private duhet këmbëngulësh të mbrohen edhe në këtë ligj sysh janë mbrojtur deri tash dhe interesat komerciale po ashtu.

Tek shfuqizimi, unë mendoj që janë, të kuptohet, ligji i vjetër, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri shfuqizohet është normale, por është e panevojshme që të figurojnë këto edhe udhëzimet administrative që shfuqizohen, sepse ajo nënkuptohet që këtu bëhet fjalë për ligj dhe jo për udhëzimin administrativ.

Nga përvoja që e kam edhe në të kaluarën do ta jap kontributin si deputet i pavarur në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Të nderuar ministra, deputetë,

Ky është një dokument parimisht i nevojshëm edhe i dobishëm, mirëpo formulimet i ka problematike, ashtu që edhe e lejon edhe s'e lejon. Ka dispozita, kur në parim të të gjithë, po ka dispozita përjashtimore edhe formulime të tilla që zyrtarit publik i jep autorizime diskrecionale për ta refuzuar kërkesën kurdoherë, këtë do ta elaboroj pak më tutje.

Konkretisht, në qoftë se e analizojmë kritikisht dispozitën e neni 1 dhe 4, del se kushdo dhe kurdo do të kishte autorizim për të pasur qasje në dokumentet publike. Kjo është një çështje problematike. Ne e dimë se ka njerëz edhe neuropatë edhe psikopatë, edhe njerëz që si të them i kanë disa prirje që bëjnë investigime pa kurrfarë baze, do të duhej që të përjashtohet ajo mundësi edhe të përcaktohet se kushdo që do të kishte interes juridik, se jo bie fjala, kujtdo që do t'i tekej. Unë e di një rast nga praktika gjyqësore në Gjykatën Supreme, një person H.M. 15 vjet duke shfrytëzuar, vërtet keq shfrytëzuar institutin juridik, heshtja e administratës, nga administrata komunale në atë atëherë ishte krahinore, në

Gjykatën Supreme, heshtja e administratës, domethënë, ka kërkuar për t'ju pranuar diploma e Fakultetit Juridik, ani pse nuk e ka pasur jo atë po as shkollën e mesme. Do të thotë nuk duhet të lejojmë dispozita problematike që krijojnë, si të them lëndë edhe raste juridike administrative, qoftë edhe gjyqësore, përderisa ne e dimë se me qindra, mijëra lëndë juridike, administrative edhe gjyqësore janë të paprekura, të mos numërojmë lëndë të cilat janë prekur formalisht edhe nuk dihet se a do të përfundohen ndonjëherë edhe mos ta përmendim edhe atë tjetrën që është edhe më neuralgjike, që me qindra, mijëra lëndë të përmbaaruara, të formës së prerë, nuk përmbaohen, nuk ekzekutohen.

Te neni 13, paragrafi 1, alineja 2, "Kërkesa për qasje në dokument mund të refuzohet nëse është e qartë se kërkesa është e paarsyeshme". Ky formulim i jep autorizim autoritetit publik, qoftë në institucionet e administratës, qoftë të gjyqësorit, që kurdoherë, duke u apeluar në këtë formulim, t'ia refuzojë kërkesën, madje edhe atëherë kur do të ishte kërkesë e bazuar. Ka këso formulime problematike, po disa po i përmendin, natyrisht për hir të kohës edhe të durimit.

Neni 13, paragrafi 2, autoriteti publik që refuzon qasjen në dokumentin publik duhet të japë arsye për refuzim. Ky është një formulim shumë joserioz, domethënë duhet të japë arsye, po nuk ka arsye, duhet të japë aktvendim edhe mirë është këtu që me nenin 23 është përcaktuar, është adresuar Ligji për procedurën e përgjithshme administrative, që do të thotë dihet ç'është aktvendimi, është akt administrativ që duhet të ketë edhe hyrje edhe dispozitiv, edhe arsyetim, edhe udhëzim juridik, se jo arsyetim, domethënë, arsyetim jep primusi, sekundusi në çështjet juridike private e kësisoj, a këtu është fjala për procedura serioze.

Mirë është apeluar në Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, me dispozitën e nenit 23, po do të duhej edhe në Ligjin për procedurën civile apo gjyqësore, sepse dokumente publike mund të ketë edhe në gjyqësorin, edhe në këtë konformitet më pastaj të hapej ajo baza që ja refuzon kërkesën me aktvendim, qoftë në procedurën administrative, qoftë në atë gjyqësore edhe pala të kishte të drejtë për të përdorur mjetin juridik, fillimisht të rregullt e rrjedhimisht, eventualisht të jashtëzakonshëm.

Neni 25, përfundimisht, disa formulime që nuk janë profesionale, të, nivelit më të ulët janë, po e zëmë neni 25, thotë çdo nëpunës civilë apo zyrtarë, ky nuk ekziston qysh nëpunës zyrtarë i cila ka shkelur dispozitat e këtij ligji me "l" të vogël, përveç përgjegjësisë penale apo kundërvajtës, do të jetë subjekt i procedurave disiplinore në përputhje me Ligjin për shërbimin civil dhe me ligjet tjera relevante, domëthanë sipas hartuesit paska ligje relevante, paska ligje irelevante le t'i tregojë se na atëherë ato ligje nuk do t'i përfillim, por çdo akt ligjor është relevant, madje, madje super relevant edhe shumë i rëndësishëm.

Në këtë dokument do të duhej të përcaktoheshin sanksionet, dënimet me të holla, ju lutem, edhe organi i cili do t'i aplikonte, do t'i caktonte edhe do t'i përmbaonte, pa këto ky dokument do të mbetej një dokument i mirë, i cili nuk do të përfillej dot, aq më parë kur e dimi që Avokati i Popullit nuk ka ingjirencë, përpos atyre apeluere e kësisoj domethënë të karakterit moralizues, s'ka kompetenca për të ndërmarrë masa efikase ose e orienton në procedurë gjyqësore ajo quhet kësisoj ad calendar grekas "kur bën shelnja rrush," në qoftë se do të drejtohen në procedurë gjyqësore kur, kur do të realizonte kërkesën e vet. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Shumëçka e kam pasur ndërmend ta them e thanë parafolësit e mi edhe s'po dua me marrë edhe aq shumë kohë, po megjithatë e mbetet diçka që për mua po më duket shumë e rëndësishme. Për shembull

në kapitullin e katërt- dokumentet e publikuara me iniciativë të autoriteteve publike, qasja e drejtpërdrejtë në formë elektronike po më duket shumë e zbehtë, po më duket e zbehtë sepse kisha kërkuar që kjo çështje të forcohet shumë më shumë. Kemi të bëjmë me dokumente me të cilat obligohet institucioni përkatës që të bëjë publikimin e tyre.

Unë vetëm do t'ju ilustroj disa prej shembujve që po përdorën në terren, sepse fillimisht kam menduar se janë veç probleme” teknike”, por po del se qenkan shumë politike edhe politike për përfitime. Rasti i Ministrisë së Shëndetësisë, gjatë përgatitjes sime për në pyetjen parlamentare rreth zhdukjes së 6 hektarëve tokë dhe thyerjes së ligjit për ndërtimin e spitalit privat në Qendrën Klinike Universitare, tentova që të gjej udhëzimin administrativ me të cilin rregullohet funksionimi dhe organizimi i spitaleve private, por çuditërisht i vetmi udhëzim administrativ që s'ishte në ueb faqe, ishte ai udhëzim administrativ. Tash në rregull mund të jetë rastësisht, sepse s'ka pasur dëshirë tjetri që të shohë se çka në të vërtetë po ndodhë ku s'ka të drejtë të ndërtojë deri në 1.5 kilometra edhe që të krijohet një farë forme si mjegull, sepse edhe më ra në mend fjala popullore: “ujku do mjegull”, dhe ju drejtova Ministrisë së Shëndetësisë dhe ma dërguan më pastaj. Kurse së voni, para nja 3 – 4 dite, tentova që të gjejë memorandumin e mirëkuptimit mes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, mes Bankës Qendrore dhe Ministrisë së Administratës Publike dhe asaj Lokale, po çuditërisht askund nuk është, thua se janë dokumente private të tyre edhe po i mbajnë në zarfe mbyllur.

Dokumente me të cilat tentohet të prodhohen përfitime individuale, personale apo grupe, ndoshta edhe që marrin përmasa të krimit të organizuar. Dhe çka ndodhë, në një memorandum mirëkuptimi institucionet mikrofinanciare, organizatë joqeveritare me përfitime, me status të benificuar tentojnë të përkthehen në banka. Dhe po flasim për dhjetëra miliona asete dhe opinioni publik e ka vështirë, e kam pasur unë vështirë dhe i jam drejtuar edhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, nuk ma ka kthye përgjigjen që të më afrojmë një memorandum të tillë, i kam drejtuar edhe Ministrisë së Administratës Publike, një letër në Ueb faqen e tyre përmes kontaktit edhe jam prezantua si deputet, Naim Rrustemi, ende nuk e kam përgjigjen, besoj që do ta kem. Këto janë vetëm disa prej arsyeve pse unë kërkoj që ky nen të jetë shumë më i fuqishëm, nuk janë udhëzimet administrative pronë e udhëheqësit të institucionit, nuk janë aktet normative, marrëveshjet, strategjitë, strategjia e administratës publike ka qenë e larguar nga ueb faqja për dy vite me radhë e Ministrisë së Administratës Publike, kjo për mua nuk më jep kuptim. I vetmi kuptim që po e shoh është për të tentuar për t' i mbyllur informatat, sepse mos po qon dikush pluhur edhe po na priset neve pazari.

Kjo ishte, kërkoj që të jenë shumë më të fuqishëm konkretisht rreth nenit 15 që të publikohen dokumentacionet e rëndësishme. Nuk është mirë të udhëheqin institucionet me logjikën e pronarit, nuk është populli i Kosovës argat i askujt të punojë për tjetërkënd për t'u pasuruar. Janë në shërbim të qytetarëve, paguhen për atë punë, nuk janë duke bërë nga zemërgjerësia, janë zgjedhur, i kanë zgjedhur institucionet, por nuk është rob qytetari që ata ta kenë një jetë të këndshme dhe të mirë, të mirë nuk e kanë, por të pasur.

Dhe për fund unë do ta propozoj një amendament konkret. Dje më çuditi fakti në mbledhjen e Qeverisë, ministri i Shëndetësisë thotë m'i keni pru në momentin e fundit 30 faqe s'po mund t' i lexoj, për një çështje që është shumë e rëndësishme siç është privatizimi i PTK-së dhe rastësisht prezantimi, me qenë se mbledhjet janë transparente, të gjithë u çuditën qysh po guxon ti të flasësh, qysh po guxon ti të lypësh letra... ma qonin mallin si do zogj të vogël kur i afrohet rreziku Kërkoj që duhet vendos një amendament që edhe Qeveria ta rregullojë me ministrat e vet qasje në dokumente para se të votojë, dokumenti 30 faqe, 2 minuta përpara edhe voton, edhe dokumentet të tilla le t'i kenë si kjo ishte pak me dromca humori, por kjo reflekton nivelin politik, organizimin e brendshëm të krerëve që janë në udhëheqje të institucioneve të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sigurisht që vërejtjet esenciale në këtë projektligj mjaft të rëndësishëm u thanë nga parafolësit dhe ndoshta ne vetëm që kemi mbetur më në fund për të diskutuar, mund vetëm t'i përforcojmë pikat ku mendojmë që Projektligji duhet t'i nënshtrohet amendamentimit gjatë, deri te leximi i dytë. Unë po konsideroj që nuk është shumë problem përmbajtja e këtij projektligji sa është zbatimi i dispozitave ekzistuese deri tash në këtë fushë dhe i këtij ligji kur do të finalizohet dhe do të miratohet nga Kuvendi, pra pjesa e zbatimit të tij. Dhe ndoshta ne do të duhej që të jemi më kërkues dhe më insistues në këtë pjesë, sepse është pjesë e misionit të Parlamentit edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve.

Natyrisht bëhet fjalë për një ligj bazik që e përcjell procesin e tranzicionit politik në të gjitha vendet që kanë kaluar nëpër këtë trajektore të transformimit, nëpër të cilën po kalon aktualisht Kosova. Dhe, natyrisht se bëhet fjalë për një ligj që do të ndikojë në ndryshimin e mentalitetit politik nga një mentalitet totalitar i pamundësisë totale të qasjes në dokumente zyrtarë ose publike te një mentalitet demokratik jo totalitar që kërkon lejimin e qasjes në dokumente, madje edhe në dokumente vitale, sepse të gjitha ato, përmbajtjet e atyre dokumenteve lidhen me interesat e qytetarëve të një vendi.

Çka po dua të them? Do të thotë edhe ky projektligj si ka ardhur çalon dhe nuk garanton se do të mund të kërkojmë mundësi të qasjes në dokumente përmes këtij ligji në një të ardhme kur të aprovohet ky, nëse shkon kështu atë që e tha parafolësi deputeti Smaka, te neni 13.2, domethënë, kërkesa për qasje në dokumente mund të refuzohet nëse është e qartë që kërkesa është e paarsyeshme. Tash me këtë klauzolë po thuaj se çdo kërkesë mund t'i gjendet një sentencë që e bën atë të paarsyeshme përkatësisht mund të interpretohet një sentencë për ta shpallur si të paarsyeshme dhe për të mos dhënë përgjigje. Dhe prapë projektligji çalon te pjesa që nuk përkufizon qartë sanksionimin dhe kompetentët që do ta bëjnë sanksionimin për shkeljen e këtij projektligji nga ana e zyrtarëve që duhet të ofrojnë në moment të caktuar, dokument të caktuar, domethënë duhet t'i ofrojnë qasje kërkuesit.

Mendoj që gjatë procesit deri te leximi i dytë duhet ky projektligj, sepse ne kemi pasur dispozita që e kanë rregulluar këtë fushë dhe ndoshta po të ishin zbatuar mirë ato nuk do t'i kishim problemet që janë ngritur në opinion shpeshherë për pamundësi të qasjes në dokumente.

Pastaj edhe një moment tjetër që duhet ky ligj të rregullohet me ligjet që rregullojnë probleme më specifike qysh është Ligji i deklarimit të pasurisë ose nesër një dispozitë që do të rregullojë çështjen e të dhënave personale e tjera. Ky ligj e komplikon qasjen e dokumenteve që duhet të jenë publike se edhe është bërë përkufizimi qasja në dokumente publike. Përderisa ne kemi një pjesë të dokumenteve që lidhen me privatësinë qysh është deklarimi i pronës e kemi qitur në një farë mënyre në deklarim të plotë dhe tash bëjmë fjalë për dokumentet që prekin më pak privatësinë e individit ose çështjen e të dhënave personale, sepse janë dokumente publike dhe e komplikojmë me procedura deri te qasja në ato dokumente ose lëmë hapësirë që të mos publikohen të gjitha e që do të ishte dashur se në raport me rëndësinë që kanë dokumenti për deklarimin e pasurisë ose dokumente për të dhënat personale, këto dokumente nuk e kanë atë rëndësi dhe i kemi komplikuar procedurat e qasjes te këto dokumente më shumë se te dokumentet që në fakt janë, domethënë, të rëndësishme dhe kemi qenë më liberal për t'i ekspozua ato në raport me këto.

Këto do të ishin vërejtje ndoshta parimore, sepse ato specifike edhe profesionale u thanë nga parafolësit dhe ne do të mundohemi të kontribuojmë që ky ligj të bëhet i aplikueshëm kur miratohet, përkatësisht të bëhet i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka i fundit deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Të jesh i fundit siç e dinë të gjithë nuk është edhe fort lehtë për shkak se shumë nga ato që përgatitemi t'i themi të tjerët i thonë. Por, megjithatë mua më duhet të ndalem veç u prek në disa forma neni 12 dhe 13, unë do të doja të ndalem me theks të posaçëm në nenin 12, që ka të bëjë me refuzimin e qasjes në dokumente, domethënë përjashtimet e së drejtës në qasje me dokumente ku po e lexoj për opinion kosovar, thotë: "Çdo kërkues ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike, kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së" vazhdojnë, unë do të shkoj te pika 1.5 "Inspektimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet publike, shih ti, pastaj 1.7; "Interesave komerciale dhe të tjera ekonomike" ama nuk shpjegohet se çka janë ato interesa, për të vazhduar 1.8 me politikat ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit, dhe këtu shtrohet pyetja për atë nuk na jepet dokumenti apo informata për 266 milionë të cilat janë investuar në letra në vlerë dhe ne nuk e dimë se çfarë kamate marrin.

Pastaj, të diskutimeve brenda apo ndërmjet autoriteteve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështje, dhe kjo ndonjë çështje është varësisht se si ne e interpretojmë apo se si autoritetet gjegjëse e interpretojnë.

Unë tash po ndalem edhe një herë ta elaborojë nenin 12 pika 7- Çka janë mbrojtjet e interesave komerciale dhe të tjera ekonomike? Shtrohet pyetja, e marrim si shembull kontratën për dhënien me koncesion të Aeroportit, sigurisht se këtu ka interesa ekonomike, interesa komerciale. Prandaj, edhe nuk është publikuar dhe në bazë të këtyre pikave kjo kontratë nuk do të publikohet, ne kurrë s'do ta dimë si Aeroporti është dhënë me koncesion, ashtu siç nuk e dinë se si Feronikeli u publikua për shkak se aty ka interesa komerciale dhe ekonomike, dhe kurrë opinionin publik kontratën e privatizimit të Feronikelit nuk e ka pasur në dorë.

Dhe tash sidomos gazetarët, por edhe qytetarët të tjerë duhet të aktrojnë apo të behën Eliot Ness apo Chelo Kons, nesër për shembull ... për ta gjetur një informatë, informatë të cilën Ligji mbi qasje në dokumentet publike është dashur t'ia servojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Është interesant se këto pika kanë qenë gjithnjë kritikë kryesore e komunitetit të mediave, gazetarëve sepse kjo pikë iu ka kufizuar atyre fushëveprimin për ta informuar opinionin kosovar, dhe këto pika nuk preken fare.

Tash e kemi edhe privatizimin e PTK-së, ku madje qasje në ato dokumente ashtu siç e tha deputeti Naim Rrustemi, me plotë të drejtë nuk patën as ministrat e le më qytetarët e Kosovës. Pastaj KEK-u do të na privatizohet sigurisht se këtu edhe një herë po e theksoj se ka interesa komerciale, ka interesa tjera ekonomike, por ama janë pronë e qytetarëve dhe sipas ligjeve, të paktën merrni shikoni ligjet për qasjen e dokumenteve zyrtare diku është Ligji për shpalosjen e informatës me interes publik, të gjitha i obligojnë institucionet për hir të transparencës dhe luftës kundër korrupsionit, që qytetarëve t' u servohen këto dokumente e jo të mbulohen me lloj- lloj nene aty e sidomos, siç edhe e thanë këtë nenin 13 pika 1 e 2 është skandaloz, kjo veç në diktaturë mund të ishte futur ky nen këtu. Domethënë, shih ti thotë nëse është e qartë që kërkesa është e paarsyeshme, po sigurisht se është e paarsyeshme kur dua të interesohem ku mbetën 24 milionë që i keni vjedhur për shembull supozohet, sigurisht është e paarsyeshme ajo.

Unë po them edhe një herë këtë ligj nuk do ta përkrah, sepse me këtë ligj vazhdohet të mbrohet korrupsioni, të mbulohet korrupsioni. Ky ligj është dashur të jetë ligj për, po them edhe një herë për shpalosjen e informatës me interes për publikun kur kem sidomos të bëjmë me pronën publike, pronën

e qytetarëve të Kosovës, t'i ndihmojë transparencës dhe luftës kundër korrupsionit. Ky ligj veç vazhdon që transparencën ta mbyllë, vazhdon ta mbulojë korrupsionin, vazhdon që qytetarin e Kosovës ta mbajë në mjegull, të mos e informojë po t'i lihet interpretimeve kështu tenis, ai tha, ky tha, ne thamë, ato po thonë, e tjera e tjera dhe mos të dalin dokumentet gjithmonë po flasim për dokumentet publike ky ligj është, nuk është për dokumentet zyrtare, për interesat e veçanta të shtetit, ndonëse s'di çka kemi ne, e kemi një agjencion për inteligjencën dhe ... më falni dhe ai nuk funksionon fare e tjera e tjera, domethënë ky ligj vazhdon edhe më tutje që qytetarin e Kosovës dhe sidomos mediat të mos i lë lirshëm që ta bëjnë punën e tyre. Faleminderit! Andaj nuk do ta mbroj, nuk do ta votoj këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Replikë, Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: I nderuar deputet Tali,

Unë rastin e mbrëmshëm të ministrit Bujar Bukoshi, ministrit të Shëndetësisë jo që më reflektoi se këtu nuk ka kush ta zbatojë Ligjin për qasje në dokumente publike, por qëllimisht i mbajmë të mbyllura informacionet. Dhe e potencova qëllimisht që të ilustruj vullnetin në forma abstrakte, vullnetin politik se sa ka mundësi dikush tjetër në rast se ministrat ndihen si zogj të vetmuar thuajse ju ka humbur pula. Kjo ishte arsyeja pse e kamë marrë shembullin e djeshëm. Në rast se kërkohet nga ministri të votohet diçka që s'e ka lexuar, kjo mua më vendos në dyshim shumë të madh se si ka mundësi të tjerët të kenë qasje në dokumentet publike, s'ka kush e zbaton këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Uroj që edhe deputetët edhe ministrat t'i lexojnë ligjet dhe letrat e veta me kohë.

Tani sipas radhës fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, zëvendëskryeministri Ramë Manaj, në qoftë se do.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Duke shprehur konsideratën dhe falënderimin për kontributet e juaja më lejoni t'i them vetëm pak çështje që lidhen me draftin e ofruar.

Fillimisht mendoj se domosdoshmërisht duhet dhe do të ketë plotësime e precizime draftit siç u theksua edhe në këtë pjesë të seancës, gjithmonë në funksion dhe me qëllim të plotësimit dhe ngritjes së kualitetit të një ligji. Kjo duhet të bëhet natyrisht duke plotësuar afate, duke konkretizuar normën, duke eliminuar elemente kolizive dhe sigurisht duke përfshirë edhe aspektet sanksionuese të normës.

Më tutje, gjithmonë me drejtë kërkohet harmonizimi i të gjitha ligjeve me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe kjo është edhe një akt i tillë i harmonizimit të një ligji, natyrisht edhe i plotësimit të tij.

Po ua përkujtoj diçka që është krejtësisht e njohur. Parlamenti veprimtari themelore ka miratimin e ligjeve, ndërsa Qeveria është furnitori kryesor me draftligje, me propozimligje.

Më tutje, po përkujtoj se ky draftligj dhe pasi të bëhet ligj nuk mund t'i tkurrë kompetenca të organeve të tjera në fushë të caktuar ose institucioneve tjera. Më tutje më lejoni të them se nxjerrja në afat të caktuar apo të pacaktuar e akteve nënligjore nuk kushtëzon zbatimin e ligjit dhe nuk pengon zbatimin e ligjit.

Po iu përkujtoj se kërkesa për qasjen në dokumente publike pa dashur të paragjykoj ndonjëherë mund të jetë e paqartë. Po iu përkujtoj së paku juristët e kanë të qartë relacionin në mes të normës së

përgjithshme dhe normës së veçantë. Është propozuar që draftligji të quhet Ligj për qasje në dokumente publike dhe besoj se është e qartë. Të gjitha dokumentet publike janë dokumente zyrtare, por jo të gjitha dokumentet zyrtare mund të jenë dokumente publike. Dhe kjo implikon domosdonë e qartësimi, e plotësimit dhe gjithnjë në funksion të një ligji të zbatueshëm, një ligji funksional dhe një ligji që do të jetë në shërbim të qytetarëve dhe të drejtave të tyre themelore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani lus deputetët të cilët nuk janë në sallë të vinë për të votuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

A ka deputetë që janë duke hyrë prapë në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Në sallë janë 69 deputetë,

Konstatoj se me 56 vota “për”, 8 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet Projektligji për qasjen e dokumenteve publike.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione: Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media si Komision funksional dhe komisionet e përhershme.

Komisionet duhet, që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë i Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji. Shpresoj se ministri i Ekonomisë dhe Financave, vjen shpejt.

Atëherë fjalën e ka zoti Ahmet Shala, ministër i Ekonomisë dhe Financave që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantoj projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në pika të shkurtra të paraqes para jush Projektligjin ose arsyeshmërinë për hartimin e Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave, për institucionet financiare të Kosovës i cili sot gjendet para jush.

Ky ligj ka qenë i përgatitur para disa vitesh dhe ka qenë në plan që të jetë i gatshëm edhe për vitin e kaluar, por për shkak të rrethanave globale nëse mund të ju rikujtoj është shtyrë për këtë vit dhe konsideroj që është bërë mirë që është shty për këtë vit sepse në kohën kur bankat e disa shteteve bankrotonin do të ishte goxha rrezik që ne të vijmë me këtë ligj në Parlament duke u ... nga efektet psikologjike që mund t’i kishte ky ligj.

Është formuar grupi punues i cili ka hulumtuar të gjitha detajet e këtij ligji së bashku me institucionet e rëndësishme ndërkombëtare gjegjësisht Bankën Botërore dhe fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ne kemi sjell sot këtu në Parlament për të aprovuar i cili sjell nëse mund të them ose ngritë sigurinë e qytetarëve të Kosovës për depozitat në sistemin bankar, edhe pse konsideroj që bankat e Kosovës kanë treguar një pjekuri të vetë .. sistemi bankarë në tërësi ka dhënë testin e vetë gjatë krizës më të madhe të njohur ndonjëherë në 70 vjetët e fundit. Shuma e cila do të sigurohet do jetë 2000 euro, ne jem të

vetëdijshëm se është një shumë e ulët por gjithsesi një vlerë e ulët, por gjithsesi këto janë mundësitë tona që tash për tash të bëjmë sigurimin e depozitave, por në të njëjtën kohë i tërë sistemi bankar është mjaftë mirë i siguruar përmes formave të tjera dhe i monitoruar saktë nga Banka Qendrore e Kosovës, e thash testi i parë është dhënë dhe unë besoj që të gjitha informacionet ne që i kemi sistemi bankar në Kosovë është vërtetë më i qëndrueshmi në regjion.

Ky ligj do të ndikoj në ngritjen e nivelit siç e thashë të depozitave besoj nëpër bankat komerciale të Kosovës, përmes këtij ligji parashihet krijimi i një institucioni të ri me stafin përkatës që do të merret me implementimin e mbarrëvajtjes së këtij ligji dhe bazuar në të dhënat aktuale sa i përket depozitave si dhe nivelin e sigurimit të këtyre depozitave do të duhet të kemi një fond prej 15 milionë euro, 5 milionë euro i ka afuar KfV-ja, pra Banka për Zhvillim e Republikës Gjermane si grand për themelimin e këtij fondi, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar që në vitin 2011 – 2013 t'i shtoj edhe 10 milionë euro. Sigurisht ky është fondi fillestarë ndërsa me rritjen e depozitave do të kërkohet edhe fond më i lartë.

Për të menaxhuar me këtë fond do të krijohet një njësi nëse mund të quaj jo një agjenci siç ka qenë ideja e parë në të cilën në baza ditore dhe në baza periodike do të kontrollohet dhe raportohet në Bankën Qendrore, mirëvajtja e menaxhimit dhe e investimeve të këtyre parave si dhe do të sigurohet që Bordi i Bankës Qendrore t'i jetë mbikëqyrës i vetëm ndaj këtij fondi i cili do të jetë tepër i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës.

Unë uroj që ky fond, në fakt, edhe ky ligj të kalojë sot në parlament. Është një nga diskutimet që i kemi pasur edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe besoj që do të jetë një nga plotësimet e kushteve që ne jemi zotuar që do t'i ndërmarrim. Nuk është kusht, si të them, prior action që thonë, pra, që duhet të aprovohet para 15 korrikut, siç janë buxheti dhe disa ligje të tjera, por është në kuadër të listave që është vendosur si kusht për të hyrë në program me fondin monetar ndërkombëtar, si nga ligjet e dëshirueshme që do të duhej të zbatoheshin në shtetin e Kosovës.

Gjithsesi konsideroj që çfarëdo kontributi që do të jepet nga ana e juaj dhe nga ana e ekspertëve të tjerë, do të pasurojnë këtë dhe ne do të jemi të gatshëm të reflektojmë gjatë diskutimeve në grupet parlamentare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Tani radhën e ka kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, është paraqitur kryetari, Gani Koci

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të komisionit, po edhe në emrin tim personal, si deputet, fillimisht dua të them që është një nga ligjet që kompletton atë që jemi mësuar të themi – kuadër ligjor që rregullon fushën financiare. Ndoshta pak i janë shmangur atij vargu, të rendit, të ngjarjeve që duhet të vijnë. Ne në Parlament kemi Ligjin për Bankën Qendrore, që e kemi në diskutim dhe në shqyrtim dhe pas atij ligji do të duhej të ishte Ligji për bankat komerciale, që janë institucione që pranojnë depozita dhe tek pastaj të na vjen Ligji për sigurimin e depozitave. Më sa di unë, është në proces te Qeveria, me gjithë akterët që ndihmojnë në këtë fushë, Ligji për bankat komerciale, sepse ne akoma do të veprojmë mbi bazë të do rregullave që janë të kohës së UNMIK-ut për sa u përket bankave komerciale dhe, po them, paraprakisht do të duhej të ishte këtu në shqyrtim, në Kuvend Ligji për bankat komerciale e tek pastaj Ligji për sigurimin e depozitave, por edhe si i tillë, ne duhet ta pranojmë, sepse është një ligj shumë i domosdoshëm që rregullon këtë fushë të sigurimit të depozitave, që nuk e kemi akoma dhe nuk e kemi pasur akoma. Prandaj, ka qenë ndoshta edhe një hezitim i personave fizikë, por edhe i personave

juridikë që mjetet e tyre t'i depozitojnë nëpër institucione që pranojnë depozita, siç janë bankat ose institucionet tjera financiare.

Ndoshta shkalla e sigurimit është e ulët në krahasim edhe me vendet e regjionit, të mos flasim me vendet e tjera të Evropës por, megjithatë, si nismë është e mirë dhe krahasimisht me mundësitë financiare që i kemi, mendoj se ky ligj duhet të pranohet dhe duhet të shqyrtohet shumë shpejt dhe të miratohet. Dua ta përmendi këtu, për informacionin tuaj, zoti ministër, ne edhe më herët kemi pasur një ligj për raportimet financiare, që ka qenë Ligji i kontabilitetit dhe raportime financiare, që është një nga ligjet që do të duhej të ishte moti i proceduar në Kuvend dhe mendoj se draftimi i parë është bërë dhe ne kemi pasur një listë të emrave të ligjeve të emërtimeve se cilat dhe në të cilën kohë duhet të vijnë. Prandaj, ne si komision sikur po jemi të zënë me punët që po e kryejmë një punë që është dashur ta kryejmë një tjetër para saj dhe në këtë formë sikur edhe po vonohen pastaj edhe amendamenti dhe miratimi përfundimtar i tyre. Pavarësisht prej kësaj, dua vetëm disa çështje që mendoj se ligjit i mungojnë ose nuk janë të qartësuar sa duhet.

Kemi të përkufizimet. Bankë, e dimë çka është bankë dhe atë e përcakton Ligji mbi Bankën Qendrore dhe të gjitha përkufizimet për institucionet financiare mendoj se duhet të përmbahen, duhet t'i ketë ai ligj dhe po na bien njëfarë përsëritje, sepse banka është bankë në secilin ligj ose kudo qoftë që përmendet ose një tjetër që për mua është shumë e pakuptueshme. Ne e kemi një definicion "e mundshme" dhe shpjegimi është, thotë, do të thotë një ngjarje e cila mund të ndodhë në të ardhmen dhe kjo është e vetëkuptueshme. Nuk di pse duhet të jetë e mundshme, e pamundshme. Këto lloj përkufizimesh që edhe në aspektin teknik edhe në aspektin gjuhësor janë të panevojshme dhe nuk do të duhej ngarkohej me çështje të tilla një ligj si ky.

Çështja tjetër është se neni 18 dhe 22 rregullojnë çështjen e organizimit të Bordit menaxhues të Fondit të sigurimeve. Unë mendoj, siç e thatë edhe ju, autoriteti qendror bankar është autoriteti i vetëm, autoritet i vetëm që menaxhon dhe duhet të menaxhojë me këtë bord, sepse në nenet më pastaj nuk përcaktohen përgjegjësitë, nuk janë të qarta përgjegjësitë e këtij bordi, nuk janë të qarta se cili do të duhej ekspertiza ose eksperiencia e tyre për të qenë dhe nuk janë të përcaktuara komplet përgjegjësitë dhe në njëfarë mënyre kujt i përgjigjet dhe kujt i jep llogari për këtë çështje. Ju e dini që në Ligjin për Bankën Qendrore, autoritet i vetëm, ta quaj, fiskal, agjend fiskal i Qeverisë dhe i shtetit, është guvernatori, do të thotë është ai që është në krye të bankës qendrore dhe konsideroj se mos po duplikojmë institucione brenda një institucioni dhe nuk përcaktohen qartë kufijtë dhe përgjegjësitë që mund t'i ketë njëri ose tjetri në këtë rast, sidomos të rastet, se kjo siguri i depozitave ka të bëjë me momentet kur institucionet financiare janë josolvente dhe atëherë duhet t'u kthehen atyre që kanë depozituar aty dhe vjen ai procesi i likuidimit, që është një proces i veçantë që është i përcaktuar në Ligjin për Bankën Qendrore në raste të insolvensës së institucioneve të ndryshme financiare. Prandaj, këto besojmë që në komision, bashkërisht po them, bashkërisht me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa t'i plotësojmë këto çështje dhe t'i definojmë qartë kompetencat e atyre që do të menaxhojnë me këtë fond të sigurimeve financiare dhe mundësitë eventuale të shfrytëzimit të këtij fondi ose të investimeve dhe, si të them, vendimet për investime të mjeteve që do të jenë nga ky fond, sepse fondi nuk është që të krijohet dhe të mbetet i ngrirë, si i tillë, por ai duhet të shfrytëzohet dhe ndoshta si fond i tillë edhe duhet të gjenerojë të hyra dhe për formën e gjenerimit ose të investimeve të këtyre mjeteve do të duhej vërtet të përcaktohej qartë kompetenca e kujt duhet të jetë, a e Bankës, a e Ministrisë, apo nuk dua ta ngatërroj tash këtu edhe Kuvendin, siç jemi mësuar, se Kuvendi duhet të jetë autoriteti i gjithëçkafit në rregullimin e çështjeve të caktuara.

Përndryshe, edhe si deputet, edhe si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Ligji është i pranueshëm dhe duhet të miratohet.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tani vazhdojmë me kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, është paraqitur deputeti Bahri Hyseni. Safete Hadergjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë. Me këtë Projektligj, Ministria e Ekonomisë dhe Financa gradualisht po përmbyllë objektivat e saj në hartimin e legjislacionit që ka të bëjë me rregullimin e sistemit financiar në Kosovë.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa kërkoi që t'i kemi dy ligje tjera, të cilat janë shumë të rëndësishme për rregullimin e kësaj problematike, të cilat shpresojmë që shumë shpejt do t'i kemi në shqyrtim edhe ato.

Në këtë projektligj rregullohet një fushë mjaft e rëndësishme dhe shumë e ndjeshme për interesat e qytetarëve, sepse rregullon sigurimin depozitave të personave fizikë dhe juridikë dhe është për t'u mbështetur nisma në këtë drejtim. Miratimi i këtij Projektligji kontribuon në ruajtjen apo në rritjen e besueshmërisë së institucioneve financiare dhe në njëfarë mënyre kontribuohet që tansakcionet financiare të kryhen nëpërmes bankës dhe të zvogëlohet qarkullimi i parave kesh.

Me këtë projektligj, institucioneve financiare që pranojnë depozita u kërkohet që të kenë sigurimin e depozitave. Po ashtu, rregullohet mbikëqyrja e likuidimit të institucioneve financiare që pranojnë depozita si dhe parashihet mënyra e formimit dhe mënyra e funksionimit të Fondit për sigurimin e depozitave në Kosovë. Projektligji shihet se ka implikime buxhetore, të cilat parashihen të mbulohen nga donatorët, për çka edhe ekziston marrëveshja me Qeverinë gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim për 5 milionë, kurse pjesa prej 11 milionëve parashihet të mbulohet nga qeveria.

Projektligji, edhe me deklaratën e cila na ka ardhur, i plotëson, është në harmoni me direktivat e Bashkësisë Evropiane.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, është i mendimit se në këtë Projektligji duhet të bëhen disa përmirësime teknike, gjuhësore, por edhe përmbajtjesore. Te përkufizimet, neni 2, pika 1.12, thuhet: "Fondi për sigurimin e depozitave në Kosovë", kurse në pikën 1.13 të këtij neni, thuhet: "Fondi për sigurimin e depozitave". Domethënë, janë tituj pothuaj se të njëjtë, edhe pse kanë qëllime pak më të ndryshme, sepse përkufizimi në pikën 1.13, Fondi i sigurimit të depozitave ka të bëjë me nenin 25, që i qaset investimit të aseteve të Fondit për sigurimin e depozitave, që mendoj se duhet rregulluar dhe duhet të qartësohet mënyra e investimit të mjeteve të fondit, sepse në ato dy pika të cilat janë të parapara në nenin 25 nuk qartësohet aq sa duhet një problematikë e tillë e investimit të fondit.

Neni 13, pika 2, për shkak të transparencës më të madhe është mirë po ashtu të caktohen saktë afatet dhe mënyra e raportimit dhe jo të mbetet, siç është në projektligj, që së paku një herë në vit raportohet dhe atëherë nuk dihet as se kur do të raportohet apo do të ketë raporte më të shpejta, kështu që për shkak të transparencës është mirë të definohet sa herë në vit duhet raportuar dhe cili është afati i raportimit nga ana e menaxhuesve të këtij fondi.

Neni 18 parasheh përbërjen e Bordit menaxheres. Në nenin 18.2.1 duhet të definohet që në Bordin menaxhues të jetë guvernatori apo ndonjë person tjetër i caktuar nga Banka Qendrore e Kosovës dhe

jo të mbetet këtu guvernatori ose dikush tjetër dhe nuk është e përcaktuar mirë se cili do të jetë ai anëtar, sepse ky anëtar do të jetë anëtar i përhershëm i Fondit për sigurimin e depozitave.

Po ashtu, në pikën 5 po të këtij neni thuhet se anëtarët e Bordit menaxheus të tjerë nga Banka Qendrore, do të shërbejnë për një mandat 5 vjeçar dhe do të kenë të drejtë rizgjedhje të njehershme. Është mirë edhe këto të qartësohen. Është fjala për mandatin 5 vjeçar të anëtarëve tjerë të Bordit, pa anëtarin e Bankës Qendrore dhe, nëse është kështu, atëherë duhet të caktohet edhe mandati i anëtarit të Bankës Qendrore dhe jo të mbetet në këtë mënyrë, siç është e paraqitur në këtë neni, sepse mandej do të shkaktohen konfuzione, çfarë mandati do të ketë anëtari i Bankës Qendrore, apo mund t'i jepet edhe një kuptim tjetër, mos po flitet për më shumë anëtarë të Bankës Qendrore që do të kenë mandatin 5 vjeçar dhe nuk është përcaktuar mandati i të tjerëve. Domethënë, është nen me dy kuptime.

Në nenin 18.8, që ka të bëjë me kompensimin e Bordit, duhet të definohet më mirë mënyra e kompensimit të bordit sepse, nëse mbetet kështu siç është e definuar në këtë pikë, do të ketë konfuzione në të ardhmen se si do të paguhet anëtarët e fondit. Është një fond i ndjeshëm që ka të bëjë me sigurimin e depozitave, prandaj është mirë të përcaktohet edhe mënyra e kompensimit të anëtarëve, në mënyrë pak më të qartë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrah në parim këtë projektligj dhe kontributin e vet do ta japë përmes anëtarëve të cilët i ka në komisionin funksional që do ta shqyrtojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sipas radhës, përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të LDK-së, është paraqitur Armend Zemaj, apo Myrvete Pantina. Deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Zoti kryesues,

Lidhja Demokratike e Kosovës, në parim e mbështet Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë. Ne mendojmë se ky projektligj është më se i nevojshëm për të rregulluar fushën në fjalë.

Me këtë projektligj shpresojmë se do të rritet siguria dhe besimi në institucionet financiare depozitare të Kosovës. Në bazë të këtij projektligji, në radhë të parë do të mbrohen interesat apo do të sigurohen depozituesit e vegjël, domethënë ata që kanë mjete të deponuara në institucionet financiare deri në 2000 euro dhe në qoftë se dështojnë institucionet financiare, atëherë do t'u kompensohen depozitat këtyre depozitorëve. Edhe pse me këtë projektligj bëhet një hap drejt harmonizimit me ligjet e BE-së, sipas *acquis communautaire* dhe Direktivës 94/19 ET, megjithatë nuk janë përmbushur të gjitha kriteret e parapara mbi skemat e depozitave të garantuara për arsye se, sipas s direktivës, limiti i garantimit të depozitave duhet të jetë 20.000 euro dhe më vonë për shkak të krizës globale financiare, ky limit është ngritur në 50.000 euro, gjë që nuk ka qenë e mundur, pra, të bëhet edhe në rastin e Kosovës për shkak se e dimë çfarë niveli të zhvillimit ekonomik kemi. Por megjithatë, mendoj se edhe kjo iniciativë fillestare, domethënë që siguri i mjeteve prej 2000 eurosh për mjetet e deponuara, është më mirë se sa të mos ketë asnjë garanci për mjetet e deponuara në institucionet financiare.

Në projektligj thuhet se duhet të bëhet menaxhimi dhe investimi i fondit të jetë i siguruar nëpërmes të opsionit më të mirë të mundshëm për investim në treg. Mendoj se ky definim duhet të qartësohet më mirë dhe të qartësohet konkretisht se cili është ai opsion më i mirë apo, thjeshtë, të caktohen kriteret në bazë të cilave do të zgjedhet opsioni më i mirë. Po ashtu, në nenin 13, thuhet se “kontributet fillestare do të mblidhen nga donacionet apo përmes mjeteve të tjera”. Mendoj se edhe ky nen duhet të

qartësohet, pra në mënyrë që të definohet qartë se cilat janë ato mjete tjera prej ku do të sigurohen mjetet për Fondin e sigurimit të depozitave.

Me gjithë këto vërejtje, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon që ky projektligj duhet të miratohet në parim dhe kontributin tonë do ta japim në kuadër të komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar atë AAK-së, deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Janë dy arsye pse Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështetë në parim këtë ligj. E para, sepse jemi për avancimin e sistemit financiar dhe rritjen e besimit të institucioneve financiare para depozituesve dhe arsyeja e dytë është se dëshirojmë që aktet tona ligjore që miratohen në Kuvend, të përafrohen dhe të barazohen me ato të Bashkimit Evropian.

Edhe pse po them në fillim, i kemi edhe ne disa dilema, sepse qoftë për kah përmbajtja, qoftë për nga dilemat që kanë mbetur të pazgjidhura, që disa u përmenden nga parafolësit, nuk është në tërësi që i plotëson kriteret për t'u miratuar, por mendojmë që këto mangësi mund të eliminohen në procesin e shqyrtimit nëpër komisionet përkatëse. Për ne është pak e paqartë pse është vonuar kaq shumë ky ligj, kur prej vitit 2007 ka pasur përgatitje dhe ka pasur edhe veprime konkrete. E dyta, desha të pyes pse në këtë dokument i kemi do dilema, më vonë në njëfarë forme u sqarua nga ministri, në deklaratën e Ministrisë së Financave për koston buxhetore thuhet që ka një kosto, një pjesë është mbuluar ose është premtuar nga donatorët dhe është arritur marrëveshja, pjesa tjetër duhet të sigurohet ashtu siç parashih Korniza afatmesme e shpenzimeve, për tri vite nga disa milionë, që mund të akceptohet, por në memorandum, të cilin memorandum e keni sjellë bashkëngjitur me ligjin, thuhet se nuk ka kosto shtesë buxhetore dhe është krejt okej, të hyrat tjera do të jenë nga burimet tjera. Cila është e vërteta, ju e thatë, por është një dokument prej jush, që mua më ka prurë në dilemë. Te memorandumi thjeshtë thuhet nuk ka kosto shtesë buxhetore, te vlerësimi thuhet që ka. Me këto vërejtje dhe, besoj, me ato të tjerat që po ashtu i konsiderojmë edhe si vërejtje tonat, në procedurë të miratimit do të jemi aktiv. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Ministër i Drejtësisë,

Deputetë të respektuar,

Kohë më parë e kam pas ngritur një mocion shkrimor për pyetje - përgjigje gojore dhe një mocion ia kam pas adresuar Kryesisë së Kuvendit, ndër të tjera për ta udhëzuar Qeverinë për ta përgatitur këtë dokument. Dua të them se në parim ky akt është i nevojshëm, sepse ndër të tjera stimulon depozitimet ligjore, transparencën dhe ngritjen e kapitalit financiar e tjera, domethënë është i dobishëm. Mirëpo, teksti nuk e kënaq kërkesën, sepse nuk është fjala së paku nga dispozitat, jo nga ekspozita e ministrit, që e dha, ai e dha korrekt, mirëpo nga dispozitat e këtij dokumenti nuk del ajo që sigurohen depozitimet, sepse po e marrim thjeshtë kësisoj. Depozitari është kreditori, depozitarrësi apo marrësi apo mbajtësi - debitori. Çfarë ndodhë në qoftë se depozitari bankroton, kollapson, shkon në likuidim, po e zëmë. Si do të siguroheshin depozitat e depozitarit? Nuk është dhënë përgjigje, ju lutem, ky është defekti kryesor.

Më pastaj, në qoftë se e marrim përmbajtjen e këtij dokumenti, del se do të duhet të titullohej ligji, jo Ligji, po e zëmë, e ky projekt është tash, për sigurimin e depozitave, po për Bordin menaxhues. Aq tepër i kushtohet kujdes bordit, sa që është e pakuptueshme, e pazezonueshme.

Janë disa formulime të paqëndrueshme kështu, apriori. Bie fjala, që e marrim të përkufizimet: “Administrator nënkupton një etnitet, themeluar sipas ligjit, që të marrë kontrollin mbi institucionin financiar, që pranon depozita sipas nenit 39 të Rregullores” e tjera, e tjera. Akti ligjor apelohet në dispozitat e rregullores. Po kjo është, domethënë, non sens, ju lutem. Rregullorja, tek e fundit, është akt nënligjor dhe e dyta, edhe po të ishte e karakterit ligjor, ajo rregullore mundet të pësojë ndryshime, e më pastaj do të duhej panevojshëm që automatikisht ta ndryshonim këtë ligj kur do të miratohej. Në vend që të merrej ajo përmbajtje, të formulohej edhe kesi sojit. Duket që hartuesit kanë qenë tepër dembelë edhe e kanë marrë një teknikë, cut and paste, preje edhe ngite aty dhe kështu.

Ka dispozita të paqarta edhe të tipit të referateve politike. Bie fjala, shembull konkret e marrim nenin 5, domethënë s’ka kurrfarë konotacioni juridik, akti ligjor duhet të dallohet me precizitet, me koncizitet, ju lutem, dhe me qartësi maksimale.

Neni 15, Kapitali. Nuk është dhënë definim edhe specifikim i qartë se është fjala për kapital minimal, rregullator, statusor apo çfarë kapitali. Më pastaj, roli dhe funksioni i këtij kapitali, se dihet fare mirë ç’është kapitali themelor statusor, minimal. Prandaj, këtu do të duhej riformuluar krejtësisht, duke iu dhënë kuptimi i qartë dhe funksioni qatë se, tek e fundit, kapitali i këtillë nuk bën të preket. Nëse do të binte nën te, do të duhej të suprimohej fondi, prandaj duhet t’i kushtohet kujdes i veçantë, ju lutem, riformulimit dhe dhënies së definicionit të destinuar.

Te neni 18, bie fjala, paragrafi 2, alineja 4, ja ç’thuhet: “BQK-ja duhet të emërojë Bordin menaxhues të FSDK-së dhe thotë: “anëtarin e pavarur, me përvojë ndërkombëtare”. Ky është një formulim që krijon bazë juridike për të bërë lojëra të pahijshme edhe të pashijshme. Por ç’është, ju lutem, le të tregoj dikush “përvoja ndërkombëtare”? Ne e dimë fare mirë që edhe në shtetet më të përparuara të botës së sotme ka institucione tepër joserioze. Prandaj, mund të ndodhë që të punojë kushdo, po e zëmë, që ta sjellë një letër se paska përvojë ndërkombëtare, e ne e dimë fare mirë se shpeshherë, jo rrallë herë, të tillët nuk dinë asgjë.

Neni 18, paragrafi 8, ja formulimi: “Anëtarët e Bordit menaxhues, përveç BQK-së, do të marrin kompensim nga fondi në formën e honorarëve për pjesëmarrje në takime dhe në raste të caktuara edhe kompensim për udhëtime dhe për akomodime...”. Akomodim mund të jetë vendosja në hotelin me 5 yje, e dimë ne çfarë çmimesh janë ato! Akomodime, këta duket se do të vinin prej jashtë apo s’po di se prej kah, apo jo, “...në përputhje me ato që merren nga personat që mbajnë pozita ekzekutive apo jo ekzekutive në bordet mbikëqyrëse apo menaxhuese, varësisht nga rasti, në institucionet e mëdha financiare që pranojnë depozita në rajon”. Do të thotë, këta do të ishin personat më të privilegjuar në vendin tonë, krejtësisht të ngjashëm me ata të Trustit Pensioinal Kursimor, që e kanë bazamentin juridik, që ju krijon status që të kenë paga sikur kolegët e tyre në Gjermani, a ne e dimë se Gjermania e ka GJDP-në e tretë në botë, ndërsa ne nuk e di sa e kemi, nuk e di se ku jemi, nën 100, po.

Me nenin 19, bie fjala, paragrafi ... thuhet: “Bordi menaxhues i fondit ka përgjegjësi për miratimin e emërimit të auditorëve të jashtëm të fondit”, do të thotë vet e përcakton, ia jap raportin, e korrupton, jep shkëlqyeshëm dhe atje krijon bazë juridike për të bërë abuzime, spekulime, malverzime më se të ndryshme dhe i mbulon me një letër të një auditori që vetë e financon, sepse e cakton vetë, apo do ta caktonte nëse nuk do të pësojë ndonjë ndryshim.

Neni 23, Sanksionet administrative: “Fondi do të përcaktojë dënimet e parapara për shkeljet sipas këtij ligji...” e tjera, e tjera, domethënë fondit i jepet roli legjislativ, zotëri kryesues! Ne e dimë se

kush cakton dispozita të tilla, vetëm legjislativi. Po në këtë rast do t'i delegoheshin nga ky legjislativ ingerenca, autorizime, paratagra, fondi që të caktonte sanksione.

Edhe te neni 29, paragrafi 2, është një formulim në kundërshtim me parimet themelore të përgjegjësisë. Kjo është e rregulluar kjo çështje nga e drejta romake, se mos të flasim me kodet civile. Thotë: “një punëtor apo agjenti i fondit nuk do të jetë përgjegjës për dëmet apo për aktet dhe lëshimet e kryera gjatë detyrës, përveç nëse ato akte apo lëshime të tilla përbëjnë sjelljet e këqija të qëllimshme”. Pa marrë parasysh, dëmtuesi kurdoherë është debitor përballë të dëmtuarit, ju lutem! Prandaj, kjo është rregull elementare, formulimi i tillë do ta amnistonte dëmtuesin, në këtë rast keqpërdoruesin, abuzuesin që mos të dënohej edhe për veprimet për të cilat qartas do të duhej të dënohej. Edhe përfundimisht, ju lutem me respekt, do të duhej të ishte dhe të inkorporohej edhe një kaptinë – Dispozitat ndëshkimore. Pa ato, ky akt do të mbetej, si të them, vetëm i karakterit moral që duhet të bëhet kësisoj, do të duhej bëhej kësisoj, sepse nuk do të ishte sanksion.

Në parim, këtë dokument ne e mbështesim, por ky akt është tipik, sikur shumë akte të tjera që po pësojnë më shumë projekt amendamente, se sa dispozita, më pastaj kur po miratohen, po dalin në kolizion dispozitat me këto. Prandaj, konkluzion i padiskutueshëm është që numër i madh i projektligjeve po na vinë tepër të dobëta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Synavere Rysha, zoti kryesues! Megjithatë, ju faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet, në parim, Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucioneve financiare, i cili si qëllim ka rregullimin e sigurimit të depozitave të personave fizikë dhe juridikë, themelimin e Fondit të sigurimit të depozitave në Kosovë dhe përcakton mbikëqyrjen e likuidimit të institucioneve financiare që pranojnë depozita.

Në tekstin e projektligjit vërehen disa dobësi dhe paqartësi, por duke pasur parasysh se e kemi mundësinë e përmirësimit në fazën e amendamentimit, për çka kontributi ynë nuk do të mungojë, nuk do të ndalem aty. Sidoqoftë, shqetësuese për ne mbetet çështja e vlerësimit të ndikimit buxhetor. Mungesa e buxhetit, çështje kyçe e cila vështirëson zbatimin në praktikë të këtij Projektligji.

Sipas nenit 13 të Projektligjit, do të jetë themeluar Fondi i sigurimit të depozitave në Kosovë, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhimin e Fondit për sigurimin e depozitave, fondi i pavarur, ashtu siç quhet. Kjo do një riformulim apo sqarim: “do të jetë themeluar”, çka nënkupton kjo? Është themeluar, do të themelohet apo është dashur të themelohet dhe ne mandej ta kemi ligjin. Këtu nuk ka një periudhë kohore, mirëpo kjo terminologji duhet ndryshuar. Mandej, kemi te neni 15, “Kapitali i autorizuar i fondit do të ë jetë 15 milionë euro”. Kontributet fillestare do të mblidhen nga donacionet apo përmes mjeteve tjera, nuk dihet në çfarë mënyre.

Thuhet se 5 milionë euro janë garantuar, janë siguruar grande nga Qeveria Gjermane, që duhet falënderuar donatorët, derisa burimet tjera, 11 milionë euro priten të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, por nuk tregohet se nga cilat burime të sigurohen këto mjete në buxhet. Dihet qartë, ndarje buxhetore për kapitalin e autorizuar të fondit për vitin 2010, nuk janë paraparë. Mendohet 1 milionë euro të sigurohen nga rishikimi, të paktën kështu thuhet në projektligj.

Pse po ndodhë kjo sikur Qeveria nuk e ka fare parasysh gjatë hartimit të buxhetit, nuk e harmonizon dhe nuk e ka parasysh agjendën e projektligjeve që do të ketë në vitin në vijim, mirëpo harton buxhetin pa e konsultuar mirë agjendën dhe përgatitë ligje apo sjellë në Kuvend ligje pa pasur

buxhet të mjaftueshëm për implementimin e tyre. Shqetësuese mbetet çështja, nëse mbështesim dhe e përkrahim sepse është mjaft i nevojshëm dhe i domosdoshëm, mirëpo sa do të ketë kjo kuptim kur do të ketë vështirësi, që në start shihet dhe është i paraprirë që ky projektligj të mos zbatohet në praktikë edhe për një periudhë të gjatë.

Sidoqoftë, problemet me menaxhimin e buxhetit po vazhdojnë, ndryshimet dhe lëvizjet buxhetore të qeveritarëve pa pëlqimin e Kuvendit po ndodhin, që vërtet kjo është për t'u ndëshkuar dhe për t'u ngritur si çështje brenda këtij Kuvendi, pse ndodhë ajo, sepse të paktën ligji e ndalon këtë rreptësisht dhe duhet të dënohen autoritetet që e bëjnë ndarjen buxhetore apo lëvizjen buxhetore brenda vitit pa pëlqimin e këtij Kuvendi. Megjithatë, te ne në Kosovë gjithçka ndodhë dhe ndoshta edhe ky ligj mund të zbatohet në praktikë sepse mund të lëvizin çështjet pa u konsultuar Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! në emër të Grupit Parlamentar "7+", fjalën e ka deputetja Mufëra Shiniq.

MYFËRA SHINIQ: Teşekkür ederim,

Kosovada finansman enstitülerin depozito güvenlik sisteminin oluşması Yasa Tasarısı Kosova için çok önemli bir yasa tasarısıdır. Oldukça iyi bir şekilde hazırlanmış görülmektedir, ancak madde 2.1.17de ortak cari hesabının açılmasında iki ya da fazla kişi eşit hakka sahip olurken, tek kişi adına açılacaktır. Denmesi burada kimine adına açılması öncüllüğünü gösterdiğine dair ek bir madde olmalıdır. Bu cari hesabının kapanması konusunda da hak sahiplerine bir kolaylığın, bir eşitliğin sağlanmasına dair bir madde olmalıdır, diye düşünüyoruz.

Bununla da hak sahipleri arasında sorun çıkmamasını garantilemektedir. Diğer uyarı ve önerilerimizi de Fonksiyonel komisyonlarına sunarak katkımızı vereceğiz.

7+ Parlamenter Grubu olarak bu yasa tasarısının birinci okunuşunu kabul etmekteyiz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, kush është? Mursel Halili

MURSELJ HALILJI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Dame i gospodo,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj nacrt zakona i u načelu će podržati isti. Smatramo da njegova usaglašenost sa zakonodavstvom Evropske unije je pozitivan plus, znači korisno. Takođe, ovim nacrtom zakona obezbeđuje se depozit i fizičkih i pravnih lica, naravno osniva se i fond i veoma bitna konstatacija je da se vrši nadzor nad likvidacijom finansijskih organizacija.

Možda je malo problematično oko budžetskih implikacija, obzirom da se na teret budžeta Kosova svaljuje negde suma od oko 11 miliona eura, mada je to parcijalno u godinama rapoređeno. Naravno, mi se slažemo sa ostalim primedbama koje su prethodnici izneli i možda jedna, jedan doprinos za sada jeste da u članu 1, u definicijama, znači u stavu 1.16 mislimo da je adekvatnije termin „osigurani rizik“ a ne „osigurani događaj“, obzirom da je događaj nešto što se još nije dogodilo, a rizik je nešto što je buduća i osigurava se za slučaj. Možda da se dogodi, ali ne mora. Možda bi bilo malo bolje precizirati pitanje izveštavanja, što su napomenuli neki od prethodnika. Sve u svemu, naša parlamentarna grupa će podržati ovaj nacrt zakona u načelu i, naravno, daćemo svoj doprinos radom u funkcionalnim komisijama. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala, na datu reč!

Pažljivo sam se trudila da slušam sve prethodne kolege, videla sam da su se maksimalno trudili da oko ovog Zakona daju svoje primedbe. Ja, u ime svoje Grupe za integraciju, mi smo pažljivo razmatrali ovaj zakon i mišljenja smo da je ovaj zakon preko potreban kosovskom tržištu finansija. Ovo je ustvari dvojni zakon, ili da kažem, sa ovim zakonom dobijamo dvojno knjigovodstvo, dvojno nadgledanje mimo Centralne banke svih finansijskih operatora na Kosovu.

Ovakvo dvojno nadgledanje je obaveza Evropske unije, obaveza evropskih zakona zato što bez dvojnog nadgledanja nema prave finansijske transparentnosti. Ovaj zakon znamo da dolazi na ime Direktive Evropske unije, koja je usvojena 1994. godine, koja je potvrđena 2008. godine, 2006. godine zapravo i u 2009. godini je ponovno obnovljena.

Ovaj zakon je jako važan iz jednog razloga što je odgovoran, ne samo ulagaču depozita ili onom koji uzima pozajmicu kao depozit, nego je i, da kažem, jedna od mera nadgledanja i same Centralne banke, jer odgovara Centralnoj banci, daje godišnji izveštaj Centralnoj banci i radi na jedan transparentan način i jedan je od zakona koji po prvi put daje obavezu osnivanja fondova. Ja sam više puta ovde naglašavala da bez osnivanja fondova nema prave finansijske kontrole. Zašto ovo kažemo? Iz prostog razloga, ako ne znamo u koji smo novčanik stavili sitan i krupan novac, onda ne znamo koliko novca imamo. Ovo je znači sve što je u sistemu Centralne banke, kruga i komercijalnih banaka, ovaj fond će biti obaveza osiguranja svih tih komercijalnih banaka i same Centralne banke koliko je u opticaju depozita na Kosovu.

Ovo pojačava prvo, da kažem, kontrolu sredstava koja se stavljaju u depozit, pojačava poverenje kod poverenika, dali je to pravno ili fizičko lice i ovo je jedan od zakona koji će u budućnosti, koji ima potrebu i namenu da smanji korupciju na Kosovu.

Ovaj zakon, znamo dobro da prvo, kao poverenje predstavlja povratak sredstva u depozitu, znači unutar 60 dana, za depozit najmanje od 2000 eura, koji će vraćati poveriocima depozita sa jednom sigurnošću da će svoj novac vratiti. Drugo, poverenje imamo da će to biti odloženo na 60 dana ili i u ratama i, treće poverenje imamo kada je u pitanju likvidacija finansijskog autoriteta, i dalje je poverioc osiguran od strane fonda. To što smo rekli kada je aplikacija budžetska za fond, verujte mi da je to, da se ja sada danas javno zahvaljujem Nemačkoj vladi na donaciji od 5 miliona nepovratnih sredstava, 11 svojih miliona, iz svog budžeta, da ovo trebamo što brže da uradimo da bi imali kontrolu na finansijskom tržištu. I jedan od obaveza koje su ovde definisane, jeste to što zakon sam nije strukturalno, malo je prilagođen kosovskim uslovima i malo je, da kažem, ublažen. Ovaj zakon na evropskom finansijskom tržištu ima jako veliku kontrolu, znamo da se na tom tržištu nalaze mnogi akteri, kao što je rekao gospodin, kolega Riza Smaka, da mi moramo da budemo osigurani od aktera koji se pojavljuju, da kažemo, tako divlje na tržištu, da se definiše u ovom zakonu sa kojim akterima, sa kojim udruženjima, sa kojim pravnim i fizičkim subjektima ima pravo ovaj fond u mreži osiguranja da bude u Evropi.

Znači, da to budu sertifikovani fondovi, koji će odgovarati kada su depoziti u pitanju. Mi znamo što se desilo sa dva naša depozita, kao što je depozit Kosovskog trusta, gde smo izgubili 130 miliona, znamo šta se desilo sa depozitom Agencije za privatizaciju, gde smo opet izgubili povereničkih 150 miliona. Da se to ne bih desilo, mi moramo da znamo aktere i prave činioce koji su zakonski legalizovani i registrovani na evropskom tržištu.

Jednu primedbu koju mi imamo trenutno, neću se obazirati na zakonu, jer puno je rečeno o zakonu, samo imamo jednu primedbu, kada je u pitanju najmanji depozit osiguran od 2000 eura, gde se kaže

da je uzet „bruto nacionalni dohodak Kosova“, ovo citiram, znači bruto nacionalni dohodak Kosova, limit za bruto nacionalni produkt pomnožen sa dva, što odgovara sumi od 2000 eura. Ja sam više puta dala ovde do znanja da imamo 1120 eura bruto nacionalni dohodak, međutim ovde je bilo tvrdnje da je to više, evo ponovo imamo od strane vlade i zakona da je to toliko, čak i manje.

Drugo, što znači da smo mi na jednoj, da kažem, ivici minimuma u Evropi. Drugo, što moramo da kod zakona obratimo pažnju, sa kojim ministarstvima i šta treba s kim da koordinira, mora dobro da se zacрта u Zakonu, sa dobrim članovima. Odgovornosti borda, zapošljavanje, kada je u pitanju zapošljavanje, imamo primedbu da se kaže u članu 22. gde je Upravni odbor direktora, kada je zapošljavanje u pitanju, tačka 1.7, kaže: „Zapošljavanje osoblja uz odobrenje upravnog odbora i u skladu sa ovim zakonom“, mora da se doda, ja dajem ovo, apelujem na funkcionalnu komisiju koja bude radila, posebno na naše članove koji su iz ostalih zajednica, da paze i da dodaju kao amandman „u skladu i sa Zakonom o zapošljavanju manjina“. Ovo su javne institucije i svako od naših predstavnika mora više da bude član ovih institucija.

Drugo, što je opet jako važno za nas, član 25, što sam dala do znanja kada je investicija sredstava fonda osiguranja depozita, znači fond daje osiguranje depozitu koji je osiguran kod njega i daje osiguranje depozitu koji je primio na čuvanje, kao što sam rekla, ovi fondovi koje sam spomenula kao rizične fondove i čitam član 2. „Fond može takođe investirati u kratkoročne, fiksirane obveznice prihoda ili obvezne instrumente deminovane u euro, izdate od banaka Evropske unije ili kompanija sa najvećim rejtingom definisano kao minimalni rejting kvaliteta od A1, P1“. To je rejting oplođenja, a ne gubljenja. Znači, ovaj fond ne može da investira sredstva sa rejtingom minus.

Moramo još neke stvari da definišemo kada su kaznene odredbe, koje nema u zakonu, što je žalosno, a ovde se najviše u ovom zakonu sprečava pranje novca. Mora da ima kaznene odredbe i zato treba da vodi računa funkcionalna komisija, neka malo prelista evropski zakon, neka prelista zakone u regiji a mi ćemo kao komisija, ja lično da dan neke inicijative i za neke članove koji moraju biti sastavni deo ovog zakona. Toliko od naše grupe. Hvala na pažnji!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për sigurimin e depozitave dhe ai për Bankën Qendrore të Kosovës, që është shqyrtuar në Kuvend, paraqesin ligjet më të rëndësishme për institucionet financiare në Kosovë. Pavarësisht se depozitat në bankat komerciale, të cilat veprojnë në Kosovë, janë burim kryesor i funksionimit të tyre, ato gjer më tani nuk janë siguruar me ligj.

Momentalisht, sigurimi i depozitave tek ne është bërë me një mbikëqyrje të bankave komerciale nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Mbikëqyrjen rigorozë dhe shpeshtimi i kërkesave për raportim nga bankat komerciale, janë vetëm një prej aktiviteteve në vazhden e objektivit primar, e që është mbrojtja e depozituesve.

Një mundësi e mirë e cila do të siguronte dhe do të rriste sigurinë e depozitave të personave fizikë dhe juridikë është miratimi i Ligjit të depozitave dhe krijimi i një Agjencioni për sigurimin e depozitave. Ligji për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave rregullon sigurimin e depozitave të personave fizikë dhe juridikë, qeverisjen e Fondit të sigurimit të depozitave në Kosovë, si dhe mbikëqyrjen e likuidimit të institucioneve financiare që pranojnë depozita. Objektivat e sistemit të sigurimit janë të dylllojshme. Së pari, objektivi primar i sistemit për sigurimin e depozitave është që të mbrojtë depozitarët nga humbja, në rast të paraqitjes së një ngjarje të siguruar dhe, së

dyti, objektivi sekondar i sistemit për sigurimin e depozitave është që të mbështesë Bankën Qendrore të Kosovës në rritjen e sigurisë, solvencës dhe funksionimin efikas të një sistemi stabil financiar.

Ligji që jemi duke e shqyrtuar themelon Fondin e sigurimit të depozitave në Kosovë, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve financiare që pranojnë depozita. Ky ligj është i harmonizuar me Direktivën evropiane 94/9 mbi skemat e depozitave të garantuara. Sipas ligjit të propozuar, garantohen depozitë-dhënësit se deri në vlerën 2000 do t'u kompensohen depozitat e tyre në rast të falimentimit të institucionit financiar që pranon depozita, ndërsa depozituesve me depozita mbi 2000 euro do t'u kompensohen gjatë një periudhe më të gjatë kohore, varësisht nga procesi i likuidimit të institucionit financiar që pranon depozita.

Në këtë aspekt, vërejtja thelbësore në këtë ligj është që, edhe pse i precizon këto çështje ligji, megjithatë mungon procedura e detajuar e realizmit të tyre, sidomos në procedurën e falimentimit dhe të likuidimit, gjë që është një pengesë shumë e madhe po qe se në procedurën e amendamentimit nuk përmirësohet një gjë e tillë. Kryesisht, vendet e zhvilluara kanë një limit më të lartë të mbrojtjes së depozitave apo të depozitave të siguruara, ndërsa vendet më pak të zhvilluara kanë limitin më të ulët të depozitave të mbrojtura.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji për funksionimin efikas të një sistemi financiar, stabil, avancimin e sistemit financiar dhe rritjen e sigurisë dhe të besimit në institucionet financiare, depozitë-marrëse, e mbështes Projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë, duke shpresuar se vërejtjet të cilat u theksuan në këtë shqyrtim, do të merren parasysh në komisionin funksional, veçmas për procedurën e falimentimit dhe të likuidimit dhe, në anën tjetër, siç u theksua edhe nga dy parafolës paraprak, se çështja e gjobave dhe dënimeve tjera, sanksioneve, domethënë, nuk është precizuar dhe nuk përmban, gjë që është një vërejtje thelbësore lidhur me këtë ligj. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Për hir të transparencës dhe të punës së deputetit, kam dëshirë që t'i jap disa vërejtje elementare, të cilat, ne si deputetë dhe Qeveria, besoj edhe ministri, nuk duhet t'i tejkalojmë në këtë projektligj.

Ne e dimë shumë mirë se tanimë kemi Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të referohemi tek rregulloret e UNMIK-ut, ndërsa nëse e shohim këtë ligj, e shihni nenin 2, nenin 8, neni tjetër është neni 5, po ashtu të cilët, të gjitha këto nene referohen me Rregulloren e UNMIK-ut, që nuk do të duhej të referoheshin në Rregulloret e UNMIK-ut, sepse ky është projektligj i ri. Sa i përket projektligjit, i cili autorizon bordin të hyjë në transaksione financiare, duke bërë investimin e mjeteve të fondit brenda apo jashtë vendit, duke dhënë apo marrë hua të brendshme apo të jashtme, pa autorizim të veçantë, në kundërshtim me Kushtetutën edhe ligjet në fuqi.

Kompetent për vendimmarrje për huat ndërkombëtare dhe transaksione të ngjashme financiare është ekskluzivisht Kuvendi i Kosovës, sepse në emër të Republikës së Kosovës mund të krijohen detyrime financiare vetëm përmes instrumentit të konventës ndërkombëtare, të ratifikuar në Kuvend me shumicë të cilësuar. Projektligji në nenin 21 parasheh formën e mbajtjes së takimeve dhe procedurën e vendimmarrjes së bordit, ku sipas paragrafit 7, mund të merren vendime vetëm me dy anëtarë të bordit. Ministër, asnjëherë në borde nuk mund të merren vendime prej 2 anëtarëve meqenëse bordi

përbëhet prej 5 anëtarëve, andaj vendimet duhet të merren nga një numër tek i anëtarëve të bordit, që do të duhej të ishte 3 anëtarë të bordit.

Projektligji përjashton mundësinë e mbikëqyrjes së punës së bordit, duke përjashtuar në heshtje edhe Auditorin Gjeneral, i cili funksionon në emër të shtetit nga mundësia e auditimit të punës së bordit dhe fondit të tij në atë mënyrë që autorizon bordin për angazhim të një auditori të jashtëm, me të vetmin kufizim që nuk mund të angazhohet më gjatë se 5 vite radhazi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

I dëgjuam edhe parafolësit, të gjithë kolegët, pak a shumë ndoshta, t'ju them të drejtën, mu duket se i ndryshoi edhe përmbajtja e këtij projektligji. E para dhe më e mira është se ky Ligj do ta plotësojë Rregulloren e UNMIK-ut për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e Bankës së Kosovës, pjesën ku flitet për depozitat apo sigurimin e depozitave financiare, ndërsa pjesën tjetër do ta plotësojnë ligjet që janë në procedurë dhe sigurisht ligji që do të vjen, sepse gjithë këtë fushë, edhe shpëlarjen e parasë, edhe Bankën Qendrore, bankat komerciale i mbulon kjo. Kjo është ajo që ne, në parim edhe e përkrahim. Është e kuptueshme që tani sistemi financiar është i qëndrueshëm për momentin, por mund të ... dhe duhet të krijojmë mekanizmat që në rast se ndodhë ndonjë falimentim apo humbje, të kemi ligj të qëndrueshëm.

Unë mendoj, sepse u thanë, u thanë shumica edhe në emër të Grupit Parlamentar, këtu janë dy çështje: Një, krijimi i Ligjit për sigurimin e depozitave dhe tjetra çështje duhet të jetë krijimi i besueshmërisë të depozitarëve në bazë të këtij ligji, si në bankat komerciale dhe në këto institucionet tjera financiare. Unë mendoj që edhe komisioni, edhe Qeveria, në këtë aspekt, Banka Qendrore, ndoshta do të fokusohemi dhe duhet të fokusohemi te shuma, sepse edhe sipas direktivave të BE-së, që tani po përmendet, minimalja është 20.000 euro dhe maksimalja pas krizës së fundit është 50.000 euro dhe mos të mbetet që ky ligj t'i sigurojë vetëm depozituesit e vegjël dhe ata ta ndiejnë veten shumë mirë nëse kanë depozitë, por edhe depozituesit e mëdhenj dhe njerëzit që krijojnë fonde pranë bankave komerciale, duke marrë parasysh sepse ky numër i vogël apo shuma e vogël, atëherë vjen edhe deri te kreditë, sepse ne nuk po mund e ulim akoma në Kosovë, norma e kredive është shumë e madhe, shkak kryesor janë fondet apo depozitat. Një çështje që është sensitive për mua, mbeten depozitat e Trustit Pensional të Kosovës. Ndoshta këtu duhet të kemi edhe kujdes në relacionin me Trustin Pensional, sepse prek direkt atë kategori. Kohëve të fundit Trusti ka investuar edhe në bankat komerciale dhe kur të merret parasysh se sigurimi është vetëm 2000 euro, atëherë krijohet një mos besueshmëri edhe e investitorëve, por edhe e taksapaguesve, në këtë rast kontribuuesve të Trustit Pensional. Personalisht mendoj që Kosovës i nevojitet, po e shohim që ne jemi më të fundit që e miratojmë, edhe pse ka qenë kjo Rregullore, që bëhemi me ligj në këtë çështje dhe kjo besoj që do t'i ndihmojë edhe zhvillimit ekonomik të vendit në të ardhmen. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Sanije Aliaj e ka fjalën.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Projektligji për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare të Kosovës konsideroj se është një ndër ligjet më të rëndësishme, sepse mundëson mbikëqyrjen rigorozë të depozitave të depozituesve në bankat e Kosovës për të siguruar një sistem stabil financiar, por edhe për sigurimin e besueshmërisë tek qytetarët e Kosovës për krijimin e fondeve financiare.

Natyrisht se projektligjin e përkrah, në parim, sepse e përkrah edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, por unë me këtë rast do të ndalem në nenin 18 të këtij projektligji, që konsideroj në dispozitën 4 të nenit 18, neni është, kjo dispozitë është diskriminuese. Unë do të bëj përpjekje të sqaroj pse është diskriminuese dhe i sugjeroj komisionit funksional që me këtë rast të ketë kujdes gjatë amendamentimit.

Neni 18 rregullon qeverisjen dhe përbërjen e Bordit menaxhues. Natyrisht se Bordin menaxhues e emëron Banka Qendrore e Kosovës për të menaxhuar Fondin e sigurimit të depozitave për institucionet financiare të Kosovës. Pra, me këtë rast, ky nen rregullon se fondi do të qeveriset nga një bord menaxhues prej 5 personash dhe do të jetë i përbërë nga 3 anëtarë fillestar, me të drejtë vote, dhe dy anëtarë tjerë, që nuk kanë të drejtë vote.

Njëri prej tyre është guvernatori i Bankës Qendrore ose një person tjetër i emëruar sipas detyrës zyrtare, përfaqësuesi tjetër është ekspert nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe përfaqësuesi i tretë, me të drejtë vote është ekspert nga Shoqëria e kontabilistëve dhe autoriteteve të certifikuara të Kosovës. Por, në paragrafin 2.4, që e përbën këtë bord, është anëtari i pavarur me përvojë ndërkombëtare. Pra, me këtë argument, unë konsideroj se ky nen është diskriminues, sepse mohon të drejtën e ekspertëve vendorë që nuk kanë mundësi të krijojnë këtë përvojë ndërkombëtare. Natyrisht se bordi për të qenë efikas, për të qeverisur këtë fond, ka të drejtën dhe të emërojë këshilltarë, që nuk kanë mundësinë për të pasur qasje në dokumentet zyrtare konfidenciale. Këto ishin ato vërejtjet e mia për këtë nen dhe kërkoj edhe një herë nga komisioni funksional që të përmirësojë paragrafin 4 të këtij neni. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Konstatoj që diskutime tjera nuk ka. Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, nëse dëshiron ta marrë fjalën. Ministri Ahmet Shala e ka fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë ju falënderoj për të gjitha kontributet që deputetët dhanë në këtë, mbase harrova të sqaroj fare në fillim se ky ligj është sponzoruar nga Banka Qendrore e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në fakt shumë pak ka qenë e involvuar në përgatitjen e tij. Andaj, do t'i kisha lutur komisionet funksionale që të ftojnë gjatë diskutimeve edhe Bankën Qendrore të Kosovës për çështjet e detajizuara, sepse konsideroj se ata kanë qenë sponsor të këtij dokumenti, të këtij Projektligji, që gjithsesi ne e mbështesim. Për detajet, sigurisht ekspertët e Thesarit me Ministrinë do të jenë së bashku me grupet funksionale dhe me grupet tjera të nevojshme për të diskutuar këtu. U ngritën disa pyetje sa u përket implikimeve buxhetore. Ne jemi zotuar që në vitin 2010 të kemi një angazhim minimal, edhe pse ... e ka kushtëzuar që të kemi të paktën 3 milionë euro, kështu që besoj që Qeveria gjermane do ta ketë parasysh edhe fondin, marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në parim jemi marrë vesh që në qoftë se Ligji aprovohet këtë vit dhe në qoftë se ne mund të qesim një gjysmë milioni euro, në vitin 2011, 2012 dhe 2013 nga 3,3 milionë, atëherë edhe ata do t'i hedhin 5 milionët e vet dhe konsideroj që gjithsesi ka ndikim buxhetor në vitet që pasojnë, ndërsa gjatë këtij viti i kemi harmonizuar këto qëndrime me Qeverinë gjermane dhe besoj që do të pranohet, edhe pse insistimi i tyre ka qenë që të jetë 3,3 milionë.

Arsyet e mosardhjes së këtij ligji, në fakt, i shpjegova në fillim në parlament, edhe pse ka qenë kohë më parë i përgatitur, ka qenë kryesisht kriza ekonomike, që ka qenë në vitin 2008-2009 dhe nuk kemi dashur dhe konsideroj që kemi bërë mirë që nuk kemi ardhur me debat sa i përket sigurimeve. Kur tani i mora shifrat e sakta, janë 1.248.212 veta në Kosovë që kanë depozita deri në 2000 euro, ndërsa gjithsej depozitues, pra qytetarë që depozitojnë, janë 1.331.000 veta. Shuma totale e depozituesve në Kosovë që kanë deri në 2000 euro, pra nuk përjashtohet që kanë edhe mbi, por deri në 2000 euro,

është 130.000.000 euro, që përfshinë rreth 7,6% të totalit të depozitave që është rreth 1.700.000.000. Pra, si pjesëmarrje në numër është 94%, ndërsa si pjesëmarrje në shumë, është rreth 7% . E di që shuma e caktuar është ende e ulët, është kusht i Unionit Evropian që të jetë 20.000 euro minimumi, por kur të hyjmë në Unionin Evropian. Andaj, kjo është mundësia maksimale që ne mund të ofrojmë tani dhe besoj që me përmirësimet dhe sugjerimet që u dhanë, të cilat sinjerisht i falënderoj shumicën e deputetëve apo të gjithë që kishin qëllimin e mirë, do ta mbështesim edhe ne si ministri gjatë punës në komisione. Ju faleminderit shumë për kontribute!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatoj që në sallë janë 65 deputetë dhe kemi kuorum për votim. Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tani:

Me 61 vota “për”, 4 abstenime, konstatoj që Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurime të depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Ju faleminderit! Na kanë mbetur edhe 4 pika të rendit të ditës. Propozoj një pauzë dreke deri në ora 15:00. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ne mund t’ia fillojmë. Ju njoftoj se sipas Rregullores së punës, kuorumi duhet vetëm në vendimmarrje. Debatin mund ta vazhdojmë edhe pa numër të caktuar të deputetëve.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010

Unë nuk jam gjuhëtar, por më duket këtu se disa agjencive ku po ua qesin emrin e Kosovës, kjo “Kosovare e Pronës” duhet të ndryshohet, të bëhet shqip, sepse nuk janë shqip, por nuk e di si janë me ligj.

Është mirë ta kemi parasysh për t’i ndryshuar ligjet, se vërtet nuk po tingëllon shqip. Vazhdojmë.

Komisioni Funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar, për miratim

Nëse e do fjalën kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi? Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar me vëmendje Raportin e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe me rastin e shqyrtimit ka konstatuar se Agjencia e Pronës me kohë e ka sjellë raportin në Komisionin për Legjislacion, e më pastaj ne e kemi përcjellë në Kuvend. Është me interes të theksohet se është raporti i bazuar në Ligjin aktual që është mbi Agjencinë dhe ju e dini që një kohë të gjatë ky Agjencion ka vepruar në bazë të Rregullores së faktorit ndërkombëtar dhe, tani kur po bisedojmë, në përbërjen e Agjencionit ka të stafit ndërkombëtar.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka qenë i interesuar t'i shohë të gjitha sfidat që i ka para veti Agjencia Kosovare e Pronës edhe për buxhetin, edhe për emërimet e bordit, edhe për profesionalizmin apo për mungesën e kapaciteteve në shërbimin profesional dhe gjatë shqyrtimit, bashkërisht me përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Pronës ka konstatuar se mandati i Agjencisë Kosovare të Pronës është për zgjedhjen e kërkesave pronëso-ro-juridike, të cilat një kohë të gjatë kanë qenë të zgjedhura nga një departament për çështje pronësore që ka funksionuar në kuadër të faktorit ndërkombëtar.

Mbi të gjitha, vlen të përmendet se një problem i qytetarëve të Kosovës është që kanë paraqitur shumë kërkesa. Deri më tani Agjencia Kosovare e Pronës ka pranuar mbi 40.000 kërkesa, që është sfida për Agjencinë t'i shqyrtojë brenda afateve, kur edhe qytetarët e Kosovës kanë nevojë ta zgjidhin problemin e pronësisë. Kërkesat kanë të bëjnë për çështje të ndryshme të pronës, edhe për pronën komerciale, edhe për pronën private, por edhe për pronat tjera dhe sidomos për pronat të cilat kanë qenë diskutuese gjatë kohës së luftës në Kosovë, luftës së fundit në Kosovë të vitit 1998-99, kur shumë njerëz paraprakisht, domethënë qytetarë të Kosovës gjatë kohës kur ata kanë punuar nëpër institucione publike, janë larguar, më pastaj këto prona kanë qenë të uzurpuara.

Vlen të përmenden se janë dy probleme të cilat i kemi hasur si komision, për të cilat kërkojmë që Qeveria e Kosovës të intervenojë. E para, Ju e dini që Kuvendi i Kosovës ka refuzuar propozimin që ka ardhur për emërimin e dy anëtarëve vendorë të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë dhe pothuaj nga kjo ditë ende mbetet situata e njëjtë. Agjencia vepron pa anëtarë të bordit ekzistues, prandaj i rekomandojmë Qeverisë së Kosovës, që është edhe në rekomandimet përfundimtare të kësaj, që sa më parë, konform Ligjit në fuqi t'i rekomandojë anëtarët vendorë që të jenë anëtarë të bordit, sepse është një dilemë madhe dhe është një problem në vete që është pa fajin e Agjencisë. Çështje tjetër me interes është që zyrat të cilat kanë qenë funksionale në Beograd, janë mbyllur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe kjo ka sjellë një situatë që e ka ndërlikuar procesin e ndihmës sa i përket dokumentacionit, i cili aktualisht nuk është në Kosovë.

Prandaj, duke i pasur parasysh këto sfida që i përmenda, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka marrë vendim që Kuvendit të Kosovës në këtë seancë plenare t'i propozojë këto rekomandime. Domethënë, jemi pajtuar të gjithë se raporti është në nivel dhe rekomandimi i parë është të aprovohet Raporti i punës së Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2009. Pika e dytë e Rekomandimit është që të kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës të emërohen anëtarët e Bordit mbikëqyrës të AKP-së sepse, ju thashë, është sfida shumë e madhe dhe në mungesë të bordit ka vështirësi Agjencia t'i shqyrtojë dhe aprovojë edhe politikat që i ka para vetës dhe, nën 3, t'i ofrohet një mbështetje

institucionale Agjencisë Kosovare të Pronës, jo vetëm nga Qeveria e Kosovës, por në këtë rast edhe nga Kuvendi i Kosovës dhe nga faktori ndërkombëtar për ta rifunksionalizuar Zyrën e Agjencisë së Pronës jashtë territorit të Republikës së Kosovës, fjala është për Beogradin dhe zyrat tjera të cilat i ka pasur të vendosura jashtë territorit të Kosovës.

Në fund, unë kërkoj që deputetët ta aprovojnë raportin dhe rekomandimet të jenë të zbatueshme pas vendimit që do ta marrë Kuvendi i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Këta të buxhetit nuk e kërkojnë fjalën? Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Raportin e Agjencionit Kosovar të Pronës dhe vërtet shihet se raporti është më shumë një pasqyrim numerik i gjithë punës së Agjencionit, duke filluar nga bordi, stafi, mandej kërkesat, natyra e kërkesave dhe duke pasur parasysh se vërtet ky fushëveprim është i natyrës së veçantë për jetën e qytetarëve, e cila vërtet kërkon profesionalizëm të madh dhe kërkon përkushtim serioz të gjithë Agjencionit. Nga pasqyrimet nuk mund të shihen vërtet detalet se cilat janë pengesat, por në raport si pengesë kryesore paraqitet mosfunksionimi i zyrave jashtë Kosovës dhe mos kompletimi i bordit, i cili është obligim i institucioneve të Kosovës, Qevrisë, përkatësisht Parlamentit.

Duke pasur parasysh krejt këtë specifikë, këto janë të paraqitura vetëm në nivel të regjioneve dhe komunave, pa detale tjera, megjithatë ne si Grup Parlamentar mendojmë se duhet përkrahur rekomandimet e komisionit funksional dhe e mbështesim si të tillë. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e punës, Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2009. Mendojmë se raporti përmban informata të mjaftueshme për aktivitetin e AKP-së për periudhën e raportimit dhe çështjet që trajtohen janë mirë të pasqyruara edhe në aspektin financiar, pasqyrat financiare, duke marrë parasysh se ky financohet edhe nga donatorët e jashtëm.

Sfida kryesore mbetet trajtimi i kërkesave të qytetarëve për pronën bujqësore dhe komerciale dhe pronën e paluajtshme private, prandaj kjo mbetet sfidë për Agjencinë dhe ne e çmojmë punën dhe angazhimin e tyre në këtë drejtim.

Grup Parlamentar i LDK-së e përkrah raportin, në parim, dhe njëherësh iu jep mbështetje rekomandimeve që dalin nga komisioni funksional, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Donika Kadaj – Bujupi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në parim e mbështet këtë raport mirëpo, kuptohet, me disa rekomandime dhe vërejtje. E para, u tha edhe më herët, më 25 qershor 2009, ky Kuvend ktheu prapa propozimet e kryeministrit për nominimin e tre zyrtarëve të bordit, tre anëtarëve të bordit. Një vit pas, ende vazhdon që ky bord të funksionojë pa anëtarët vendas dhe ne e konsiderojmë që kjo është e papranueshme dhe flet për mentalitetin qeverisës të kësaj Qeverie, të cilët me çdo kusht tentojnë që anëtarët e të gjitha bordeve të agjencioneve të pavarura të jenë të emëruar politik dhe, nëse ky Kuvend në një rast sikurse me datën 29 qershor të vitit të kaluar vendos ndryshe, atëherë le ta pësojnë bordet, le ta pësojë procesi dhe kurrsezi nuk mund të dilet nga ky mentalitet i një anësie, i një përshtatshmërie dhe militantizmi politik. Prandaj, konsiderojmë se është shumë për keqardhje dhe kërkojmë që sa më parë t'i kemi emrat e anëtarëve vendorë, sepse kemi njerëz profesionistë vendorë të cilët duhet të jenë në këtë bord.

E dyta, lidhet me kapitullin 6 dhe skemën e qiradhënies, e cila thotë: “Skema shërben për të ofruar mbrojtje ligjore dhe fizike për pronën e braktisur banesore, duke siguruar burim minimal të të ardhurave për bartësit e të drejtës pronësore, të cilët përndryshe mund të vendosin t'i shesin shtëpitë e tyre”. Ne kërkojmë që ky parim dhe këto standarde dhe ky rregull të aprovohet edhe në pjesën veriore të vendit, të zbatohet atje, edhe shqiptarët që jetojnë në pjesën e veriut të Mitrovicës të marrin qira për pronat e tyre të cilat janë të uzurpuara dhe të mos kemi standarde të dyfishta ashtu siç po vazhdon të ndodhë. Do të thotë, këto janë dy rekomandime për Kuvendin dhe për Qeverinë. Qeveria duhet të gjejë mjete shtesë, nëse do të thotë me këtë buxhet është e pamundur që t'ua paguajë qiranë qytetarëve të pjesës veriut të Mitrovicës, të cilët e dinë që po ballafaqohen me sfida të shumta për mbijetesë në mungesë të zbatimit të kësaj rregulloreje dhe të këtij kapitulli 6. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AKR-së, kush e do fjalën? Deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,
Deputetë të respektuar,

Nga përmbajtja e Raportit vjetor të Agjencionit Kosovar të Pronës për vitin 2009, ndër të tjera përvijohet dhe del në pah predominant komponenti politik mbi juridikën. Kjo është një sfidë irrituese në përgjithësi, një.

Dy, çështja e pronave në vendin tonë është një ndër çështjet më të rëndësishme dhe më të ndërlikuara dhe këtë në asnjë mënyrë Agjencioni kosovar nuk ka kompetenca për ta zgjidhur as përafërsisht. Prandaj, në këtë kontest edhe apropos me këtë, edhe në këtë rast do të isha angazhuar që të përgatisim një dokument për pronat, se është një temë e hapur dhe ka shumë raste juridike civile, e kjo Agjenci është organ administrativ, nuk mund të zgjidhen çështjet pronësore nga Agjencia, nga organi administrativ, po nga gjyqësorët. Prandaj, në koncept është çështja. Sa iu përket të dhënave, Grupi Kuvendor i AKR-së e miraton në parim këtë raport. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të LDD-së, deputetja Qamile Morina e ka kërkuar fjalën.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se edhe pse është hera e parë që raportohet në Kuvend për punën e Agjencionit të Pronës, Raporti shumë qartë dhe në mënyrë të detajizuar pasqyron punën, sukseset, sfidat dhe mangësitë që po e përcjellin këtë agjencion.

Është hera e parë që e kemi në Kuvend një raport të tillë, nga se gjer para shpalljes së pavarësisë, ky Agjencion ka qenë një organ ndërkombëtar i mbikëqyrur nga UNMIK-u dhe tani sipas infrastrukturës së re ligjore, tashmë është institucion i Kosovës. Mirëpo, duhet theksuar se natyra dhe funksionimi i

Agjencioni t'ri realisht nuk ka ndryshuar me ligjin e ri, gjithmonë duke pasur parasysh respektimin deri në përfundim të mbikëqyrjes së zbatimit të propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës.

Në këtë kontekst, vlen të përmendim se të gjitha emërimet dhe obligimet ligjore që i ka pasur Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, janë kryer me kohë, mirëpo pala që do të duhej të kishte interes të lartë në përmbushjen e obligimeve ligjore, pikërisht janë institucionet tona dhe ato sot e kësaj dite nuk arriten të kompletojnë Bordin mbikëqyrës të AKP-së, i cili është përgjegjës për linjën e veprimit të këtij agjencioni, si dhe emërimin e zëvendës drejtorit ekzekutiv të AKP-së.

Duke pasur parasysh që ky agjencion merret me zgjedhjen e kërkesave mbi pronën private, bujqësore, komerciale të qytetarëve të vendit tonë, qasja e institucioneve tona edhe pas më shumë se dy vite pavarësie, është tejet joserioze gjer në shkallë të injorimit në mos përmbushjen e obligimeve ligjore për emërimin e përfaqësuesve vendorë. Sfidë tjetër në punën e këtij agjencioni është mbyllja e zyrave të AKP-së në Serbi, në qershor të vitit 2008 nga Qeveria e Serbisë.

Kemi mjaft dilema lidhur me arritjen e Memorandumit të mirëkuptimit në mes të UNHCR-it dhe AKP-së, që në Serbi të hapen zyrat e UNHCR-it që do të kishin funksion të qasjes në arkivat e zhvendosura pronësore. Gjithashtu, konsiderojmë se sfida e madhe do të mbetet për këtë agjencion zbulimi i gabimeve të notifikimit të pronave dhe kjo kryesisht i atribuohet mungesës së të dhënave kadastrale adekuata në atë kohë. E konsiderojmë sukses arritjen e nënshkrimit të Memorandumit të mirëkuptimit në mes Agjencisë së Pronave dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si dhe avancimin e këtij agjencioni me pajisje për identifikim, si GJPE, sistemi i navigacionit dhe sistemi elektronik i hartave do ta lehtësojnë punën e identifikimit në të ardhmen.

Administrimi i pronës, si dhe skema e qiradhënies vullnetare, fatkeqësisht nuk gjeti zbatueshmëri në Mitrovicë, andej lumit Ibër. Edhe pse gjatë vitit 2009, u arrit një Memorandum mirëkuptimi me Policinë e Kosovës për mbështetje të Policisë së Kosovës për zbatimin e urdhër dëbimeve të skemës së qiradhënies në këtë pjesë të Mitrovicës, është larg asaj që u arrit në interval shumë të shkurtër tek mitrovicasit këndej lumit Ibër. Andaj, është më se frustruese për mitrovicasit qasja jo serioze dhe papërgjegjësi e Qeverisë, moszgjidhja e dy anëtarëve të Bordit mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronave, që është dashur para dy viteve të emërohen, si dhe mungesa e zgjedhjes së gjyqtarit vendor që po e paralizojnë punën e këtij paneli. Kjo ka pasur reperkusione tek qytetarët e Mitrovicës, se që nga viti 2008 Agjencia nuk ka mundur të bëjë asnjë lirim të pronës në pjesën veriore të Mitrovicës, ku kryesisht janë të uzurpuara pronat tona.

Aso kohe kanë qenë të evidentuara 512 prona të shqiptarëve në pjesën andej Ibrit dhe në këtë raport nuk kemi hasur se sa prona kanë mbetur pa u shitur gjatë kësaj periudhe. Me shumë përgjegjësi e them se shteti i Kosovës kurrë nuk u përkujdesë për shumë mitrovicas që ende kanë pronën e tyre të pa shitur, e jetojnë nën marginën e ekzistencës sot.

Në fund, Lidhja Demokratike e Dardanisë e mbështet Raportin e Agjencionit të Pronës si dhe kontributin e donatorëve në buxhetin e këtij agjencioni, me kërkesë që institucionet tona të këndellen dhe sa më shpejt t'i kryejnë obligimet ligjore në raport me këtë agjencion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Bağımsız Kurul Meclisimize ilk defa böyle bir Raporla çıkmaktadır. Dolayısıyla kimi uyarılarımız bulunmaktadır. Kurul üyeleri ile ilgili atamalarda tüm bağımsız kurullarda eşit muamelenin

uygulanması gereği görülmektedir. Özellikle Kosova dışındaki ofislerin işlevsel olmayışına rağmen Raporun gerekliliği yine de komisyon başkanı tarafından da ifade edildiği gibi özellikle vatandaşların büyük taleplerine yönelik ihtiyaçları da göz önünde bulundurarak var olan eksikliklere rağmen 7+ Parlamenter Grubu Raporu desteklemektedir. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjala është për deputetin Petar Miletiq.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Tema kojom se bavi Agencija za imovinu od velikog je značaja, posebno za zajednicu koju predstavlja ova naša Poslanička grupa. U ovom izveštaju, ono što sam primetio da nedostaje, jeste broj uspešno rešenih slučajeva, odnosno koliko je građana koji su imali zahtev kod ove Agencije, uspešno rešeno, dakle koliko je građana ušlo u posed imovine, bilo da se radi o zemljištu, stanovima ili kućama. Takođe, u ovom izveštaju ne postoji nijedna reč koja govori o tome na koje je probleme ova agencija nailazila kod nerešenih slučajeva, ustvari ne znamo ni koliko ima takvih slučajeva, tako da bi bilo dobro da znamo koji su to specifični problemi na koje je ova agencija naišla prilikom vraćanja imovine pravim vlasnicima.

Obzirom da sam i lično žrtva uzurpacije imovine, hteo bih da se osvrnem na tačku 5. odnosno poglavlje 5. ovog izveštaja i to tačnije 5. tačka 5, gde se govori o podršci Kosovske policije u sprovođenju odluka. Mislim da bi bilo dobro da ovakav jedan izveštaj sadrži i proveru implementacije rešenih slučajeva. Dakle, u tački 5, tačka 5. postoji da je potpisan Memorandum razumevanja između EULEX-a, Kosovske policije i Kosovske agencije za imovinu, 19. oktobra 2009. godine, i da je rešen problem podrške Kosovske policije.

Pa tako u tački 6.2.2. stoji da kada dolazi do iseljenja, kada se ono zakaže, ono ne može da se odloži osim u izuzetnim prilikama, isključivo uz odobrenje izvršnog direktora Kosovske agencije za imovinu ili njegovog zamenika. Opet moram da kažem, i ako ne bih, nije mi namera da privatizujem ili da na svom ličnom primeru govorim o tome, ali prosto bio sam u prilici da se u Peći obratim policiji koja nije odradila svoj posao i koja nije uspela da reši ovaj problem i iseljavanje je obustavljeno i ako bez odobrenja izvršnog direktora ili njegovog zamenika, kako stoji u ovom izveštaju. Verujem da neko ko je poslanik u ovoj Skupštini, u najvišem domu, ako ja imam ovakve probleme, kakve probleme imaju obični građani, da tako kažem, koji žele da dođu ponovo u posed svoje imovine.

Mi zaista snažno podržavamo Kosovsku agenciju za imovinu, da rešava probleme imovine svih građana, bez obzira na njihovu etničku pripadnost, kao što sam ovde čuo i Albanaca koji žive na severu, oni moraju takođe da dođu u posed svoje imovine, tako i Srbi južno od Ibra moraju da dođu u posed svoje imovine.

Ja verujem da Kosovska agencija za imovinu zaista čini sve što može da reši ove probleme međutim, kažem još jednom, bilo bi dobro da imamo ovde u izveštaju šta su njihovi izazovi, jer mi zaista ne znamo na koji problem oni naiđu kada ne reše slučaj. Takođe, još jedan možda ne tako važan detalj sam uočio, ali recimo u opštini Peć ima 13.821 slučaj. To je duplo više nego recimo u drugoj po redu opštini, kada su u pitanju potraživanja prava. Dakle, očigledno je da u opštini Peć nešto ne funkcioniše kod Kosovske agencije za imovinu, tako da bi ova agencija mogla da preispita rad tog odeljenja koje se nalazi u Peći.

Naš Poslanički klub će po savesti glasati o ovom izveštaju, kažem izveštaj i nije toliko loš, ali bi Kosovska agenciju za imovinu mogla da radi mnogo bolje. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Grupi për Integritet, Vladimir Todoroviq e ka fjalën.

VLADIMIR TODOROVIC: Hvala, gospodine predsednice!

Mislim da je pravo pitanje došlo na pravo mesto. Kada je u pitanju uzurpacija nepokretne imovine, sigurno da ima tu problema i kao što su rekli, jedna poslanica je rekla ovde da ima i u severnoj Mitrovici, sigurno ga ima i južno od Ibra. To su veliki problemi, očito da sva ova oštećena lica koja upravo kada se radi o stanovima ili o zemljištu obradljivog karaktera, tu krivicu snosi i sud, Opštinski sud. Kada dođu do suda, došli su na suprot..., naime radi u interesu uzurpatora a ne u interesu pravog vlasnika. Nedavno je jedan građanin došao kod mene i požalio se po tom pitanju. Da ne bi mnogo pričao, rekli su prethodni diskutanti, to je dobro pitanje da je došlo ovde u Skupštini i Poslanički klub za integritet u načelu podržaće takav izveštaj. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pra, grupet parlamentare i kryen minutat e tyre. Të lajmëruar për debat ose diskutim i kemi edhe 4 deputetë. Unë kisha kërkuar nga deputetët që do t'i ftoj, le t'i rumbullakojnë nja 3-4 minuta më shumë, mendoj se mjaft mund të thonë. Po shkojmë sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryetar!

Kam frikë, në qoftë se nuk i bëj katër minuta, të më falësh!

Raporti që po e trajtojmë në përgjithësi përmban informacione të mjaftueshme për aktivitetet e Agjencisë së Pronës, mbi të arriturat për vitin 2009. Të dhënat aktuale 2009, krahasuar me ato të viteve paraprake, tregojnë nivele të kënaqshme dhe rritje të performancës, sidomos në zgjidhjen e një numri të madh të kërkesave, kontesteve të parashtruara ndaj AKP-së. Në aneksin B të dokumentit, statistikat mbi vendimmarrjen e kërkesave tregojnë një gjë të tillë. Për shembull, kërkesat e vendosura qershor 2007 janë: 498, ndërsa në qershor të vitit 2009 janë 24.777. Fakti se nga 31 dhjetor 2008 përfundoi efekti juridik i Rregullores së UNMIK-ut dhe i njëjti mbështetet plotësisht në Ligjin e Kosovës, duke u bërë kështu legjislacioni i vetëm mbështetës i AKP-së, përveç eliminimit të ... politike, fuqishëm ndikojnë në harmonizimin dhe fuqizimin e bashkëveprimit reciprok në mes të institucioneve relevante vendore dhe pranisë ndërkombëtare.

Pjesa e raportit ku i referohet mandatit të strukturave organizative dhe shtrirjes së AKP-së, ofron informacion të mjaftueshëm për organizimin dhe funksionimin e AKP-së. Me të gjitha të arriturat, raporti vë në dukje mungesën e dy anëtarëve të Bordit mbikëqyrës të AKP-së dhe atë të zëvendësrejtorit të AKP-së, që janë çështje thelbësore, që kanë mbetur pa zgjidhje. Pozitat në fjalë plotësohen me propozimin e kryeministrit dhe më pas emërimi nga Kuvendi i Kosovës. Megjithëse një gjë të tillë kryeministri e kishte bërë me kohë më parë, Kuvendi kishte refuzuar propozimin e tij. Pyetja: Pse kjo çështje zvarritet që nga 25 qershori 2009, dhe kur pritet të ketë zgjidhje?

Një tjetër shqetësim mbetet prania e AKP-së në Serbi, zyrat e së cilës atje vazhdojnë të janë të mbyllura që nga qershori 2008. Megjithëse memorandum i mes AKP-së dhe UNCHR-it që do t'i lejonte kësaj të fundit hapjen e zyrave në Serbi dhe kryerjen e të njëjtave funksione në llogari të AKP-së, mbetet në pritje të vendimeve të autoriteteve serbe. 40.500 është numri i kërkesave pronësore të pranuar nga Serbia dhe Mali i Zi, 90% prej tyre janë vetëm nga Serbia, moszgjidhja e të cilave, siç potencon raporti, ndikon dukshëm në nivelin e realizimit të synimeve të përgjithshme të agjencionit.

Sugjerim: Të bëhet presion mbi autoritetet serbe në Beograd që të fillojë hapja e këtyre zyrave, nëse jo, atëherë të gjenden format alternative në kryerjen e procedurave të nevojshme. Kjo më shumë se çdo kujt tjetër do t'u shërbente vetë qytetarëve serbë, por edhe AKP-së, si palë e rëndësishme dhe e interesuar për zgjidhjen e këtyre kontesteve pronësore. Pjesa që i trajton kryesisht procedurat e

pranimeve dhe të njoftimit të palëve, të dhënat tregojnë se deri në dhjetor 2007, janë regjistruar rreth 38.335 kërkesa. Gjatë periudhës së verifikimit të kërkesave janë hetuar lëshime të shumta që janë vërejtur tek pas identifikimit dhe inspektimit të ngastrave të caktuara. Si rezultat i kësaj, numri i kërkesave është rritur në 40.318. Kjo flet mjaft për efikasitetin dhe ngritjen e përgjegjësisë profesionale të AKP-së, që duhet përshëndetur gjithsesi. Të dhënat e ofruara në raport tregojnë se numri më i madh i kërkesave pronësore ka të bëjë me tokat bujqësore – 36.139, 1000 janë për pronat komerciale dhe rreth 3.179 kanë të bëjnë me pronat banesore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe njoftimeve mbi kërkesat, që përveç formës individuale të palëve të përfshira në kontekst, bëhen edhe përmes gazetës së AKP-së.

Sugjerim: Për hir të transparencës, të rritet tirazhi i gazetës së AKP-së, që tash është 20.000 copë, së paku në nivelin e kërkesave pronësore të përgjithshme, që janë rreth 40.318. Edhe pse buxheti vazhdon të jetë problem serioz, në këtë aspekt duhet inkurajuar donatorët, eventualisht të dedikohet buxhet shtesë nga buxheti i Kosovës në favor të rritjes së tirazhit të gazetës.

Te përpunimi i kërkesave që ofron kapitulli i tretë të hartuesit të dokumentit, duhet specifikuar se cilat janë format alternative që kanë gjetur, që ka gjetur AKM-ja për të zvogëluar, respektivisht zgjidhur një numër aq të madh rastesh, kontestesh pronësore, duke konsultuar arkivat e pronës të zhvendosura në Serbi. Konkretisht, qenka mbyllja e zyrës në Serbi, thuhet se në raport se nga 3.500 kërkesa të pazgjidhura, tashmë vetëm 226 kanë mbetur në pritje të verifikimit atje. Si dhe në çfarë mënyre është bërë kjo?

Pjesë e veçantë e raportit i kushtohet vendimmarrjes dhe Komisionit për kërkesa pronësore, që rregullohen kryesisht me legjislacion aktual, me ndihmë dhe format e ekzekutimit të tyre. Po ashtu, edhe zbatimi i vendimeve të marra trajtohen në vijimësi të raportit. Shifrat tregojnë se deri në fund të raportit, AKP-ja ka shpërndarë 10.199 vendime. Duhet potencuar rolin shumë të rëndësishëm të Policisë së Kosovës në mbështetje të vendimeve të marra, kryesisht me rastin e dëbimeve dhe relacionet shumë të mira të bashkëpunimit me agjencitë dhe institucionet tjera relevante.

Raporti informon qartë edhe për skemat e qiradhënies vullnetare dhe të administratës së pronës. Sugjerojmë: të kihet parasysh gjendja e rëndë sociale e disa familjeve të cilat ... pasojë e mungesës së vendstrehimit të përhershëm që gjejnë në pronën publike. Në disa raste, në shumë rajone të vendit, ndërhyrja brutale e policisë që për qëllim kishte dëbimin nga këto prona, kishte shkaktuar pakënaqësi të madhe dhe herë – herë edhe përshkallëzim të gjendjes së rëndë sociale. Në këtë drejtim, AKP duhet negociuar me partnerët tjerë social në Kosovë dhe para se të ndërmerren hapat e tillë, të gjejë zgjidhje adekuate për këto raste. AKP në pjesën ku raportohet me stafin, duhet të sqarojë se si ka mundësi që dy ... serb në Serbi, me kontratë të rregullt vazhdojnë të jenë pjesë e listës së pagave dhe pse zyrtar në këtë vend vazhdojnë të jenë të mbyllura.

Pjesa e fundit, ndoshta më problematike është ajo që flet për buxhetin, i cili vazhdon të jetë pika e dobët e AKP-së. Nga të gjitha kërkesat buxhetore, vetëm 26% të buxhetit të përgjithshëm është siguruar nga buxheti i Kosovës, ndërsa pjesa tjetër vazhdon të dhurohet në formë donacionesh, kryesisht nga qeveritë e vendeve mike, si SHBA, Zvicër, Belgjikë, Gjermani e tjera. Kjo çështje duhet të zgjidhet përfundimisht nga institucionet e vendit, pavarësisht dëshirës së donacionit, të jenë edhe më tutje prezentë në këtë formë.

Krejt në fund, dua të them se raporti si tërësi është i përgatitur mirë dhe me kujdes. Nuk ka lëshime që do të ndikojnë në opinionin negativ të tij. AKP duhet kushtuar edhe më shumë kujdes transparencës, ndoshta jo vetëm përmes këtyre raporteve, por edhe përmes formave tjera të

pranueshme ndaj publikut të mirë informuar për shkak se kemi të bëjmë me një çështje shumë të ndjeshme, siç është çështja e pronës. Ju falënderoj shumë!

KRYETARI: Deputet, ta përkujtoj se zyrat në Serbi nuk janë për të zgjidhur probleme. Mendoj se këtë duhet ta keni parasysh, sa herë të flisni për zyrat në Serbi. Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, kryetar!

Pa pasur ndonjë pretendim që kontributi im do të ndikojë në vendimin e këtij Kuvendi, në miratim apo mosmiratim të këtij raporti, më lejoni që t'i them disa vërejtje të mia në lidhje me funksionin dhe veprimtarinë e Agjencionit Kosovar të Pronave. Së pari, mungesa e Ligjit për pronat mendoj se për pronën është një pengesë e madhe në punën më të suksesshme dhe më bindëse të Agjencionit Kosovar të Pronave. Tjetër, mungesa e institucionit të ankesës, që e merr për shembull atributin e gjyqit Agjencioni Kosovar i Pronës dhe bien vendime në të cilat nuk mund të ushtrohet institucioni i ankesës, mendoj se është një burim ose një arsye dhe një shkas që vendimet të merren edhe arbitrare dhe të ketë palë në këto konteste të dëmtuara padrejtësisht.

Shumë ankesa të qytetarëve në institucionin e Avokatit të Popullit, mendoj se nuk po merren dhe nuk po shqyrtohen në Agjencionin Kosovar të Pronave. Mendoj se një mangësi dhe një pengesë e madhe në punën e këtij agjencioni është edhe mosmiratimi në Kuvend të Kosovës i Ligjit për shitjen e banesave, që pronarët e kanë të drejtën e shfrytëzimit. Mendoj se edhe këtu ka, do të thotë ka lëndë për të cilat bihen vendime në këtë agjencion dhe pastaj kur të vijë ky ligj, do të na shkaktojë, pra, probleme të mëdha, do t'ju shkaktojë probleme të mëdha vetë shfrytëzuesve ose atyre që i kanë blerë këto prona.

Tjetër, është hetuar moskoordinimi i punëve kur bëhet identifikimi i pronave, posaçërisht i pronave bujqësore, moskoordinimi me Agjencionin e Kadastrave dhe shpeshherë ndodhë në terren, pra, që një pronë i identifikohet një pronari, ndërsa praktikisht ajo është krejt diku tjetër dhe mendoj se Kuvendi, në shqyrtimin e këtij raporti është dashur të ketë pak më tepër kujdes, edhe Komisioni gjithashtu, t'i marrë vlerësimet edhe të Avokatit të Popullit dhe është dashur ta ketë një debat me palët e interesuara dhe me palët e dëmtuara për shkak se kemi të bëjmë me mijëra vendime të cilat janë marrë dhe mendoj se në të ardhmen do të kenë të gjitha institucionet, të gjitha nivelet mjaft probleme me këto vendime. Për shembull, ka edhe vendime ku i jepet e drejta e shitjes së pronës, të banesës e cila ka qenë e dhënë në shfrytëzim në bazë të një funksioni që e ka pasur dikush para luftës dhe në bazë të asaj, pra, banesat e funksionarëve në atë kohë që i kanë marrë vetëm për shfrytëzim gjatë kohës sa e kanë mandatin, pra banesa mandatore, ato për shembull janë shitur dhe kështu mund të krijohen probleme në të ardhmen, të cilat do të jenë vështirë të riparueshme.

Ky ishte një kontribut imi, pa pretenduar që Kuvendi do të ndryshojë vendimin e vet me votim “pro” ose “kundër” këtij raporti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti shumë qartë paraqet veprimtarinë e AKP-së dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Agjencioni Kosovar i Pronës.

AKP-ja është themelues i agjenci e pavarur me Ligjin aktual të kësaj Agjencie për zgjidhjen e kërkesave mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. AKP-ja, si

agjenci e pavarur, veprimtarinë e vet e kryen përmes tri organeve të saj: Sekretarisë ekzekutive; Bordit mbikëqyrës dhe Komisionit për kërkesa pronësore të Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e AKP-së janë që t'i zgjidhë kërkesat pronësore dhe të drejtën e shfrytëzimit me të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës për pronën e patundshme private. AKP-ja funksionon përmes zyrave regjionale që funksionojnë në 5 regjionet e Kosovës dhe në Mal të Zi e Maqedoni. Agjencioni Kosovar i Pronës siguron zbatimin e vendimeve të Komisionit të kërkesave pronësore të Kosovës dhe të aktgjyqimeve mbi ankesat e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në raport pasqyrohet se AKP-ja ka pranuar mbi 40.500 kërkesa, shumica e të cilave janë zgjidhur. Pra, 36.139 kërkesa kanë të bëjnë me të drejtën mbi tokat bujqësore, 1000 kanë të bëjnë mbi pronat komerciale dhe 3.179 mbi pronat banesore. Po të analizohet numri i kërkesave sipas komunave, prinë komuna e Istogut me 5.595 kërkesa; Prizreni me 3.530; Peja me 3.312 kërkesa dhe Klina me 3.512 kërkesa. Raporti mendoj se nuk i plotëson standardet e duhura bashkëkohore se, ndër të tjera, një pjesë e madhe e këtij raporti i kushtohet biografisë së tre anëtarëve të Bordit dhe në detale përshkruan veprimtarinë e organeve, e më pak i kushton rëndësi zbatimit të politikave për një punë transparente për veprimtarinë e vet.

Ligji i Agjencionit Kosovar të Pronës rregullon procedurat që palët të marrin pjesë në procedurë, sepse palët me kërkesat e tyre me shkrim nuk kanë mundësi t'i prezantojnë dëshmi apo argumente gojore Komisionit të kërkesave të pronës të Kosovës. Gjatë zbatimit të vendimeve, ashtu siç prezantohet në raport, të marra nga Komisioni për kërkesa të pronës së Kosovës, Sekretaria ekzekutive ka konstatuar se janë bërë një varg gabimesh sa i përket saktësisë së notifikimit fizik fillestar deri në 30% të rasteve, me arsyetim se mungesa e të dhënave kadastrale që ndodhen në Serbi dhe presioni për të filluar procesi i vendimmarrjes mbi kërkesat e palëve që kanë konteste pronësore. Prandaj, Komisioni i kërkesave të pronës së Kosovës, në qershor të vitit 2009 ka anuluar dorëzimin e vendimeve derisa Sekretaria ekzekutive të konfirmojë saktësinë e notifikimit në ato kërkesa. Ky vendim është i mirë, por në raport nuk paraqitet asnjë e dhënë se si janë zgjidhur gabimet deri në 30% të ofruara palëve që kanë konteste pronësore, kur dihet që për një punë, për një pronë të paluajtshme banesore janë paraqitur dy e më shumë pronarë.

AKP-ja, regjistrin me të gjitha kërkesat e paraqitura i publikon në Buletinin e njohur si Gazeta e AKP-së deri në 20.000 kopje, të cilat u shpërndahen komunave, gjykatave, në enklava dhe Shoqërisë Civile. Edhe ky raport prezanton vështirësitë e AKP-së për të zbatuar urdhër-vendimet të miratuara nga AKP-ja dhe që nga viti 2008, ky Agjencion nuk ka mund të lirojë asnjë pronë në veri të Kosovës. Pra, edhe në këtë fushëveprimtari ka vështirësi në zbatimin e ligjeve, prandaj institucionet e Kosovës duhet të angazhohen seriozisht që të zbatohen vendimet për lirim të pasurisë së paluajtshme.

Raportin e përkrah me rekomandimet e komisionit funksional, Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, që të emërohen anëtarët e Bordit të AKP-së, të rifunksionalizohen zyrat e AKP-së në tërë territorin e Kosovës dhe të plotësohet infrastruktura ligjore me Ligjin mbi pronat. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ëmbëlsirën e kemi lënë për fund, Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Ju faleminderit!

Konform kërkesës suaj, zoti kryetar, do të flas dhe do të mundohem të jem në katërminutësh.

Ky raport është shkruar, për të gjithë ata që e kanë lexuar, sipas modës aktuale, sipas frymës së tashme, pra në stilin e mbushjes fletëve dhe të faqeve me numra, tabela dhe aty - këtu ndonjë ankesë që institucioni në fjalë e ka, si bie fjala mungesa e resurseve njerëzore dhe atyre financiare. Por,

mungojnë informatat konkrete, sidomos kur kemi të bëjmë me disa informata që janë shumë me rëndësi për qytetarin e Kosovës dhe të njëjtën kohë që nuk janë informata politike.

Unë do të ndalem në dy, po them për shkak të kohës dhe të qenit i fundit, që shumë gjëra u thanë, unë po e marrë, po ndalem vetëm te tjetërsimi i pronës së Universitetit të Prishtinës nga të punësuarit e UP-së, bile aty ka pasur edhe ka në realitet edhe profesorë, bile, bile edhe deputetë dhe ish ministra e ministra. Prandaj, Agjencionit Kosovar të Pronës unë do t'i kërkoj që në raportin e radhës të na shkruaj pak më shumë për këtë çështje, sepse është shumë me interes. Pastaj, më intereson po ashtu edhe prona e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ku janë tjetërsuar rreth 6 hektarë tokë, pronë publike. Po them, edhe këtu nuk ka asgjë ndëretnike, por është pronë publike dhe ma merr mendja që nuk kanë pse të frikohen të shkruajnë, për atë edhe paguhet të punësuarit në AKP. Dikur, siç dihet, prona e QKUK-së ishte 48 hektarë e 82 ari, tash kanë mbetur 37 hektarë e 14 ari, pra janë tjetërsuar 6 hektarë e 18 ari, sipas disa vlerësimeve rreth 20 milionë euro. Nëse AKP-së i duken pak, atëherë okej. Po them, vetëm nga viti 2004 deri në vitin 2008, janë zhdukur 2 hektarë e 62 ari. Sigurisht se gjithë këtë pronë nuk e ka tjetërsuar vetëm një njeri, por shumë njerëz dhe sigurisht se këtë pronë nuk e kanë tjetërsuar apo uzurpuar qytetarët e rëndomtë, qytetarët e zakonshëm, sepse për ta bërë këtë çështje, është dashur të kesh mekanizma, strukturë, me fjalë tjera ata që e kanë pasur pushtetin apo që i kanë udhëhequr institucionet gjegjëse dhe Agjencia Kosovare e Pronës duhet t'i publikojë emrat e atyre, pra të personave publikë, gjithnjë flas. Përndryshe, po them për raportin e radhës, se këtë raport nuk e kam ndërmend ta votoj, nëse vazhdon AKP-ja, por edhe agjencitë tjera të na raportojnë në këtë mënyrë me shifra, me tabela, me numra, domethënë kurrëgjë në substancë, neve do të vazhdojmë të mos na informojnë, jo vetëm deputetët, por edhe krejt qytetarët e Kosovës. Unë po e them edhe një herë, ky raport mua nuk më tregon asgjë, asnjë informatë nuk e kam kuptuar, besoj që edhe qytetarët e Kosovës e kushdo tjetër që do ta lexojë, ka shifra, ka disa ankesa që ju mungojnë resurset njerëzore financiare, domethënë në një farë mënyre deja vu e të gjitha agjencioneve e tjera. Apeloj te agjencionet, sidomos këto që na përgjigjen neve që ta ndërrojnë stilin e raporteve, të na raportojnë për të na informuar diçka, jo për të na dezinformuar apo të fshehin informatën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ky ishte diskutuesi i fundit. Tani është radha për ta votuar Raportin me rekomandime. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë kemi 65 deputetë. Votojmë tash:

Me 44 vota “për”, 11 “kundër”, 7 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2009, me rekomandimet e komisionit funksional. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 7-të të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Raportit të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin e punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitën e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Kuvendit ia ka rekomanduar, për miratim. Sipas radhës, ftoj kryetaren e komisionit funksional, deputeten Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Në pajtim me Rregullën 41 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në mbledhjen e mbajtur me 18 maj 2010, e shqyrtoi Raportin vjetor 2009, të Autoritetit të Aviacionit Civil, të datës 27 prill 2010, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqes këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbështesë dhe të miratojë Raportin vjetor të punës për vitin 2009 të Autoritetit të Aviacionit Civil, të datës 27 prill 2010. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci, nuk është këtu, s'e do fjalën, domethënë. Me radhë, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Autoritetit të Aviacionit Civil dhe është i mendimit se Autoriteti i Aviacionit Civil i ka paraqitur Kuvendit një raport sipas Ligjit mbi Aviacionin Civil, i cili parasheh që për çdo vit, deri më 31 mars ky autoritet t'i paraqesë raport gjithëpërfshirës Kuvendit të Kosovës. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është i mendimit se ky raport i plotëson kushtet e raportimit, është një raport gjithëpërfshirës i cili siguron informata të hollësishme për vitin e shkuar kalendarik.

Ajo çka doja të thosha në lidhje me aspektin financiar, të cilin e ka pasur ky Autoritet i Aviacionit Civil, është se gjatë vitit 2009, ka pasur diku 840.000 euro në dispozicion dhe për aktivitetet e veta i ka shpenzuar vetëm 482.000 euro, çka do të thotë se buxhetin e ka realizuar diku 57%, ndërsa nga raporti shihet se të hyrat vetanake të realizuara në këtë periudhë janë diku 1.140.000 euro. Është një dukuri që po përcillet pothuaj se të gjitha agjencione të pavarura kur është çështja të realizimi i buxhetit, kanë një realizim diku 54% dhe më së shumti deri në 64% ose 65%, çka do të thotë se të gjitha këto agjencione kanë probleme kur është çështja të planifikimi i buxhetit, i cili më tutje ndikon dukshëm të realizimi i buxhetit dhe mosrealizimi i buxhetit të këtyre agjencioneve mandej ndikon edhe në strukturën e realizimit të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës.

Edhe pse ky Autoritet i Aviacionit Civil arsyetohet se buxhetin nuk ka pasur mundësi ta realizojë për shkak se është e paraparë që t'i ketë 21 punëtorë dhe i ka punësuar vetëm 13 punëtorë dhe për shkak se Bordi është zgjedhur diku nga fundi i shtatorit dhe ka filluar punën shumë vonë. Megjithatë, duhet të përcillet një sugjerim të të gjitha këto agjencione që të kenë kujdes me planifikimin e buxhetit.

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrah rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Energjetikë, Telekomunikacion dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa që të përkrahet ky raport i Aviacionit Civil.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, kolegë deputetë!

Lidhur me Raportin e Autoritetit të Aviacionit Civil, unë së bashku me shumë kolegë tjerë deputetë të Grupit Parlamentar të LDK-së kemi pasur rastin ta shqyrtojmë bashkërisht në kuadër të debatit që e kemi pasur dhe raportit që e ka paraqitur drejtori i këtij autoriteti para komisionit parlamentar dhe vlerësimi ynë është se ky raport për punën njëvjeçare të këtij autoriteti përmban të gjitha ato elemente të cilat kërkohen prej një autoriteti të raportojë para parlamentit, të cilat mendojmë dhe vlerësojmë se puna njëvjeçare e këtij autoriteti ka qenë punë e mirë, e suksesshme dhe i kemi dhënë përkrahje edhe në parim gjatë debatit, por edhe tash që të miratohet për arsye se të gjitha aktivitetet që i ka planifikuar brenda vitit, përkundër ndonjë sfide ose kushteve të cilat përmenden në raport, mendojmë se i ka plotësuar në tërësi. Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah raportin, e aprovon dhe e miraton dhe besoj që pjesët tjera që kanë mbetur në kuadër të detyrave të tij për këtë vit, ky autoritet me përvojën gradualisht që po e fiton, besojmë që do ta kryejë punën më mirë se sa në vitin e kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, kryesues!

Më lejoni të jap vlerësimet e Grupit Parlamentar të AAK-së në lidhje me raportin që po e shqyrtojmë në këtë pikë të rendit të ditës. Mendojmë se është një raport i sistemuar dhe i shkruar mirë, përmbajtësor, në të cilin mund të kuptohet qartë angazhimi dhe përpjekja e këtij autoriteti që Kosova t'i plotësojë sa më parë standardet ndërkombëtare në këtë fushë, në këtë lami dhe është një raport i cili lirisht mund të them se mund të merret si një shembull i një raportimi të mirë në Kuvend të Kosovës.

Përveç tabelave, paraqitjeve tabelare të mjeteve financiare të zotuar, të harxhuara, të ndara e tjera, ky raport pra paraqet edhe një vit pune të këtij autoriteti me angazhimet e tij për t'i përmbushur të gjitha obligimet dhe detyrat që dalin nga Ligji për Aviacionin Civil, që duhet t'i përmbushë ky autoritet, por në të mund të shihet qartë dhe të hetohet edhe një angazhim për në të ardhmen, pra sfidat me të cilat mendon se ky autoritet do të përballet gjatë vitit të ardhshëm dhe me planet për tejkalimin e tyre.

Një parafolëse përpara përmendi te pagat dhe mëditjet që janë realizuar diku 59%, unë ju sugjeroj që ta shikoni tabelën nr. 7, faqe 42, 13 të punësuar 250.511,58 euro janë paga dhe mëditje, që i bie diku rreth 20.000 euro për të punësuar, pra, për një vit. Mendoj që janë të ardhura mjaft të larta, që unë i sugjeroj Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, për shkak se nga raporti shihet se pagat i cakton drejtori i përgjithshëm i këtij agjencioni, ndërsa i miraton Ministria për Ekonomi dhe Financa, mendoj se duhet të ketë sa më parë Kosova një rend dhe një ligj edhe për pagat e të punësuarve në këto agjencione.

Grupi parlamentar i AAK-së e miraton këtë raport me rekomandimet e Komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009. Dihet se Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Aviacionin Civil, me datën 13 mars të vitit 2008, në pakon e presidentit Ahtisari, me të cilin ligj formohet Autoriteti i Aviacionit Civil. Ky autoritet është funksionalizuar më 1 janar 2009. Në raport shihet puna e një rregullatori të ngarkuar me rregullimet e aseteve të sigurisë së Aviacionit Civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe

ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Në këtë raport është përfshirë edhe pjesëmarrja e këtij rregullatori ekonomik, në mbledhje të organizuara të Komisionit Evropian, në kuadër të projekteve të implementimit të Marrëveshjes mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

Duke marrë parasysh se Kosova në këtë lëmi ka qenë shumë rëndë në aspektet e infrastrukturës ligjore dhe në aspektet të cilat tash janë marrë shumë seriozisht nga Autoriteti i Aviacionit Civil dhe gjithë raporti përfshin një punë shumë serioze të këtij autoriteti, me punën të cilën e kanë pasqyruar brenda raportit të vitit 2009.

Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah Raportin e këtij Autoriteti të Aviacionit Civil dhe shpreson që në të ardhmen puna e tyre do të dihet edhe me hapjen e hapësirave të tjera ajrore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe mund të themi që është një raport i hartuar mirë, mbase do të duhej të ishte shembull edhe për autoritetet e tjera të pavarura, agjencitë apo bordet se si vihet para deputetëve, para organit më të lartë legjislativ, me një raport jashtëzakonisht të kompletuar, qoftë të strukturuar në aspektin e teknikave juridike, apo edhe të standardeve tjera të raporteve që do të duhej t'i vinin institucionit më të lartë legjislativ të vendit.

Ligji për Aviacionin Civil, përveç tjerash e themelon Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. AAC-ja është një agjenci e pavarur rregullatore, e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së Aviacionit Civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror.

Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe i ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror, nënkupton miratimin edhe të tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë.

Të hyrat financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil, ky mekanizëm institucional financohet nga të hyrat vetanake, do të thotë nuk ka implikime dhe nuk financohet nga Buxheti i Kosovës, sepse më 1 janar të vitit 2009, ka hyrë në fuqi Rregullorja 2008/7 për caktimin e tarifës së sigurisë së udhëtarëve që udhëtojnë në fluturime komerciale nga Kosova. Kjo Rregullore përcakton një tarifë sigurie prej 2 eruosh për çdo udhëtarë që niset nga Kosova me fluturime komerciale, andaj edhe fondet e mbledhura nga të gjitha këto që u potencuan më lartë dhe nga kjo tarifë sigurie, i ndahen këtij autoriteti.

Raporti, qoftë në aspektin substancial të raportimit dhe të pasqyrave financiare, tregon shembullin se si një autoritet rregullator duhet ta kryejë punën, është një raport real që parasheh edhe sfidat, por edhe nevojat për avancim të mëtutjeshëm në aeroportin e vetëm ndërkombëtar që e ka Kosova, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Andaj, ne e mbështesim në parim dhe vërtet do të duhej të ishte shembull për raportet e bordeve dhe të agjencioneve tjera rregullatore dhe të pavarura që vijnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I fundit është deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

AAC-ja është institucion përgjegjës për rregullimin e sigurisë së Aviacionit Civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajror të Republikës së Kosovës. Aktivitetet

në Aviacionin Civil në hapësirën ajrore të Kosovës zhvillohen në përputhje me ligjet, dispozitat e Ligjit për Aviacionin Civil, Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, të datës 7 dhjetor 1944 dhe të Marrëveshjes për themelimin e zonës së përbashkët evropiane të aviacionit.

Vetëm këtë vit AAC-ja ka bërë një punë shumë të suksesshme në hartimin dhe publikimin e 9 udhëzuesve apo doracakëve e ndryshëm të cilët lidhen drejtpërdrejt me sigurimin e fluturimeve nga i vetmi aeroport që ka Kosova, si përcaktimi i zonës mbrojtëse të aeroportit, vlerësimi i sigurisë të aeroplanëve të kompanive ndërkombëtare që fluturojnë në Kosovë, aprovimi i tarifave për fluturimin në Kosovë, certifikimi i aerodromeve dhe aeroporteve dhe të tjera.

Në këtë kuadër, lirisht mund të themi se Kosova posedon kornizën e duhur ligjore për aviacionin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të aviacionit. Si rezultat i punës së këtij agjencioni dhe i vetë menaxhmentit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, sot fusha e aviacionit llogaritet edhe në raportet e Komisionit Evropian, si njëra prej fushave që ka shënuar më së shumti progres në Kosovë.

Për ta bërë më të prekshëm për të gjithë ju punën e këtij agjencioni, mund t'i përmendim veç hartimit të rregulloreve konform kërkesave dhe ligjeve të shteteve të Bashkimit Evropian dhe certifikimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës nga ana e kësaj agjencie, pas certifikimit nga ana e autoriteteve të Aviacionit Civil të Islandës. Siç e dimë tashmë, Islanda, konkretisht Autoriteti i Aviacionit Civil i këtij vendi, i cili mbahet si njëri prej më profesionaleve në Evropë, por edhe më gjerë për shkak se shumë shtete ia kanë besuar kontrollin ajror këtij shteti, të certifikojë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës në përputhshmëri me standardet më të larta të sigurisë së Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, ICAO, për të certifikuar më pas nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Për të marrë këtë certifikatë, së pari nga Islanda, më pas nga AVC-ja, u deshën po thuaj 50 milionë euro investime në mënyrë që Aeroporti ynë i vetëm të marrë certifikim për plotësimin e kushteve të sigurisë, njëlloj si aeroportet e vendeve evropiane.

Mund t'i përmendim disa nga investimet më të mëdha, si rishtesimi i pistës, rruga perimetrike, rrethoja e re, të cilat garantojnë fluturime të sigurt, në radhë të parë. Po ashtu, për të përshëndetur është certifikimi i stafit të aeroportit, konkretisht kontrollorë dhe një pjesë tjetër të stafit teknik të cilët janë shkolluar në shkollat më të mira evropiane për kontrollin e hapësirës ajrore nga ana e AAC-së. Gjithashtu, nuk mund ta lëmë pa e potencuar edhe kontrollin e vazhdueshëm për çështjet më të rëndësishme të sigurisë së aeroportit, si dhe lejen që iu dha aeroportit për të punuar 24 orë në ditë.

Rezultatet pozitive të këtij vendimi tashmë janë të njohura për publikun. Veç anëve pozitive nga aspekti politik për punën 24 orëshe, Aeroporti ka zgjeruar kapacitetet. Në sajë të kësaj, kemi edhe rritjen e fluturimeve prej 15%, ndërsa numri i udhëtarëve është rritur për 10% në krahasim me vitin 2009, kur ishte viti më i mirë mbi 1.2 milionë udhëtarë. Pra, sivjet numri i udhëtarëve pritet të ofrohet 1.3 milionë pasagjerë, ndërkohë që në sajë të plotësimit të kushteve dhe aktiviteteve të vetëm, aeroporti ka kërkesa për të fluturuar edhe nga kompanitë më të mëdha botërore. E gjithë kjo ka sjellë që të rriten të hyrat dhe fitimet në Aeroportin e Prishtinës. Ju tashmë e dini se vetëm disa herë më parë Bordi i kësaj kompanie i kaloi 10 milionë euro dividendë, fitim Buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

I lus deputetët që të paraqiten në kohë për diskutim, veçanërisht ata që flasin në emër të grupeve parlamentare, është mirë që të paraqiten me kohë. Kush ka për të folë në emër të Grupit Parlamentar dhe jo të ketë nevojë për t'i thirr me emër ose pasi t'i përfundojnë diskutimet e grupeve parlamentare, të paraqiten tani dy përfaqësues të grupeve parlamentare. Unë, sinjerisht po ju them, sikur të ishin grupet tjera parlamentare, nuk do t'ua jepja fjalën. Fjalën e ka deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Ja se izvinjavam ako sam se naknadno prijavio, međutim mislio sam da ide po redosledu pa s toga je došlo do ovoga. Parlamentarna grupa SLS je razmatrala godišnji izveštaj i u principu zadovoljavajući je, odnosno glasaće „za“. Međutim, imamo nekoliko sugestija i one se odnose na to da je trenutno tačka dnevnog reda Izveštaj o radu, a sama brošura ne nosi naziv Izveštaj o radu već nosi Godišnji izveštaj, što apsolutno ne odgovara tački dnevnog reda, jer je ovo sigurno nešto drugo i šire nego sam Izveštaj o radu.

Takođe, možda imamo primedbu na sam izgled ovog izveštaja, jeste imponantan, jeste zadivljujuće, ali pretpostavljam da i košta. S toga bi sugerisao da obzirom da postoje dosta nezavisnih komisija, odbora agencija, da se unificira izgled izveštaja, jer ćemo kod nekih naći veoma siromašan i oskudan, a kod nekih veoma bogat i izdašan izveštaj. Takođe, sada bih nešto govorio o samoj strukturi, odnosno tekstu, u delu trećem, gde se navodi nekoliko reči o nama. To je naslov ovog izveštaja, mislim da ne odgovara službenosti pisanog obraćanja i možda bi trebalo da se kaže: „Organi, organizaciona struktura i nadležnost autoriteta Civilnog vazduhoplovstva“, s tim da moja konstatacija i konstatacija SLS je da se to uozbilji na taj način jer kažem vam, „nekoliko reči o nama“ ne liči službenosti komuniciranja.

Takođe, u delu trećem, 5, Plate osoblja ACV ne navodi se iznos plata osoblja, već se tamo govori o tome ko je taj ko će odrediti plate i tako dalje, mislim da to ide u ruku nejasnoća i mogućih, ne kažem zloupotreba, ali nejasnoća koje mogu da posumnjaju u ovaj izveštaj. S toga, naša je konstatacija da se plate osoblja ACV budu transparentni iznos onoliko koliko iznosi i da budu označen u tabelama, kao što je to navedeno u ostalom delu ovog izveštaja. Inače, mi ćemo podržati ovaj izveštaj. Ja se zahvaljujem i naravno izvinjavam zbog ovog kasnog uključenja. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ja mislim da je bila tehnička greška, mi smo čekali da pozivate sve grupe redom, tako da se izvinjavamo ako smo se javili kasno.

Pred nama je danas jako važan izveštaj i možemo sa svima zajedno da pohvalimo današnji izveštaj, znamo da su aktivnosti vazduhoplovstva i sam prihod tog sektora jako važni za Kosovo, da donose jedan veliki budžet Kosovu, da razvijaju ne samo tu granu vazduhoplovstva nego i integralno i ostale grane, kao što je turizam, spajanje, integracija i ostalo.

Kada je u pitanju sama struktura izveštaja, možemo da kažemo da je jako sadržajan, da ima sve komponente jednog izveštaja, da se bavi dosta sa organizacionom šemom Civilne avijacije, da se bavi sa fondom, samim fondom te avijacije, ali je nešto što nedostaje a što nas ovde zabrinjava, jeste da mi vidimo da kada su plate u pitanju, stranica 41, da je potrošeno 250 hiljada eura, da je zarađeno milion i nešto eura, da su 840 hiljada kapitalni troškovi, da su ukupno 840 hiljada eura, neću da navodim ove ostale brojke. Ali nešto što nas zabrinjava jeste što ponovo imamo jedan izveštaj koji ne daje strukturu zaposlenih. Ovo su javna tela i moramo da imamo strukturu zaposlenih. Ovo su javna preduzeća koja faktički su i kapitalna preduzeća države. Smatramo da je to veliki minus zato što mi poslanici iz ostalih zajednica ne možemo da napravimo analizu i da vidimo koliko je prisutno zapošljenih naših predstavnika u ovim institucijama. Ja ovo kažem iz razloga da se radi struktura zaposlenih po godini, po stažu, po strukturi žena, po strukturi rodnoj, tako da bi mogli da imamo jednu sliku pravu o ljudskom resursu. Ovde vidimo da sam izveštaj da je pozitivan, ne utiče na budžet Kosova, donosi puni

budžet Kosova, što bi trebalo da bude primer za mnoga javna preduzeća. Investicija od 50 miliona za jedan takav važan objekat koji nas spaja sa svetom vazдушnom linijom je za ovo društvo bila jedna od, da kažem, ekonomskih investicija koja se isplatila i verujem da će konsignacija koja je u pitanju sa partnerom trećim biti jako važna i uspešna za Kosovo.

Jedno što hoću da kažem kada su plate u pitanju, Vlada više mora da se pozabavi i da se zna. Ovde autoritet kaže određuje plate, direktor ili ovo... Ne može pojedinac da određuje plate. Plate određuje zakon. Zakon o javnim preduzećima, Zakon o platama, Zakon o zapošljavanju, razrez plata, Zakon o radu i mi moramo te strukture da imamo da bi ove agencije ili ove institucije više mogle zakonski da se ponašaju. To je jedan naš doprinos od naše Grupe parlamentarne i hvala na datu reč!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatohet që s'ka më të paraqitur. Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e Raportit të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2009. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Ju njoftoj se në sallë janë 72 deputetë.

Me 66 vota “për”, 2 “abstenime”, konstatohet se Kuvendi miratoi Raportin e Punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2009.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Raportin financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Sipas radhës, kryetarja e komisionit funksional, Myzejene Selmani ose raportuesi i komisionit për arsyetimin e raportit. Deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesueses!

Në pajtim me Rregullën 41 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në mbledhjen e mbajtur më 5 dhe 18 maj 2010, e shqyrtoi Raportin vjetor 2009 të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe të Mineraleve, të datës 6 prill 2010, dhe të raportit plotësues të datës 17. 05. 2010 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim:

1. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbështesë dhe të miratojë Raportin vjetor të punës për vitin 2009 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, të datës 06 prill 2010, dhe raportin plotësues të 17 maj 2010, së bashku me rekomandimet në vijim.

KPMM në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të mbështetura nga Qeveria e Kosovës, urgjentisht të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të shtojë efikasitetin e ndërprerjes së të gjitha aktiviteteve ilegale të operatorëve – gurrthyes.

2. MEM dhe KPMM sipas kompetencës të ndërmarrin veprime të përshpejtuara për nxjerrjen dhe harmonizimin e akteve juridike për rregullimin e tantimave.
3. Ministria e Ekonomisë dhe Financave brenda kompetencave të ndërmarrë masa të menjëhershme ligjore ndaj subjekteve borxhlinj për inkasimin e të gjitha borxheve në emër të tantimave. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Komisioni për Buxhet dhe Financa? E ka fjalën deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse kryetari nuk është prezent në mbledhje, më ka autorizuar që në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa fjalën ta marr unë, kërkoj mirëkuptim nga deputetët.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe, siç e thatë edhe ju, kryesues, i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport, sepse ka vlerësuar se i njëjti i përmbush kriteret dhe kushtet ligjore për raportin, kështu që atë që e ka kërkuar Komisioni për Buxhet është që meqenëse obligimet janë shumë të mëdha, obligimet e kompanive ndaj ndërmarrjeve të ndryshme, ndaj Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ka kërkuar që para se të miratohet ky raport në Kuvend, Komisioni i Pavarur për Minerale dhe Miniera të paraqesë, të dorëzojë listën e atyre ndërmarrjeve të cilat nuk i kanë shlyer borxhet nga taksat e faturuara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Komisioni i Pavarur e ka dorëzuar këtë listë me emrin e të gjitha ndërmarrjeve të cilat janë borxhlinj ndaj KPMM-së dhe shihet se borxhi ndaj KPMM-së nga faturat të cilat nuk janë shlyer, është diku rreth 10 milionë euro.

Ajo çka është me rëndësi të ceket këtu, është se përpos disa ndërmarrjeve tjera, siç janë “Podrimja” që i ka 345.090 euro të pa paguara obligime, “Vëllezërit Morina”, për shembull 266.000 euro, “Unikomerc” 219.000 euro, janë edhe dy ndërmarrje që janë ndërmarrje pak më profitabile dhe të cilat gëzojnë njëfarë përkrahje dhe favorizimi në shfrytëzimin e shërbimeve, duke qenë edhe konsumatorë të privilegjuar, siç është “Ferronikeli” që ka fatura të pashlyera diku 736.420 euro dhe “Sharcem” që është me borxhe të pakryera prej 1.090.926 euro, prandaj është e pakuptimtë që këto ndërmarrje të cilat nuk i kanë kryer obligimet dhe ende të gëzojnë statusin e konsumatorëve të privilegjuar apo të kenë favorizime në shfrytëzimin e shërbimeve.

Megjithatë, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka përkrahur raportin meqenëse i ka plotësuar kriteret e raportimit dhe ka një shfrytëzim më të mirë, një realizim më të mirë të buxhetit edhe përkundër që ka pasur vërejtje për disa kategori të shpenzimeve, siç kanë qenë shërbimet e arsimimit dhe trajnimit, shërbimet e ndryshme intelektuale, këshillëdhënëse dhe shërbimet tjera kontraktuese. Megjithatë, Komisioni e ka përkrahur dhe rekomandojmë që Kuvendi ta përkrah këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani sipas radhës, përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, Sala Berisha – Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje deputetë të nderuar dhe ju të gjithë të pranishëm!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Është hera e dytë që ky institucion i raporton Kuvendit, meqë më herët nuk ka qenë kompetencë e institucioneve tona. Prandaj, kemi pasur mundësi që gjatë analizimit të këtij raporti të shohim se sa ka pasur ecje, duke e krahasuar këtë raport me raportin e një viti më parë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është njoftuar se ky raport i është kthyer Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale nga ana e komisionit parlamentar, në mënyrë që të plotësohet me informacione shtesë. Kjo është edhe arsyeja që ky raport shqyrtohet me vonesë në këtë seancë parlamentare. Mendojmë se krahasuar me raportin e një viti, ky raport nuk ka ndryshime substanciale, përveç se është i hartuar në mënyrën më afirmative sa i përket punës së tij njëvjeçare. Qëllimisht po them në mënyrën më afirmative, sepse për të nxjerrë diçka realisht, nuk duhet t'i hedhim shumë kozmetikë afirmative, por të paraqitet situata ashtu siç është reale në qoftë se dëshirojmë që miniera ta kenë kahren e duhur në mënyrë që t'i hapen dyert zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Duke bërë një krahasim me raportin e vitit paraprak, pra, që ka sjell kjo agjenci, në raport nuk vërehet ndonjë ecje përpara në vitin e kaluar, me përjashtim që është plotësuar, përkatësisht është kompletuar Bordi i KPMM-së. Dihet se ky plotësim i bordit nuk reflekton në raportin e vitit paraprak kalendarik. Nga diskutimet e vitit të kaluar në lidhje me raportin e KPMM-së, si kërkesa më emergjente kanë qenë, veç tjerash, edhe plotësimi i bordit, i cili është plotësuar pra tani, ristrukturimi i thellë i stafit, mandej miratimi i Ligjit për miniera dhe minerare, i cili është ende në procedurë dhe sigurisht do të miratohet në korrik, kur edhe i bën një vit nga leximi i parë.

Unë do t'i shkoj me radhë raportit,, kështu që në faqen 11 kemi aktivitetin e KPMM-së, ku kemi një pasqyrë nga viti 2005 – 2008 sa licenca janë lëshuar për hulumtim dhe shfrytëzim, si dhe leje speciale, ku mendoj se janë përfshirë në mënyrë gjenerale. Mandej, në faqe 12 i kemi projektet kryesore që janë kryer gjatë kësaj kohe dhe janë për t'i përshëndetur dhe për t'i përgëzuar, sepse këto janë projekte shumë të rëndësishme sa i përket gjeo-shkencave dhe fushës së minierave në përgjithësi.

Në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës gjatë analizimit të këtij raporti kanë dalë shumë pyetje dhe shumë dilema, ndër të cilat do t'i lexoj disa prej tyre, siç janë se sa po zbatohet plani i guroveve, sa i kanë shërbyer të dhënat gjeo-fizike joshjes së investitorëve dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës, sa është shfrytëzuar arkivi i KPMM-së, sqarimi i vijës buxhetore, siç është shërbimet e arsimit dhe trajnimet, shërbimet intelektuale, që i përmendi kolegja më parë, që është një dilemë se si janë shpenzuar, mandej udhëzimi administrativ për tantiema, pse është në funksion ende lista e tantiemave, e përpiluar nga UNMIK-u, mandej një pyetje shumë me rëndësi që e ka shtruar në komisionin parlamentar edhe zoti Çeku, si anëtar i komisionit, lidhur me licencën e Trepçës që çuditërisht e kemi marrë një përgjigje përafërsisht kështu: “Duke pasur parasysh se kjo ndërmarrje ndodhet nën moratorium të Gjykatës Supreme, nuk ka pasur mundësi që t'i lëshohet licencë e rregullt”. Dhe ... mendimin: Në qoftë se është kështu, sigurisht se e njëjta mundësi do të vlente që edhe asetet e saj të mos tjetërsohen. Një sqarim ose informacion për ju, deputetë të nderuar.

KPMM-ja i ka lëshuar një licencë në pronën e Trepçës, saktësisht në Drazhnjë, Çuka e Batllavës, një kompanie private dhe vazhdon ende t'i bëjë lëshime kësaj kompanie, duke ia vazhduar afatin e kësaj licence hulumtimi. Kjo po i bie se KPMM vazhdon të punojë me kute të dyfishta. Sanksionon Trepçën me licencë në emër të moratoriumit, nga ana tjetër i lëshon licencë kompanisë private në pronën e saj. Të gjitha këto marifete i bën në emër të një rregulloreje të UNMIK-ut, në mungesë të Ligjit të minierave, që kushtimisht po i bie se në këtë lojë është edhe Parlamenti, të cilit nuk po i bëhet vonë ta miratojë Ligjin për miniera dhe minerale, që do të sqaronte përfundimisht paqartësitë e tilla.

Po iu shkojmë me radhë pyetjeve të cilat janë parashtruar nga grupi parlamentar dhe kanë qenë të njëjtat gati pyetjet edhe në komisionin parlamentar. Projekti i quajtur – Plani i guroreve të Kosovës është një projekt i rëndësishëm dhe në pyetjen tonë në komision, por edhe në grup parlamentar se sa po zbatohet plani i guroreve të Kosovës, për deri sa edhe më tutje e kemi të pasqyruar në material këtë raport, operimet ilegale të cilat kryesisht kanë të bëjnë edhe me këtë fushë, kemi marrë përgjigjen përafërsisht kështu – se zbatimi i tij është pjesërisht dhe atë strikt në komunën e Kaçanikut përgjatë magjistrales Prishtinë-Shkup.

Mandej, në pyetjen sa iu përket matjeve ajrore gjeofizike – cilat janë efektet e këtij projekti dhe a i ka shërbyer Qeverisë së Kosovës për të projektuar më tutje për zhvillimin ekonomik apo ka mbetur vetëm në sirtarët e KPMM-së këto të dhëna gjeofizike e që kanë kushtuar bukur shtrenjtë, dihet që për atë kohë kur është kryer ky projekt, është menduar se është një luks të bëhen matjet gjeofizike përballë hapave në të cilët ka kaluar Kosova.

Më tutje, te kapitulli i aktiviteteve të KPMM-së për vitin 2009, përkatësisht te kapitulli i licencimit, është te licencat për hulumtime gjeologjike, kërkim zbulim, ende punohet me rregulloren e UNMIK-ut në fuqi. Thuhet se licenca për hulumtim lëshohet me afat prej 2 vjetësh, me mundësi vazhdimi, por ne konsiderojmë se kjo mundësi vazhdimi nuk duhet të jetë pafundësisht. Edhe mundësia e vazhdimit duhet ta ketë një afat kohor të caktuar, jo në emër të kësaj të drejte nga rregullorja e UNMIK-ut të mbahen peng fusha të rëndësishme minerare, siç është ajo e Çukës së Batllavës e tjera fusha minerare në të cilat ka aplikuar Ferronikeli për hulumtim dhe shfrytëzim. Konsideroj se kjo shprehje me mundësi vazhdimi është një mundësi për manipulim, për legalizim të ilegalëve dhe konsideroj se nuk është në dobi të zhvillimit ekonomik.

Mandej, më tutje i kemi të gjitha tabelat e hulumtimit gjatë vitit 2009, faqe 17 dhe 18, që janë diku 18 licenca të hulumtimit për mineralet metalore, të paraqitura në mënyrë gjenerale. Është dashur ta kemi një pasqyrë më të detajizuar, të pasqyruar në kohën kur kanë aplikuar, mënyrën e aplikimit, a është kompania e regjistruar në Kosovë, a janë paraparë me rregulloret në fuqi, e në veçanti a ka pasur kërkesa, përkatësisht aplikacione në zonat me interes të veçantë, kur dihet se në raport është një hartë e zonave me interes të veçantë, të dërguar nga Qeveria, dhe të dihet se në ato zona a ka ndonjë kërkesë, ose ndonjë aplikacion për licencë hulumtimi ose shfrytëzimi, si dhe a është licencuar ndonjë kompani në këto zona, qoftë para ose pasi t'ju ketë ardhur harta me zonat e interesit. Pra, është në interesin e deputetëve që të dihet edhe kjo çështje. Për shembull, edhe në raport shihen në mënyrën shumë të sofistikuar privilegjet që iu krijohen disa kompanive, që mos ta përsëris kolegen time më parë, siç është Sharrceci dhe Ferronikeli. Ferronikeli ka mbi 10 aplikacione për leje të hulumtimit vetëm në një regjion dhe sa është serioze kjo kompani dhe pse privilegjohej nga KPMM-ja, sa ka punuar sipas rregullores në fuqi, sa i ka kryer obligimet financiare, se siç shihet nga raporti, as përafërsisht nuk i ka kryer sa i përket taksës minerare, pse jepen kaq shumë licenca kur dihet si është privatizuar Ferronikeli. Kompani të tilla ka mjaft në tërë Kosovën, sa i kanë kryer hulumtimet për minerale metalore sipas licencave që i kanë kryer, është Iliria-Minikoop, Kosova-mineral ekspropriation, Kosova-resurs kompani, e tjera. Dhe a respektohen zonat e interesit të dhëna nga Ministria e Energjisë dhe minierave, si është puna në këtë rast, është një pyetje shumë interesante dhe si është puna me qymyret e Dukagjinit rreth shfrytëzimit të tyre. Kush duhet të merret me to? Vetëm KPMM-ja apo edhe Agjencioni i Kosovës për privatizim. Dhe dihet që boksitet e Kosovës e kanë në licencë për hulumtim sa i përket basenit të Dukagjinit, që është në kundërshtim edhe me rregulloren e UNMIK-ut, sepse mineralet energjetike duhet t'i nënshtrohen një procesi konkurrues e jo të shkojë ashtu sipas rregulloreve që vlejnë për tjerat minerale.

Mandej, një tjetër shqetësim është edhe te tantimet. Nuk e di pse nuk ka hyrë në fuqi udhëzimi administrativ, në të cilin është punuar një kohë të gjatë dhe i cili ndryshon nga lista e tantimave që e ka përpiluar UNMIK-u dhe pse nuk është aprovuar nga Bordi i KPMM-së ky udhëzim administrativ. Dhe vazhdon që tantimet ose rentat, taksat nga shfrytëzimi i minierave të bëhen paushall, sipas rregullores që e ka lënë UNMIK-u në atë kohë.

Në fund, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë raport, duke i dhënë rast Bordit të ri të përmirësuar performancën e këtij institucioni, qoftë edhe përmes një riformatizimi të thellë, duke kërkuar llogaridhënie nga stafi në fjalë, si dhe të merren përgjigjet që dolën nga pyetjet dhe dilemat e deputetëve nga kjo seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne vlerësojmë se edhe raportimi apo ky raport vjetor i punës së këtij komisioni të pavarur është në pajtim të plotë me detyrat apo detyrimet që ka ligji për themelimin e këtij komisioni, prandaj së bashku me deputetët e këtij grupi parlamentar që kemi marrë pjesë në punën dhe debatet që ka pasur në komisionin parlamentar, po ashtu kemi pasur mundësinë që të shprehim vlerësimet, vërejtjet në parim dhe normalisht debate të shumta që nuk janë kanë një po kanë qenë disa dhe në fund pra nga raportimi, nga plotësimet që i ka bërë ky komision, ne vlerësojmë pozitivisht punën që e ka bërë gjatë vitit për të cilin po raporton ky komision.

Po ashtu, vlerësojmë se edhe përgjegjësitë dhe rëndësia e madhe që ka ky komision në çështjet që kanë të bëjnë kryesisht me shfrytëzimin e resurseve natyrore, të cilat në mënyrë direkte dhe indirekte lidhen drejtpërdrejt edhe me zhvillimin, por edhe me çështjet tjera ambientale në vend, mendojmë që disa nga problemet që e kanë preokupuar këtë komision janë edhe vonesat e kompletimit të tij, që kanë ardhur nga ky parlament, i cili është autoriteti i cili është dashur të mendojë me kohë ta plotësojë përbërjen dhe performancën e këtij komisioni kaq të rëndësishëm.

Ne vlerësojmë pozitivisht, po ashtu, të gjitha aktivitetet që i ka bërë për vitin 2009, projektet të cilat i ka realizuar gjatë vitit 2009, të cilat janë të përfshira në raport, si dhe aktivitetet tjera. Në mënyrë të veçantë, po ashtu, konsideratën për problemet në të cilat kanë hasur në sektorin minierar në vend dhe nevojat, do të thotë, për përkrahje më të madhe këtij komisioni nga Kuvendi dhe Qeveria, si dhe objektivat e veçanta që i ka vu në raport, e për të cilat ne si grup parlamentar jemi pro këtij raporti vjetor, sikur që jemi edhe në përkrahje të plotë të rekomandimeve që i ka nxjerrë komisioni parlamentar, për të cilat do të veçojmë përgjegjësitë e mëdha që kanë autoritetet për masat që duhet ndërmarre, e të cilat janë veçuar në këtë raport, të cilat do të kishin ndihmuar shumë, qoftë për shfrytëzimin e pasurisë, por sidomos për grumbullimin e borxheve nga kompanitë të cilat nuk i kanë kryer detyrimet që janë për shfrytëzimin e asaj pasurie natyrore, të cilat iu kanë avit shifrës prej vitit 2007 deri në vitin për të cilin po raportohet afër 10 milionë euro. Prandaj, mendojmë që këtu duhet t'i jepet një përkrahje e plotë nga të gjitha institucionet që veçohen dhe janë vendosur, nga të cilat kërkohet, sepse komisioni në fjalë nuk mund ta përmbushë pa ndihmesën e Qeverisë dhe të ministrave përkatëse ose të institucioneve të cilat e kanë për detyrë të kërkojnë realizmin dhe përmbushjen e këtyre borxheve që, po them, janë mbi 10 milionë euro. Ndërsa, prej komisionit, po ashtu, sugjerimet që janë dhënë për këtë komision kanë të bëjnë edhe me vazhdimin e licencave për këto kompani, pra, që të jenë shumë më rigorozë që realisht të shikojnë mundësinë e marrjes së masave edhe nga vetë komisioni kur është çështja e vazhimit të licencave në pajtim me ligjin, në pajtim me rekomandimet, në mënyrë që të disiplinohen dhe kompanitë të cilat i shfrytëzojnë këto të mira, këto resurse natyrore realisht t'i përmbushin ato detyrime dhe të punojnë në drejtimin tjetër drejt zhvillimit të vendit në pikëpamje ekonomike, por edhe të ruajtjes së ambientit.

Prandaj, në parim ne e përkrahim këtë raport dhe do ta miratojmë si Grup Parlamentar i LDK-së.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti kryesues,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar këtë raport të punës dhe në parim, të themi, e mbështesim një raport të tillë të punës që e ka sjellë komisioni, mirëpo kemi një seri vërejtjesh rreth funksionimit, në radhë të parë të këtij komisioni dhe ndonjëherë komisionet e pavarura apo institucionet e tilla janë të varura nga shumë aspekte të tjera që Qeveria duhej të ishte, t'i kryejë punët e saj, në radhë të parë, të them, që ende që sa vite u bënë, ende nuk e kemi strategjinë e minierave që duhet të ishte që ky grup, ky komision të funksionojë si duhet, prandaj sot e kësaj dite ende ka mbetur strategjia e minierave pa e sjellë në parlament, e cila jep kornizat se kah duhet të zhvillohet dhe si duhet të funksionojë. Pastaj, planin për menaxhimin e minierave, të resurseve minerare, në të vërtetë që është një nga projektet po ashtu të mëdha, që ende nuk është hartuar, ende nuk është përcjellë dhe problemi tjetër i madh është, po ashtu, që u përmend edhe nga kolegët, mungesa e Ligjit të minierave dhe mineraleve, që e vështirëson punën e këtij komisioni. Mendoj se ministria e linjës përkatëse duhet t'i kishte sjellë këto dokumente, që mu resurset minerare të jenë bartës të zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Ne gjithmonë e kemi theksuar dhe po theksojmë se progresi që duhet të bëjë shteti ynë në aspektin e zhvillimit ekonomik, për neve bazën e vet e kishte në shfrytëzimin e resurseve minerare, në shfrytëzimin e këtyre pasurive të cilat janë të mjaftueshme, të bollshme për gjenerata të tëra, por po mungon vizioni, po mungon koncepti që ne të dalim nga vendi, njëri nga vendet më të varfra për të ardhura për kokë banori në Evropë.

Problemi i dytë është shumë i madh, operatorët ilegalë. Ky komision ka bërë një punë të jashtëzakonshme, sepse e ka sjellë një listë dhe e shihni sa operatorë ilegalë veprojnë në Kosovë.

Problemi tjetër i madh është sa operatorë ilegalë, të cilët janë dhe nuk kanë mund të regjistrohen, por edhe sa kompani të cilat veprojnë dhe nuk i kanë kryer aspektet financiare. Po ashtu, u përmend që janë rreth 10 milionë euro, kompani të cilat nuk i kanë kryer obligimet financiare të cilat janë pasqyruar edhe në komisionin tonë parlamentar dhe në komisionet tjera është kërkuar që Ministria e Ekonomisë dhe Financave të bëjë atë punë që duhet ta bëjë që të arrijë t'i grumbullojë ato të hyra të mëdha, të cilat iu kishin nevojitur shtetit të Kosovës.

Një problem tjetër është çështja e tantiemave. Këtu është sjellë lista e tantiemave, apo siç i thonë – taksave minerale. Unë mendoj që ky komision duhet të bëjë përgatitjen adekuate që t'i fillojë procedurat e ndryshimit të tantiemave për disa kategori të caktuara, të cilat do të mund të ishin bartës të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Dhe, problemi i fundit është që ky komision realisht ka një barrë tepër të rëndë për të dhënë licencat, qoftë licencat për hulumtime, qoftë licenca për shfrytëzim. Ne kemi, është çështja e kompleksit mineral të Trepçës që ka një lloj licence, e cila në vazhdimësi për çdo vjet kërkon që të ripërsëritet dhe duhet të ripërsëritet, mirëpo ka mbetur problemi i Trepçës një nga problemet më të mëdha të ngrira nën moratorium, siç është theksuar më herët nga ana e ish institucioneve, siç ishte UNMIK-u, dhe ka mbetur pa ndonjë aktivitet të duhur, të cilat mund të ishin bartëse të zhvillimit të mirë ekonomik të gjithë Kosovës, e në veçanti të asaj pjese të Kosovës të cilat mund të funksionojnë zëshëm, shtrirjen e pushtetit dhe shtrirjen e funksionimit të shtetit në atë pjesë të Kosovës.

Ne, po them edhe një herë, në parim e mbështesim, por kërkojmë nga institucionet, siç është ministria përkatëse, Ministria e Energjisë dhe Minierave që të përshpejtohet në hartimin e atyre dokumenteve, sepse pa ato dokumente do të jetë i vështirë funksionimi i një komisioni të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, duke marrë parasysh se gjatë shqyrtimit të këtij raporti Grupi Parlamentar i AKR-së me të gjitha pikësynimet dhe me gjitha vërejtjet që mund t'i ketë në këtë raport, prapë se prapë i jep dritën e gjelbër këtij raporti në këtë seancë plenare, që do të thotë se raporti i plotëson konditat që të ecën brenda kësaj seance plenare.

Duke marrë parasysh se Bordi i KPMM-së është vendos bukur vonë, diku nga 1 shkurti 2010 ka filluar kompletimi total i bordit, aktiviteti i KPMM-së në këtë raport shihet se edhe gjatë dhënies së licencave për hulumtime dhe licenca për shfrytëzime shihet se prapë se prapë KPMM-ja gjatë zhvillimit të procedurave të tyre hasë në pengesa mjaft të mëdha.

U parafol këtu mungesa e infrastrukturës ligjore, të Ligjit për minierat dhe minerale, i cili është brenda komisionit parlamentar, duke pasur parasysh se është punuar intensivisht në atë ligj për të mirën e gjithë sektorit minerar në Kosovë, mirëpo pritet që të miratohet, shkaqet e mos miratimit dihen nga vetë komisioni. Në këtë raport të KPMM-së shihet mjaft mirë se është pasqyruar edhe gjendja e operatorëve ilegalë të mineraleve ndërtimore dhe mosrespektimi i standardeve ambientale nga ana e kompanive dhe u parafol që është një shumë e madhe të cilën nuk e paguajnë kompanitë dhe nga dy parafolet e para u cek pagesa e taniemave nga kompanitë shumë të mëdha të cilat edhe janë, njëra është privatizuar në Kosovë dhe tjetra funksionon në gjysmë të procesit të saj, me ndërrim të operatorit ekonomik kohë pas kohe tregon mjaft mirë se KPMM-ja ballafaqohet me pengesa mjaft të mëdha ku edhe rekomandimet e Komisionit parlamentar përkrahen në mënyrë të plotë nga Grupi Parlamentar i AKR-së.

Duke marrë parasysh se KPMM-ja është organ ekonomik dhe organ i cili duhet të operojë në mënyrë të pavarur, shpresojmë dhe besojmë shumë shpejt, pas miratimit të Ligjit dhe pas miratimit edhe të strategjisë së minierave dhe mineraleve, e cila nëse e bie Qeveria e Kosovës në Kuvend, të funksionalizohet në mënyrë të duhur për interesin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se raporti i KPMM-së profesionalisht është i dobët, me shumë mangësi si nga paraqitja e bilanceve të lëndëve të para dhe cilësisë së tyre nga aspekti i një pasurie të konsiderueshme të Republikës së Kosovës.

Duke ditur se Kosova disponon, përveç të tjerash edhe me sasi shumë të mëdha të qymyrit, raporti nuk përmban esencën e shfrytëzimit të tanishëm dhe të strategjisë së zhvillimit të këtyre minierave. Nga parathënia e raportit që përmban vetëm lëvdata të mëdha për punën e këtij komisioni, fitohet përshtypja se puna e këtij komisioni është e përkryer, por fatkeqësisht realiteti është krejt ndryshe.

Vërejtjet tona konkrete lidhur me këtë raport të KPMM-së janë se KPMM-ja është e organizuar prej 79 vendeve të punës, që nga përmasat duhet t'i takonte ndonjë shteti me madhësi si Gjermania apo Anglia.

Raporti i vitit 2008 ka pasur kritika për mos inkasimin e mjaftueshëm të tantimës, e në këtë raport të vitit 2009 fare nuk është dhënë dhe paraqitur shkalla e inkasimit të tantimës.

Nga raporti mund të konkludohet se janë më tepër se gjysma e shfrytëzuesve të pa licencuar, se sa numri i atyre të licencuar. Shtrohet pyetja – pse ekziston inspeksioni aq voluminoz dhe ku janë rezultatet e këtij komisioni?

Lidhur me rezultatet e hulumtimeve në këtë raport nuk kemi pasqyra, si janë rritur rezervat e lëndëve të para dhe sa janë përmirësuar cilësia e lëndëve të para, duke pasur parasysh se qëllimi i hulumtimeve është që të zbulohen lëndët e para si nga cilësia, ashtu edhe nga sasia, atëherë ku janë rezultatet?

Në tabelë numër 4 shihet se janë 53 licenca për hulumtime, a janë dhe sa janë keqpërdorur këto licenca, ngase nuk ka asnjë të dhënë për rezultatet e hulumtimeve në këtë raport. Ajo që është tejet shqetësuese, duhet të ceket se raporti nga paraqitja e shënimeve për degradimin e ambientit mjedisor është dëshmi në veti për mos efikasitetin e KPMM-së. Gjithashtu, shtrohet pyetja sa në mënyrë profesionale dhe me kuadro profesionale shfrytëzohen lëndët e para tani në Kosovë. Në raport nuk është përfshirë Trepça, edhe pse nën administrimin e AKP-së kompetencat e KPMM-së mbi Trepçën janë sipas Rregullores 2005/03. Në raport nuk trajtohet fare çështja për koncentratet e Trepçës, duke përfshirë cilësinë dhe sasinë dhe duke pasur parasysh që në përmbajtje të koncentratit ka sasi të arit, argjendit, bismutit dhe kadmiumit. Gjithashtu, edhe çështja e Çukës së Batllavës, që është aset i Trepçës që është licencuar për hulumtim dhe nuk është e qartë me çfarë të drejte KPMM-ja i ka dhënë licencën për këtë vendburim.

Në raport, në faqen 28 jepen shënime për 265 lëndime në punë, që nuk duhet injoruar, sidomos duke pasur parasysh që ka pasur edhe raste vdekje. Mirëpo, në raport nuk kemi të dhëna për gjendjen e këtyre njerëzve, si dhe masat e ndërmarra për minimizimin e lëndimeve në të ardhmen, gjegjësisht ngritjen e sigurisë në punë.

Gjithashtu, raporti nuk përmban numrin e kërkesave për rishikimin e licencave, gjegjësisht ankesat në licencat e dhëna, si dhe mënyrën e zgjidhjes së këtyre ankesave. Ne konsiderojmë se dëmet nga mos zgjidhja e këtyre ankesave, që në të ardhmen do të mund të realizohen nëpërmjet procesit gjyqësor, do të jenë të mëdha.

Andaj, në fund, Lidhja Demokratike e Dardanisë e mbështet këtë raport me vërejtjet substanciale që i adresuam. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna grupa „7+“ u načelu prihvata ovaj izveštaj i smatramo da je urađen kvalitetno. Pada u oči činjenica da su kompanije koje duguju od prilike 10 miliona, zaista je mislim alarmantno. Gotovo 10 miliona eura, to je data ova tabela koja je naknadno dostavljena. Dati su i troškovi koje je Agencija vršila. Mi ćemo u svakom slučaju podržati ovaj izveštaj i dati do znanja da treba da se radi kvalitetnije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala izveštaj o radu Nezavisne komisije za rudnike i minerale za 2009. godinu i u principu se slaže sa tim izveštajem. Naravno, podržavamo preporuke Komisije za privredu, trgovinu, industriju, energetiku, transport i telekomunikacije, koju želim ovom prilikom da pohvalim u svom radu i naravno sa svim njenim preporukama. Međutim, smatram da postoji, recimo, nedostatak o podacima o zloupotrebi licenci. Mislim da bi to bilo dovoljno potrebno i nedostatak podataka o odbijenim zahtevima za izdavanje licenci, jer je to takođe opet jedan bitan podatak jer znamo da veliki broj firmi radi bez licenci i tako oštećuje budžet Kosova. Mi ćemo kao Parlamentarna grupa podržati ovaj izveštaj, naravno uz preporuke komisije koja je funkcionalna u ovom slučaju. Hvala, još jednom!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritim, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa, ponovo na datu reč!

I mi smo pažljivo razmatrali ovaj izveštaj. Vidimo i sam ovaj ishod izveštaja kakav je od strane svih parlamentarnih grupa. Ne možemo da kažemo da smo zadovoljni sa ovim izveštajem. Izveštaj ima dosta opisnih strana, međutim nema namensku stranu, namensku stranu da u stvari da kažem analizira i planira tržište mineralnih resursa koji su u stvari nacionalni resurs Kosova.

Jako je žalosno to što se ovde suočavamo sa velikim brojem kompanija koje nisu izmirile svoje dugove, koje imaju dugove od 10 miliona na ime izdatih licenci ili potreba gde su iskorišćavale eksploataciju, tako da mi svi znamo kada je izdavanje licenci da je plaćanje avans pre toga, znači licencu dobijaš kada platiš. Koji je autoritet ovde dozvoljavao da pojedine kompanije dobijaju licence, zašto nisu identifikovani, zašto im u roku od dve godine nisu oduzete po zakonu i zašto te kompanije nisu utužene. Vidimo da imamo troškove utuženja negde od 252 hiljade i zašto jedan ceo ciklus na Kosovu kao što je autoritet od skupštinske vlasti preko sudskih organa do izvršnih organa ne funkcioniše. Sa ovim izveštajem samo potvrđujemo ovo, da su u jako teškoj poziciji savezni organi sve do lokalnih organa. Moramo više da se bavimo sa ovim delatnostima, da inspekcije rada rade više, da svaka agencija i svaka komisija koja postoji i koja je imenovana od strane Parlamenta i Vlade, koja je namenski na tržištu da se bavi sa poslom i da bude u koordinaciji i da bude produktivna.

Imamo budžetsku orijentaciju za ovu komisiju. Mi moramo da znamo da sve ove komisije u budućnosti živeće od svojih prihoda, bez obzira što su budžetske one će morati da imaju ne samo troškove, nego i dobitak.

Vidim ovde kada su u pitanju troškovi, da je potrošeno 580.000 eura. Jako nas zabrinjava kao Grupu zašto je ovako velika kirija kada je u pitanju 94.000 eura, zašto je jako veliki avans za posete studiranja i službene..., ne piše putovanja, šta. Zašto su usluge ponovo obrazovanja i obuke jako velike, kada znamo da na tržištu Kosova imamo jako mlade funkcionalne ljude, školovane sa fakultetom koji mogu da imaju obuke, da kažem, praktične 2 – 3 meseca, a ne da ih doškolavaju ove institucije. Znači, ljudi i ljudski faktor se školuje na fakultetu, ne školuju ih institucije. Institucije nisu fakulteti, komisije nisu fakulteti, ovi autoriteti nisu fakulteti. Moramo da odvojimo troškove školovanja i da napravimo zakon koje sve obuke i u kom limitu troškova mogu da se dešavaju tamo po ovim autoritetima. Ovo je jako zabrinjavajuće. Svake godine imamo ove troškove, ti troškovi ukupno utiču možda i 30 do 40% na ukupne troškove. Molim da obrate pažnju poslanici na ove kategorije koje sam rekla i kada su u pitanju ostali troškovi, troškovi gde se može štedeti, gde imamo i namensku potrebu da štedimo.

Znači, jednom zauvek moraju ove agencije ili komisije da nam naprave izveštaj gde mogu više same da budu profitabilne, jer znamo da one postoje već četvrtu, petu godinu sa UNMIK-ovom uredbom od 2008. godine, po zakonu, i do 2009. godine, sada je u toku 2010. godina i da više ovi autoriteti imaju praksu da počnu da rade, da pune budžet Kosova, a ne da budu na teret budžeta. Ovo kažem iz

razloga zato što ove kompanije, ove komisije i ovi autoriteti mogu da donesu. Moraju jednom zauvek da se identifikuju i kompanije koje nisu i koji su razlozi zašto nisu izvršile svoje obaveze. Mora da funkcionise pravna država, mora da funkcionise svaki sistem i ja se nadam da ovaj put neću biti pokrivena sa reklamom o svetskom prvenstvu kao u prošlom govoru. Hvala! Toliko od naše grupe!

KRYESUESI: Faleminderit, për saktësinë e vlerësimeve tuaja! Vazhdojmë me deputetin Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerare hyn në grupin e agjencive dhe komisioneve të pavarura të krijuara fillimisht mbi bazën e rregulloreve të UNMIK-ut, e më vonë mbi bazën e ligjeve që rrjedhin nga pakoja e Ahtisarit, që në përgjithësi ende kanë vështirësi serioze për t'i kryer detyrimet dhe përgjegjësitë në pajtim me normat ligjore dhe me standardet e kërkuara nga Bashkimi Evropian. Në të vërtetë, që të dyja rastet e hapësirës ligjore që rrumbullakojnë komisionet dhe agjencitë, vuajnë nga sindroma e improvizimit të natyrës së ligjshmërisë mbi bazën e së cilës ato do të duhej të funksionojnë. Kur këtyre ua shtojmë edhe ngathtësinë natyrale të unifikasve apo improvizimin e ngushtë të pakos së Ahtisarit, atëherë nuk ka nevojë të flitet shumë për ecurinë e rezultateve apo bilancin e tyre.

Arsyetimi i vërtetë i ekzistencës së KPMM-së për të qenë funksional në shërbim të ekonomisë dhe zhvillimit të vendit mund të jetë i suksesshëm në qoftë se e ruan parimin e pavarësisë, duke pasur për mision zhvillimin dhe rimëkëmbjen e sektorit minerar, mbështetur gjithnjë në kriteret shkencore.

Dy, në qoftë se përgjegjësi të vetë ka projekte minerare dhe mjedisore, njëkohësisht.

Tre, në qoftë si detyrim dhe mision të vetin ka vendimmarrjen dhe menaxhimin e rentës minerare, në shërbim të forcimit të ekonomisë dhe të buxhetit të vendit.

Katër, në qoftë se për qëllim të vetin ka ruajtjen e zonave minerare, ... dhe interesit shtetëror.

Pesë, në qoftë se për mision të vetin ndër të tjera ka planifikimin hulumtues dhe shfrytëzues të resurseve minerare, mbështetur në praktikën evropiane moderne. Shumë nga këto detyra dhe përgjegjësi KPMM-ja nuk po i trajton me parametra që do të ishin në funksion të zhvillimit të ekonomisë së vendit tonë. Prandaj, më lejon t'i drejtoj Kuvendit të Kosovës këto pyetje.

1. Sa ka qenë KPMM-ja në koherencë të zhvillimit institucional dhe shtetëror?
2. Sa ka qenë në funksion të zhvillimit të ekonomisë së vendit me projektet, strategjinë dhe planifikimin zhvillimor minerar. Hiç këtu licencën e gurore, por edhe kjo çështje do rishikuar rrënjësisht dhe sigurisht që ka vend për një auditim të ngutshëm profesional dhe shkencor për të vërtetuar ligjshmërinë e këtyre licencave dhe shkallën e degradimit të hapësirës mjedisore të Kosovës.
3. Në çfarë shkalle të zhvillimit edhe pas kaq vitesh e kemi gjendjen e minierave dhe përse atyre nuk u jepet licenca afatgjate, siç është rasti me minierat e Trepçës, ku jo vetëm që nuk u jepet kjo licencë, por edhe u tjetërsohen asetet e saj me bekimin e KPMM-së, prandaj për ta rrumbullakuar diskutimin, sugjeroj:
 1. KPMM-ja nuk duhet të jetë vetëm shpenzues i buxhetit, e ndërtuar sipas mendësisë dhe klaneve të UNMIK-ut.
 2. KPMM-ja të mos e keqpërdor mbiemrin e pavarur.
 3. KPMM-ja për të mos qenë mbi ligjin dhe interesin e vendit, duhet të largohet nga interesat klasore që e kanë ngulfatur.

4. KPMM-ja të mos mjaftohet vetëm me një raport vjetor para këtij Kuvendi.

Nisur nga këto që i theksova më lart, i rekomandoj Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kryesisë së tij që me urgjencë të gjenden format dhe mundësitë juridike që KPMM-ja, aspak funksionale dhe e dalë prej kohës, të ristrukturohet dhe të rivitalizohet për të qenë më kooperuese me të gjithë partnerët e sektorit minerar dhe me faktorë tjerë të ekonomisë së vendit. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Drita Kadriu!

DRITA KADRIU: Ju faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Diskutimi im meqenëse është në fund të debatit, do të jetë shumë i shkurtër dhe i përqendruar në dy-tri fjali.

Me këtë rast dua ta falënderoj KPMM-ën dhe Bordin e KPMM-së për punën dhe angazhimin që po bën dhe trendet pozitive që i ka krijuar pas emërimit të Bordit të ri në këtë institucion.

Meqenëse këtu u përmend edhe shpenzimet të cilat ndodhin në KPMM për zhvillimet profesionale, më lejoni që ta përkrah një shpenzim të tillë duke qenë se trendet globale të zhvillimit si teknologjik, ashtu edhe informativ janë në rritje të vazhdueshme, një institucion siç është KPMM-ja do të bëhet i paqëndrueshëm nëse nuk përcjell me edukim dhe arsimim të vazhdueshëm trendet e zhvillimit, prandaj zhvillimi i burimeve njerëzore brenda KPMM-së është i domosdoshëm dhe i përgjigjet koncepteve demokratike të shoqërisë - të mësuarit gjatë gjithë jetës. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ndonëse u thanë shumë gjëra, unë do të ndalem vetëm në një rast. Mendoj se opinionit duhet t'i qartësohet mirë kjo çështje. Veç u cek, në realitet e cekën dy kolege të nderuara, zonja Sala Shala dhe zonja Qamile Morina. Pra, do të flas për pronën e Trepçës, në realitet pronën e minierës së Kishnicës, në Çukë të Drazhnjes.

Siç dihet, para dy vitesh, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale Kompanisë Kosova Resources i pati dhënë licencë për hulumtime në një pronë në të cilën veç është hulumtuar dhe është hulumtuar nga viti 1953 deri në vitin 1990 nga ekspertët e Trepçës dhe kjo pronë, dihet që është afër liqenit të Batllavës. Dihet po ashtu se në këtë pronë janë të verifikuara 4.7 milionë tonë xehe, pra në këtë pronë që është 20 hektarë e 60 ari janë të verifikuara rezervat e xehes prej 4.700.000 tonë, ku 9% të xehes e përbën plumbi, 12% zinku dhe argjend ka 250 gramë për ton. Shtrohet pyetja – çka ka për t'u hulumtuar aty? Bile-bile, Trepça edhe pati hapur dy nivele të horizonteve, rrugën dhe oxhakun. Ajo që, apo arsyeja pse desha ta përmend këtë rast është shumë irrituese deklarata e një udhëheqësi të madh të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, zotit Naser Peci, që është zëvendës drejtor. Ai mediave u thotë se kur i është dhënë licenca Kosova Resources L.L.C., thotë se “ne nuk kemi pasur informata në atë kohë nëse ka pasur konflikt interesi e as sot nuk mund të konfirmojmë që ka pasur konflikt interesi”, dhe këtu është fundi i citatit të tij. Çdo kush e di dhe sado pak që është i informuar me këtë rast se kryeinspektori, zoti Aleksandro Valenta ka qenë edhe anëtar i Bordit të KPMM-së, do të thotë të Komisionit të Pavarur për Minerale dhe Miniera dhe bëhet menaxher i Kosova Resources, Domethënë, njeri që ka punuar apo që ka qenë në Bord të KPMM-së i jep licencë vetvetes.

E, unë, po ju lus, kushdo dhe sadopak që ka njohuri për konfliktin e interesave, le të ma shpjegojë se çka është konflikti i interesave, nëse ky rast eklatant nuk është konflikt i interesave. Nëse këtu nuk ka

marrëveshje të brendshme, sinqerisht unë nuk e di se çka është marrëveshja e brendshme. Njeriu t'i jep vetvetes licencë për të hulumtuar një parcelë e cila me vite të tëra është hulumtuar, mua tjetër send s'më tregon pos asaj se ka kurdisje, se ka korrupsion. Dhe, KPMM-ja nuk merret fare me këtë rast. Aq më tepër, zëvendës drejtori tenton ta arsyetojë këtë çështje.

Këtu u tha, KPMM-ja duhet të jetë e pavarur. Ai zotëri duhet ta dijë që merr rrogë nga Komisioni i cili, për nga definicioni duhet të jetë i pavarur. Dhe ne, si Kuvend, sinqerisht duhet të merremi me këto raste, sepse të punësuarit që nuk e kryejnë detyrën paguhen dhe rrjedhimisht duhet të suspendohen apo të përjashtohen nga puna, t'iu merret mandati. Dhe, nuk flasim për një pronë çka do, por flasim për një pasuri shumë të madhe. Kjo është ngjashëm siç ishte rasti me Ferronikelin. Njeriu i cili pati marrë pjesë në privatizimin e Ferronikelit, zoti Artan Bajrush, pasi të privatizohet atje bëhet drejtor, një prej më të mëdhenjve atje, menaxher i administratës, në marrëdhënie me publikun e tjera, e tjera. Kurrkund në botë s'bën, veç në Kosovë ka bërë vaki. Apo rasti i Luan Berishës në Lamkos. Dhe heshtin organet të cilat duhet të merren me të. E kanë parasysh se KPMM-në e ka krijuar UNMIK-u dhe kanë vepruar sipas tekeve, interesave të tyre, por ajo kohë ka përfunduar dhe ne duhet sinqerisht t'i kallëzojmë botës se seriozisht dëshirojmë të krijojmë një shtet funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca!

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

U mërzita pa fol sot në Kuvendin e Kosovës dhe desha që edhe unë të jap një kontribut modest në lidhje me raportin të cilin po e shqyrtojmë.

Unë nuk do t'i përsëris të gjitha ato vërejtje që i dha edhe kolegja në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, po edhe shumë deputetë që të gjithë të spektrit politik këtu që jemi në Parlament të ulur. Mirëpo, duke mos dashtë që t'i përsëris ato që u thanë, unë dëshiroj që rekomandimeve të komisioneve funksionale t'u shtohen edhe dy rekomandime nga ana e Kuvendit.

E para, që në këtë Agjencion të pavarur ka nevojë për një auditim të thuktë, është më se e nevojshme dhe duhet këtu ne si Kuvend të kërkojmë që aty të bëhet një auditim dhe të na sillet një raport për gjendjen e ligjshmërisë së veprimit në atë agjencion.

Dhe, e dyta, që Kuvendi të themelojë një komision hetimor i cili do të shqyrtojë në detale mënyrën, ligjshmërinë e veprimit të këtij agjencioni.

Nëse ne këtë agjencion e lëmë kështu si është, dëmi ekonomik i Kosovës do të jetë shumë i madh. Resurset që i menaxhon ky agjencion dhe për të cilat vendos janë tepër të mëdha, tepër të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës për hapin e zhvillimit, të perspektivës ekonomike në Kosovë. Vetë fakti se ky agjencion toleron ndaj operatorëve ekonomikë që mos t'i paguajnë obligimet që i kanë ligjore, në shumën prej 10 milionë eurove, flet mjaft. 10 milionë euro për buxhetin e Kosovës dhe për Kosovën në përgjithësi nuk janë pak para.

Pastaj, mënyra se si jepen licencat për hulumtime, tregon qartë se këtu ka probleme shumë serioze, ose ka konflikt interesi ose mund të ... këto veprime kaq noshalante, kaq komode, të këtij agjencioni na shtyn të dyshojmë se mund të ketë edhe vend për korrupsion në këtë agjencion. Kështu që unë mendoj se duke e përkrahur raportin, ne si Kuvend nuk mund të jemi indiferentë, por duhet të themelojmë një komision hetimor dhe të hetojë ligjshmërinë në këtë agjencion dhe njëkohësisht të kërkojmë një auditim të thuktë, siç thashë, të agjencionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ka shumëçka për t'u thënë lidhur me raportin, por vërtet është shqetësuese kjo se përse agjencioni ua ka vazhduar kontratat atyre ose s'e ka bllokuar punën e atyre që s'i kanë paguar tatimet dhe borxhet që kanë ndaj buxhetit të Kosovës dhe përse s'i ka pasqyruar taksat e grumbulluara nga licencat që janë dhënë.

Nuk janë botuar, nuk janë dhënë emrat e pronarëve të kompanive që i posedojnë këta gurthyes dhe nuk është dhënë ndonjë informacion se sa gurthyes punojnë pa leje në Kosovë dhe këtë do të duhej ta bënte për faktin se është një shumë enorme e shpenzimeve të karburantit prej 52.857 eurove dhe nuk kemi asnjë të dhënë se sa gurthyes janë pa leje.

Gjithashtu, edhe këto vizitat studimore do të duhej të ishin të shoqëruara me informacion se ku janë bërë këto vizita studimore dhe të ketë qenë e pasqyruar arsyeshmëria e këtyre lloj studimeve, vizitave studimore apo realisht jemi mësuar që në këtë farë kodin e shpenzimeve të buxhetit për mallra dhe shërbime të shkruajmë shifra dhe të humbin paratë. Faleminderit! Fjalën e ka Emrush Xhemajli!

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë vetëm desha ta përforcoj atë që u tha deri më tash sa u përket emrave të kompanive të gurthyesve dhe licencave që janë lëshuar për ta. Në raportin e kaluar janë kërkuar emrat dhe është thënë si rekomandim që të sillen së paku në këtë raportin që është pru tash dhe përsëri nuk janë pru, kështu që më lejoni t'ju ftoj që me këtë plotësim, ta plotësojnë me emrat e këtyre personave që i kanë guroret dhe pastaj qiten në votim. Ndërsa, tash për tash të kthehet, brenda një jave a dy kthehet, se këta i dinë domethënë kush janë këta, ta di edhe Kuvendi dhe u krye. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë besoj që edhe ky rekomandim mund të jetë një nga rekomandimet shtesë. Do të thotë, tani është radha e votimit dhe duhet ta hedh në votim. Është çështje e deputetëve a e votojnë apo jo, por kërkoj votimin e Raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009 me rekomandimet e komisionit funksional dhe rekomandimet e tjera, veçanërisht këto të fundit të deputetit Xhemajli, të votohen dhe lus regjinë e deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se Raporti me rekomandimet që u thanë më parë, u miratua me 45 vota "për", 11 "kundër" dhe 13 "abstenime". Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009

Konstatimet:

Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin e punës të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar raportin financiar të Komisionit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar, për miratim.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, Esat Brajshori, apo raportuesin e komisionit, për arsyetimin e raportit.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në pajtim me Rregullat 46.2 dhe 47.5 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2010 vendosi që për Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009 Kuvendit t'ia paraqes rekomandimin:

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për 2009, me vërejtjen e dhënë në arsyetim.

A r s y e t i m i:

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2010, pasi ka shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009, ka konstatuar se raporti është i strukturuar shumë mirë. Në mënyrë të detajizuar paraqet punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Është substancial, me përjashtim që raportit i mungon pjesa e të dhënave për të punësuarit pa konkurs në shërbimin civil të Kosovës, edhe pse komisioni ishte shumë i vetëdijshëm se kjo hallkë e hulumtimit, pra e punësimit pa konkurs, është shumë e vështirë për t'u hetuar dhe mbikëqyrur.

Pra, mendimi i Komisionit ishte ky për këtë raport dhe unë seriozisht ju kisha sugjeruar të gjithëve që ta kishin lexuar këtë raport dhe nëse për asgjë tjetër, mbase vërejtjet dhe debati i këtushëm do të mund ta ndihmonte shumë institucionet tona, si ato të nivelit lokal dhe ato qendror, por edhe agjencionit në lidhje me mënyrën se si shkelen të drejtat e nëpunësve civilë dhe pa përgjegjësinë e punëdhënësve për t'iu përgjigjur vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Atëherë, çfarë na sjell ky raport? Po ta lexojmë raportin, do të gjejmë shumë shkelje në të gjitha rrafshet dhe ajo që është më e keqja, vendimet që i sjell Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës në lidhje me rastet e caktuara ose nuk trajtohen fare nga organet ose punëdhënësit ose nuk kthehet përgjigje dhe kështu ngelen pezull ato vendime.

I ndodhur në këtë situatë, Këshilli Mbikëqyrës i Kosovës në rast se tash me Ligjin e ri që është në procedurë e sipër nuk fuqizohet, atëherë do të ishte e kotë të ekzistojë një këshill i tillë përderisa nuk respektohen nga institucionet vendimet e tij për rastet ekzakste, për rastet e sakta.

Një shërbim civil i pavarur, i qëndrueshëm dhe profesional, është garanci e fuqishme e funksionimit të shtetit, pavarësisht rrethanave dhe situatave të ndryshme. Nga mbikëqyrja e institucioneve që ka bërë KPMK-ja për respektim të Ligjit, ka gjetje të theksuara se ende jo të gjitha institucionet kanë dosje të personelit në nivelin e standardeve, përshkrime të punës të standardizuara, komisionet disiplinore dhe të ankesave që zbatojnë parimet që shpesh bëhen instrument me ndikim dhe nën presion në vendimmarrje, menaxherëve të personelit nuk u është dhënë roli dhe përgjegjësia që duhet ta kenë sipas ligjit. Institucioneve të cilave u janë dërguar rekomandimet, kanë treguar në të shumtën e rasteve papërgjegjësi dhe nuk u janë përgjigjur në vendimet e KPMK-së.

Gjatë vitit 2009, në KPMK kanë shkuar 288 ankesa të parashtuara nga nëpunësit civilë dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil. Gjatë këtij viti, 2009, shumica dërrmuese e ankesave kanë pasur për objekt kontestimin e konkurseve, ndërprerjen e kontratës së punës, mosvazhdimin e kontratës së punës, degradimin nga pozita, suspendimin nga puna dhe të tjera. Pra, një mori argumentesh që flasin shumë për shkeljen e të drejtave të shërbyesve civilë, përkatësisht mosrespektimin e vendimeve të KPMK-së në lidhje me këto raste.

Nëse ndalemi te faqja 21 e Raportit vjetor 2009, ne do të gjejmë të dhëna interesante, por edhe shqetësuese sa i përket ankesave të aprovuara, pjesërisht të aprovuara, ex-officio dhe ekzekutimi i tyre. Raporti sjell të dhënat edhe në përqindje edhe të përshkruara se sa ankesa ka pasur dhe sa prej tyre nuk janë realizuar, përkatësisht nuk janë respektuar.

Vendimet e KPMK-së janë të obligueshme dhe ato duhet të zbatohen, por përkundër këtij fakti që vendimet e KPM-së janë të formës së prerë në procedurë administrative, prej 169 ankesave të aprovuara, pjesërisht të aprovuara dhe ex-officio autoritetet punëdhënëse nuk i kanë zbatuar 76 vendime, që për ne paraqet një shqetësim të madh. Në këtë drejtim, shqetësim paraqet edhe fakti që autoritetet punëdhënëse nuk kanë njoftuar fare KPMK-në për zbatimin apo jo të një numri të theksuar të vendimeve, e që ky numër shkon në 46 raste.

Si përfundim, për të mos ju mërzhitur dhe për të mos e marrë kohën më tepër, unë mendoj se Këshilli Mbikëqyrës i Pavarur i Kosovës në formën e tanishme të veprimit të vet nuk do të kishte asnjë rëndësi të funksionimit të mëtutjeshëm në rast se institucionet gjegjëse dhe ato të pushtetit lokal dhe qendror nuk i zbatojnë vendimet që i ndërmerr.

Ndryshe, zoti kryesues, unë edhe në emër të Grupit të AKR-së paraqita fjalën time, megjithëse kolegët e grupit mund të kenë pikëpamje të tyre. Faleminderit shumë!

Seancën e drejton zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Dinanca, nuk ka të paraqitur. Kalojmë te përfaqësuesit e grupeve. Atëherë, në emër të Grupit të PDK-së, fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009.

Raporti në tërësinë e tij është përmbajtjesor, shumë mirë i hartuar, i cili pasqyron deri në detalin e fundit punën e këtij këshilli. Ajo që shihet në raport, tregon se Këshilli me kujdes, përkushtim dhe përpikëri ka kryer detyrat që i ka në mandatin e tij me përqendrim të theksuar në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civilë, aplikuesve për punësim në shërbimin civil, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe parimet mbi shërbimin civil.

Po ashtu, KPMK ka pasur angazhim dhe përkujdesje të shtuar në sforcimin e idesë për një shërbim civil të pa ndikuar, të pa anshëm, profesional, të përgjegjshëm me qëllim të krijimit të një administrate funksionale dhe efikase.

Në raport në mënyrë të detajuar KPMK-ja ka pasqyruar numrin e ankesave të parashtruara, nga ankuesit që janë gjithsej 288 ankesa. Nga ky numër i përgjithshëm i ankesave të parashtruara nga nëpunësit civilë dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil, prijnë administratat komunale, institucionet qendrore dhe agjencitë e pavarura ekzekutive.

Nëse bëjmë një krahasim të ankesave nëpër këto institucione, shihet se kemi një ndryshim. Në institucionet qendrore numri më i madh i ankesave të parashtruara është ndërprerja e kontratave të punës, pastaj kontestimi i konkurseve e kështu me radhë. Në komuna kemi numrin më të madh të

ankesave në objekt ankimi, kontestimin e konkurseve, pastaj shkëputjen e kontratave e kështu me radhë, ndërsa tek agjencitë e pavarura është e kundërta, ku numri më i madh i ankesave është degradimi nga pozita që pason me kontestimin e konkurseve.

Serioziteti i punës së Këshillit përmes komisionit shihet edhe në tabelën përmbledhëse mbi ankesat e zgjedhura, që është paraqitur në bazë të viteve në faqen 19 të këtij raporti. KPMK gjatë vitit 2009 ka zgjidhur gjithsej 358 ankesa. Vendimet e KPMK-së janë vendime administrative të formës së prerë dhe ndaj tyre nuk lejohet ankesa, por që iu nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin, do të thotë, se vendimet e KPMK-së janë të obligueshme që të zbatohen nga organet punëdhënëse. Mirëpo, në raport shihet se kemi një numër të këtyre vendimeve të cilat nuk janë ekzekutuar nga institucionet e ndryshme dhe për këtë duhet kërkuar që këto institucione t'i përmbushin obligimet e tyre në zbatimin e vendimit të KPMK-së.

Gjithashtu, KPMK ka bërë vizita nëpër institucione qendrore dhe lokale, me qëllim të vlerësimit se sa autoritetet punëdhënëse e zbatojnë bazën ligjore që e mbulon këtë fushë. Në këtë drejtim, Këshilli ka konstatuar në disa raste shkelje të zbatimit të Ligjit mbi shërbimin civil, të procedurave dhe të parimeve udhëheqëse mbi shërbimin civil dhe për këtë KPMK ka dhënë rekomandimet e tyre për secilin institucion ku janë vërejtur parregullsi me qëllim të përmirësimit dhe të përmbushjes së këtyre rekomandimeve.

KPMK gjatë vëzhgimit të procedurave të zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve në shërbimin civil të Kosovës, në 63 raste të vëzhgimit ka vërejtur se ka përparime të dukshme në zbatimin e procedurave ligjore dhe të parimeve të shërbimit civil. Në raport KPMK ka paraqitur edhe sfidat me të cilat është përballur dhe që do të përballtet edhe këtë vit, natyrisht një përkrahje financiare për KPMK-në do t'i ndihmonte në realizimin e të gjitha objektivave që ka Këshilli në punën e mëtutjeshme.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka vlerësuar lartë punën që ka bërë Këshilli, e po ashtu përkrah Raportin për vitin 2009 dhe do ta votojë, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kryetari i Grupit, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë pajtohem me dy parafolësit se ky raport i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që në fillim po e them, është një raport mjaft i mirë, i detajuar dhe gjithëpërfshirës, raport i cili përshkruan apo jep të dhëna pothuaj se në detaje, për të mos hyrë të përsëris shumëçka që u tha, që nga organizimi i brendshëm, funksionin e KPMK-së, numrin e ankesave, ankesat sipas institucioneve, gjegjësisht ato të nivelit qendror, lokal, institucioneve të pavarura, numrin e ankesave të zgjidhura ose të aprovuara, të gjitha këto të dhëna, numrin e atyre të cilat janë të ekzekutuara, që është shumë e rëndësishme për këtë këshill, funksionimin ose si funksionon si organ mbikëqyrës, funksionin e vëzhgimit, bashkëpunimin, por sigurisht edhe për problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet. Mund të them se për ne, si Grup Parlamentar, por edhe për vetë Këshillin, në bazë të asaj çfarë shkruhet dhe thuhet në raport – problem dhe sfida ka qenë vazhdimisht, deri në një kohë të fundit, mos kompletimi i vetë anëtarëve të Këshillit ose vetë Këshillit me anëtarë të nevojshëm, pastaj numri bukur i madh i rasteve të bartura nga vitet paraprake, si dhe mos ekzekutimi i një numri mjaft të madh të rekomandimeve, gjegjësisht të vendimeve që i merr ky këshill.

Padyshim se ndihmesë për Këshillin e pavarur mbikëqyrës të Kosovës do të duhej dhe është në një mënyrë vetë Ligji i miratuar për shërbyesit civilë, si dhe besojmë së shpejti edhe në leximin e dytë

Ligji i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që pritet të miratohet së shpejti, do të ishte një ndihmesë e mirë në mënyrë që ky këshill të jetë edhe më funksional dhe më efektiv.

Padyshim se bien në sy të dhënat tabelare që janë dhënë, realizimi edhe i buxhetit, pse jo, aq sa e ka ky këshill, por që të bën përshtypje ajo se është realizuar posaçërisht, për shembull, në disa kategori që diku-diku nëpër agjencione tjera nuk haset shpesh, për shembull, te pagat dhe mëditjet më pak është përqindja e realizimit, e nuk do të thotë se kanë mbetur pa paga këta, se sa tek kategoria e shërbimeve dhe mallrave, shërbimeve komunale, shpenzimeve kapitale – çka është për t'i përgëzuar për këto kategoritë tjera që kanë realizuar një përqindje mjaft të lartë të mjeteve aq sa i kanë.

Po ashtu, rekomandimet që janë dhënë në këtë raport, janë shumë specifike, janë konkrete, të adresuara në adresat përkatëse dhe ajo që na mbetet gjithë ne, edhe këtij Kuvendi si organ, si institucion i cili e ka formuar dhe zgjedh këtë këshill, është ajo që ta përkrahim punën e tyre sepse nuk mjafton, konsiderojmë edhe si Grup parlamentar, që vetëm t'i zgjedhim, por edhe t'i përkrahim dhe sigurisht edhe t'i kontrollojmë dhe mbikëqyrim në punën e tyre sepse është obligim yni.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah këtë raport të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës është një raport i përgatitur mjaft mirë, është ndër raportet ndoshta të rralla që përgatiten dhe vijnë si të tillë në Parlamentin e Kosovës, prandaj mund t'i përgëzojmë edhe publikisht anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për raportin që e kanë sjell në Parlament.

Raporti është i punuar mirë, por puna e Qeverisë nuk është e mirë. Nga raporti shihet se gjendja e shërbimit civil është shumë shqetësuese. Menaxhimi me shërbimin civil po degradon çdo ditë e më tepër.

Besoj se të gjithëve ju kujtohet se Qeveria në fillimin e punës së saj, pra kjo Qeveri ka proklamuar dhe ka garantuar që nuk do të ketë asnjë largim të punonjësve të shërbimit civil dhe ne e dimë mirë që aktualisht Qeveria punon me ushtrues detyre të sekretarëve permanentë, punon me ushtrues detyre të kryeshefave ekzekutivë, madje ka shkuar edhe deri në skajshmërinë kur vetë kryeministri i emëron dhe i shkarkon kryeshefat ekzekutivë. Dhe nga kjo nuk ka asgjë të vërtetë, sepse nga ky raport shihet se 6.9% të ankesave janë për mos vazhdimin e kontratës së punës në shërbimin civil, ndërsa ndërprerje të kontratave të punës në shërbimin civil ka 22.5% të ankesave. Po ashtu, në raport ne kemi parë se kontestim të konkursit ka në 39.9% të ankesave, që flet dhe tregon një dëshmi për ndërhyrje të plotë të politikës në shërbimin civil.

Është tepër shqetësues moszbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, sepse Qeveria edhe më tej i injoron këto rekomandime, por edhe një pjesë e komunave injorojnë zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, një organ të cilin e ka themeluar dhe që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

Një çështje shumë brengosëse është punësimi pa konkurs në shërbimin civil. Ka informacione, jo zyrtare, që Qeveria ka punësuar një numër enorm në shërbimin civil pa konkurs dhe kjo mendoj se

paraqet një problem tepër të madh për funksionimin e shërbimit civil të Kosovës dhe për punën e ligjshme të shërbimi civil të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah raportin, me kërkesën që në Parlament të sillen të dhënat për punësimet pa konkurs në shërbimin civil, gjë që është edhe kërkesë e vetë komisionit funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, siç tha, u prononcua më herët deputeti Esat Brajshori. Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsiderojmë se roli dhe funksioni i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës është parësor dhe i një rëndësie të veçantë dhe është institucioni më i lartë, mandati i të cilit është i përqendruar në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civilë dhe të aplikuesve për punësim në shërbimin civil të Kosovës, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe të parimeve mbi shërbimin civil, që për punën e vet KPMK-ja i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Kuvendit.

Raporti të cilin KPMK e ka sjell në Kuvend, e të cilin sot po e debatojmë, përmbush kriteret e nevojshme për raportim dhe është i strukturuar mjaft mirë si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja e tij dhe konsiderojmë se është një shembull i mirë dhe model që do të mund të shërbejnë institucionet tjera se si raportohet para Kuvendit.

Raporti i KPMK-së për vitin 2009 ka strukturë mjaft të mirë të ndërtuar dhe pasqyron në mënyrë të detajizuar çdo aktivitet dhe punë që ka kryer Këshilli, të gjeturat apo performancën e institucioneve të Kosovës për vitin 2009 dhe përfundon me rekomandimet që Këshilli i ka dhënë për ministritë, komunat dhe institucionet tjera të pavarura.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah Raportin e punës së KPMK-së për vitin 2009 dhe e mbështet në vazhdimësi punën që kryen ky këshill, i cili si synim ka krijimin e një shërbimi civil të pavarur, të qëndrueshëm dhe profesional, efikas e të përgjegjshëm, duke e respektuar ligjin dhe kodin etik, mirëpo brengosës mbetemi nga fakti se edhe më tej nuk është arritur të krijohet institucione të cilat synim të vetëm kanë arritjen e këtyre objektivave.

Duke iu referuar raportit në fjalë, shihet se edhe më tej në institucionet e shërbimit civil nuk është arritur profesionalizëm i duhur, zyrtarët e lartë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare tregohen të papërgjegjshëm dhe të ndikuar nga faktorë të ndryshëm, si ai politik, nepotizmi dhe faktorët tjerë. Thjeshtë, mungon respektimi i ligjit dhe shkeljet në mënyrë drastike nga institucionet.

Shqetësim tjetër i yni janë edhe ankesat e nëpunësve civilë, procedurat e rekrutimit, avancimet të cilat nuk bëhen sipas meritave dhe procedurës, vlerësimi i performancës jo objektiv, kontratat e punës nuk lëshohen dhe nuk ripërtërihen me kohëzgjatje dhe në pajtim me ligjin, pastaj mungesa e dosjeve të personelit, përshkrimet e punës, mosformimi i komisioneve disiplinore dhe të ankesës, dobësi këto që edhe më tej po i përcjellin institucionet tona dhe përkundër rekomandimeve të marra nga KPMK-ja në vitet e mëparshme për këto çështje prapë nuk kemi një performancë apo ndryshim të gjendjes. Kjo neglizhencë dhe pa përgjegjësi nga moszbatimi i rekomandimeve që bëjnë institucionet tona do të tregojnë performancë të dobët dhe do të shkaktojnë shpenzime të tepërta në buxhetin e Republikës së Kosovës, e sidomos të rasti i kontratave të ndërprera në mënyrë të paligjshme.

Dhe, krejt në fund, të nderuar qeveritarë, edhe pse asnjëri nuk jeni këtu, por të paktën ndoshta do të keni mundësi nga mediat të na dëgjoni, pyesim: kur do të ndërgjegjësoheni dhe mësoheni t'i respektoni vendimet e institucioneve që vetë i krijoni, sepse edhe KPMK është institucion i dalë nga Kushtetuta dhe ligjet e këtij vendi dhe kjo neglizhencë në zbatimin e vendimeve të tyre nuk ka kuptim. Edhe për sa kohë do të vazhdoni të punoni me ushtrues detyre si sekretarë permanentë, kryeshefa ekzekutivë dhe drejtorë të institucioneve të veçanta, apo edhe krejt kjo punë e Qeverisë është e përkohshme dhe ka një mandat shumë të kufizuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući! Mi ćemo podržati ovaj izveštaj ove komisije, sa jednom napomenom da već dugo vremena odluke ove komisije za mnoge u organizacijama ne važe i da su se mnogi radnici nakon što dobijaju pozitivan odgovor Nezavisne nadzorne komisije, budu upućivani na sud da traže sudsku odluku. Kada bi to tako bilo, onda nije potrebna ova komisija, ovi će ljudi direktno tražiti svoju zaštitu preko suda. To je praksa koja se ponavlja i zaista treba da se da značaj odlukama koje donosi ova komisija i da se vrši češća kontrola da li se te odluke sprovede. Ukoliko je praksa, kako je znamo, onda ova komisija po nekad nema ulogu koja joj je namenjena. Mi ćemo podržati izveštaj ove komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar SLS, nuk është paraqitur askush për diskutim dhe në emër të grupit të fundit, pra të Grupit për Integrim, fjalën e ka kërkuar deputeti Branislav Gërbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući!

Parlamentarna grupa za integracije je Izveštaj Nezavisnog nadzornog odbora Kosova uzela u razmatranje i u skladu sa, mogu reći slobodno, moralom jednog društva koja teži sigurno nekim novim standardima i standardima ponašanja svih građana, konkretno građana Kosova, konstatacija je da ova komisija zaista ima problema, po gotovo problema u tom civilnom sektoru, odnosno institucijama Kosova koje žele svojim autoritetom, svojim zalaganjem i svojim jednim autoritetom da stvore jedno društvo koje će biti u korist svih građana Kosova, znači u jednom multietničkom prostoru kao što je Kosovo.

Ono što je iznela Komisija, a to je činjenica da moguće u onom segmentu gde mi želimo da kroz jedan brzi proces, proces opismenjavanja i postavljanja na pozicije koje su jako odgovorne sa neozbiljnim ljudima, želimo da stvorimo jedan imidž Kosova da zaista imamo političko društvo koje je spremno za neke nove promene. U tom kontekstu, mogu reći slobodno u okviru svoje zajednice da je Ahtisarijev plan pružio dosta mogućnosti za razvoj i planove i programe srpske zajednice. To je jedan prostor koji smo mi trebali iskoristiti na jedan adekvatan način i da spoznajom kvaliteta i standarda građana, po gotovo srpske zajednice, koji bi želeli da uzmu učešće u institucijama Kosova, stvore jedan autoritet koji će biti za respekt. Međutim, bojim se da smo to poverenje zloupotrebili i da smo na jedan neozbiljan način postavili ljude koji su neodgovorni i trenutno nisu u mogućnosti da sprovedu sve zakonske procedure i ujedno da stvore jedan novi autoritet društva. U tom kontekstu, rekli bi da Republika Kosovo da bi imala jednu efikasnu nepristrasnu civilnu službu, zasnovanu na zaslugama i koja oslikava multietnički karakter Kosova, mora da se postigne potrebna stručnost, nepristranost, savesnost i poštovanje etičkih kodeksa i sprovođenje zakonskih procedura. U tom kontekstu, sigurno smatramo da i ove preporuke idu u jednom pozitivnom pravcu ka, znači, formiranju jednog moralnog društva, društva znači standarda, gde će se ceniti kvalifikacije i da sigurno te kvalifikacije biće odraz jedne..., ne samo jednog tehničkog sprovođenja života na Kosovu, nego već i jednog političkog morala koji će ipak, računajući na sve partije koje su na Kosovu, stvoriti jednog modernog kosovara koji će

imati svoje standarde i principe ponašanja. I u tom kontekstu, Grupa za integracije želi da podrži ove preporuke i mi se zahvaljujemo. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Vazhdojmë me radhën e deputetëve të paraqitur për diskutim. Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, le të përgatitet deputetja Mimoza Ahmetaj.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Në princip, unë do ta përkrah Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur mbikëqyrës të Kosovës, sepse sipas mendimit tim, është një raport mjaft detal, me shumë të dhëna të paraqitura dhe i afron Kuvendit të Kosovës që të ketë një pasqyrë të qartë se çka në të vërtetë ndodh në shërbimin civil të Kosovës. Mirëpo, çka nuk ishte dashur të ndodhë, gjithashtu mund të nxirret nga ky raport. Për shembull, te zbatimi i vendimeve të KPMK-së nga organet punëdhënëse. Këtu ne kemi një tabelë, në të cilën paraqiten të gjitha institucionet, se sa vendime nuk i kanë ekzekutuar ashtu siç janë të detyruar, siç janë të obliguar pas sugjerimeve të KPMK-së, pas vendimeve të marra nga KPMK-ja. Dhe, çuditërisht, nga ministrinë qendrore që janë, figuron se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë udhëheq bindshëm e para me 5 raste të vendimeve të pa ekzekutuara. Por, kuptueshmëria që transmetohet me këtë rast, kuptueshmëria dhe mesazhi që transmetohet me këtë rast vetëm përmes semantikës së fjalëve, vendimeve të pa ekzekutuara, disi-disi nuk e shpjegon krejt çka në të vërtetë po nënkuptohet me vendimet e pa ekzekutuara dhe dua të tentoj që të transmetoj çka në të vërtetë ndodh. Ndodh se atje ka ndodh, nëpër ministri, nëpër institucione, nëpër komuna se nuk është respektuar legjislacioni, që nuk janë respektuar normat ligjore, nuk është respektuar Ligji i shërbimit civil të Kosovës.

Dhe, këto vendime, pasi që është ndarë drejtësia, prapë nuk i ekzekuton. Me fjalë të tjera, është një keqpërdorim i pozitave të zyrtarëve që janë të obliguar t'i respektojnë vendimet që i nxjerr KPMK-ja. Obligohet sekretari i përhershëm, kryeshefat ekzekutivë, që pas një pritje, janë procedura të përfunduara dhe te obliguar që të respektojë organin e KPMK-së dhe vendimet e KPMK-së. Po, është pak edhe sa e çuditshme, qysh është e pritshme nga ministrinë që t'i respektojnë kur vetë ministrinë në sekretarinë e veta, sekretarët e përhershëm, i kanë pasur të vendosur këshilltarët e vet politikë! Nëse këshilltari politik është vendosur sekretar i përhershëm, maja e piramidës, numër një, niveli më i lartë hierarkial ka bërë thyerje flagrante të ligjit. Dhe, normalisht që nuk pres unë personalisht dhe askush nuk mund të presë që ai që e ka thyer vetë ligjin, të respektojë rekomandimet e KPMK-së. Dhe, çka fillon? Fillon një odiseadë e re dhe fillon që Gjykata Supreme, që është obligative vetëm të japë mendim për konflikt të mundshëm administrativ, sepse KPMK-ja është fjala e fundit dhe obligohet ministria apo institucioni tjetër, komuna e agjencitë ekzekutive që të implementojnë vendimin e KPMK-së. Dhe, më pastaj fillohet me atë se Gjykata Supreme e kthen lëndën në gjykatë komunale. Me fjalë të tjera, e rrënojnë krejt sistemin!

Ne edhe përmes disa pyetjeve parlamentare sot thamë se nuk është mirë të tentohet të rrënohet sistemi. Edhe ky raport, na thotë se po – ka tendencë për rrënimin e sistemit të drejtësisë për ta mjegulluar situatën.

Unë, për deputetët që janë këtu prezentë, por edhe për ata që do të dëgjojnë fjalimet apo edhe që lexojnë transkriptet e deputetëve, iu kisha thënë se më mirë është të jemi pak më të fokusuar që të kërkojmë nga të gjitha institucionet qeveritare, por edhe komunat e Kosovës që ta respektojnë ligjin, që të respektojnë vendimet e KPMK-së, se sa me eskivazhe politike gjëja se nuk ka asgjë politike. Ke të bëjë me njerëz që kanë qenë në punë, iu ka shkelë e drejta një njeriut të zakonshëm të Kosovës. Nuk është politike, s'është as partiake. Është thjeshtë humane, është pak edhe etike.

Për shembull, unë po e ilustruj me një rast kur KPMK-ja e obligon ministrinë përkatëse që të zbatojë urdhrin, të zbatojë vendimin e KPMK-së, kurse ministria përkatëse e zvarritë. Një teknikë e zgjatjes së procesit – zgjate sa më shumë që mundesh, se edhe nëse kthehet, le të kthehet kur unë nuk jam aty.

Rastin që e përmenda, për të qenë korrekt me të gjithë ata, meqenëse s'po dua të mos jem korrekt, se rasti në Ministrinë e Shëndetësisë, ku KMPK-ja thotë se duhet të kthehet menaxheri i prokurimit, njeriu qendror në procesin e blerjes, në procesin e tenderëve, me fjalë tjera të themi popullorçe, nuk e respekton vendimin e KPMK-së dhe fillon të zbulojë me logjikën e vet ide se si të ikë. Ne duhet të kërkojmë që të respektohet vendimi, se edhe tentojnë për t'u bërë pak më të mençur se që ua lejon ligji, por edhe ndoshta kjo mund të jetë normale se nuk iu konvenon të jenë ligjorë, të jenë të respektuar ndaj ligjit, nuk iu konvenon dhe tentojnë të bëhen më të mençur, sepse secili hajn nuk ka qejf ta shohë policin më të mençur se vet, se nuk i leverdisë! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj, le të përgatitet deputeti Riza Smaka. Regjia, fjalën deputetes Ahmetaj!

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, falënderoj Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për raportin e thuktë të dërguar për debat.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës është organ i pavarur që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Kuvendit të Kosovës. Gjatë periudhës raportuese ka hasur në vështirësi të theksuara, të cilat kanë penguar këtë institucion për përmbushjen me përpikëri të tri funksioneve të cilat ia përcakton baza ligjore, e ato janë: funksioni i shqyrtimit të ankesave të parashtruara nga shërbyesit civilë, funksioni i mbikëqyrjes dhe funksioni i vëzhgimit.

Duke e shikuar raportimin e të dhënave në sektorin e funksionimit të ankesave gjatë vitit 2009, KPM-së i kanë arritur 288 ankesa të parashtruara nga nëpunësit civilë dhe aplikuesit. Këtë e dëshmon edhe natyra e bazës ligjore, si dhe kategorizimi i tyre sipas objektit, sipas strukturës nacionale dhe sipas strukturës gjinore.

Gjatë vitit 2009, shumica dërmuese e ankesave kanë pasur për objekt kontestimin e konkurseve – 89 ankesa gjithsej, ndërprerja e kontratës së punës – 65 ankesa, kompensimi material – 47 ankesa, degradimi nga pozitat – 31 ankesa, masat e tjera disiplinore – 31, mosvazhdimi i kontratës – 20 ankesa dhe të tjera – 5 prej tyre.

Nga gjithsej 288 ankesa të pranuar nga KPM-ja del se numri më i madh i ankuesve janë meshkuj dhe atë 220, ndërsa femra 58. Sipas strukturës nacionale, edhe pse shqiptarët i janë drejtuar KPM-së me numrin më të madh të ankesave dhe atë 276, serbët 4, turq 2, boshnjakë 3 dhe të tjerë.

Gjatë vitit 2009, ndaj ministrive të Republikës së Kosovës janë ushtruar 81 ankesa. Objekti i këtyre ankesave është ndërprerja e kontratave dhe kontestimi i konkurseve. Ministria e Punëve të Brendshme prin me numrin më të madh të ankesave me gjithsej 12.

Komisionet e KPM-së i kanë shqyrtuar dhe kanë marrë vendim për 50 ankesa, ndërsa pjesa tjetër e ankesave ka mbetur për shqyrtim dhe vendim në vitin 2010. Nuk mendoj se është i kënaqshëm numri i ankesave të shqyrtuara. Ankesat duhet të kryhen në afate kohore, sa më të shkurtra që është e mundshme.

Gjatë vitit 2009 edhe ndaj komunave janë ushtruar 163 ankesa, ku numri më i madh i ankesave është kontestimi i konkurseve. Gjendja e shqyrtimit të ankesave në komuna është më e pakënaqshme. Nga

gjithsej kërkesa të pranuar, komisionet e KPM-së kanë shqyrtuar dhe vendosur 84 ankesa, ndërsa për shkak të bartjes së ankesave nga vitet paraprake, 79 ankesa të vitit 2009 janë bartur për t'u vendosur në vitin 2010.

Edhe ndaj agjencive dhe institucioneve tjera të pavarura si autoritetet punëdhënëse, gjatë vitit raportues 2009 KPM-ja ka pranuar 44 ankesa, ku objekt i ankimit ka qenë degradimi nga pozita dhe kontestimi i konkurseve. Komisionet e KPM-së kanë shqyrtuar dhe vendosur 32 ankesa, ndërsa 12 ankesa kanë mbetur për shqyrtim në vitin 2010.

KPM-ja gjatë vitit 2009 përmes komisioneve i ka zgjidhur gjithsej 358 ankesa. Prej këtyre ankesave, të vitit 2009 kanë qenë 180, ndërsa të viteve paraprake 178.

Për të siguruar nëse autoritetet punëdhënëse zbatojnë apo jo bazën ligjore, Këshilli gjatë vitit 2009 ka bërë 80 vizita në institucionet qendrore dhe lokale. Me përjashtim të 5 komunave, si: Graçanicë, Leposaviq, Zubin-Potok, Zveçan dhe Partesh, edhe përkundër përpjekjeve që ka Këshilli për të realizuar vizitë edhe në këto komuna, gjatë mbikëqyrjes së punës praktike të vitit raportues, KPM-ja ka konstatuar disa shkelje të zbatimit të Ligjit mbi shërbimin civil.

Të gjeturat kryesore të KPM-së gjatë inspektimit të punës nëpër institucione janë:

Menaxhimi i personelit. Shumica i institucioneve si ato qendrore, ashtu edhe ato lokale nuk kanë zbatuar plotësisht obligimin ligjor që menaxheri apo udhëheqësi i personelit të ketë rolin përgjegjës dhe autorizimet që i takojnë me ligj dhe në disa raste nuk kanë fare menaxher të personelit;

Procedurat e rekrutimit dhe selektimit. Në disa institucione rekrutimi i nëpunësve civilë nuk iniciohet dhe aprovohet në pajtim me procedurat.

Procedurat e kontratave. Kontratat e punës lëshohen me kohëzgjatje në kundërshtim me procedurat dhe ligjin; lëshimet e kontratave mbi vepër, që është shkelje e ligjit, pasi që në shërbimin civil njihen vetëm kontratat e punës pas zbatimit të procedurave të rregullta përmes konkursit publik.

Procedurat e ankesave. Disa institucione nuk kanë themeluar komisionin e ankesave.

Procedura disiplinore. Disa institucione nuk kanë themeluar komision disiplinor.

Pastaj, në disa institucione plani i punës provuese nuk bëhet në pajtim me procedurat dhe ligjin, ndërprerja e punës, përshkrimi i pozitës, vlerësimi i kryerjes së punëve, procedurat mbi pushimet, orarin e punës, mbi mundësitë e barabarta, dosjet personale, trajnimet.

KPM-ja ka vërejtur se shumica e institucioneve, si qendrore, ashtu edhe ato lokale nuk kanë zbatuar plotësisht procedurat, ligjin dhe parimet mbi shërbimin civil. Me qëllim të përmirësimit të punës, KPM i ka dhënë rekomandime çdo institucioni ku janë vërejtur parregullsi dhe nevoja të domosdoshme për përmirësim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka një funksion specifik në vëzhgimin e zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve në shërbimin civil të Kosovës. Në të gjitha ministritë, agjencitë ekzekutive dhe komunat e Kosovës, në kuadër të përmbushjes së funksionit të vëzhgimit, KPM gjatë vitit 2009 në autoritetet punëdhënëse ka realizuar 63 vëzhgime të zgjedhjes së 66 drejtorëve të departamenteve dhe të nivelit të njëjtë.

Moskompletimi i anëtarëve të Këshillit, numri i madh i ankesave të bartura nga vitet paraprake, mosekzekutimi i vendimeve të KPM-së nga ana e autoriteteve punëdhënëse, buxheti i pamjaftueshëm, të gjitha këto janë disa nga vështirësitë me të cilat është ballafaquar KPM-ja gjatë vitit 2009. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

RIZA SMAKA: Zotëri kryesues, Deputetë të respektuar, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës virtualisht është gjykatë administrative e instancës së dytë që miraton akte përfundimtare ekzekutive. Është institucion kushtetutar, pra është një organ i rëndësishëm që aktet e tija do të duhej të përfillëshin pa kurrfarë pardonimi, po në praktikë mjerisht ndodh e kundërta, gjë që këndo që është dashamirë për çështjen e Kosovës, e zhgënjën, e dëshpëron.

Në këtë kontekst do të parafrazoj Herodotin, së paku 25 shekuj më parë, që thoshte për një popull të madh të Ballkanit se është barbar për faktin se nuk i paska pas përfillë ligjet e veta. Po çfarë do të thoshte ai sot për shtetin tonë në ditët e sotme?

Shkurtimisht dhe përfundimisht, raporti reciprok i politikës dhe i juridikës jep dy kreatura:

Një, në qoftë se politika i superponohet, i supervenohet me violencë juridikes, provon shtet partiak. Po në qoftë se juridika i superponohet ashtu si do të duhej të ishte e politikës ditore, e provon shtetin e së drejtës. Unë gjykoj me bindje se në këtë rast do të duhej ta ngrehnim një komision kuvendar hetimor dhe të konstatonte kush janë ata “faktorë”, që i quajmë në thonjëza, me ironi sarkastike, që nuk i përfillin aktvendimet e formës së prerë? Kush janë ata, kush janë ato që e nëpërkëmbin Kushtetutën dhe faktet ligjore të bazuara në Kushtetutë, pra rendin juridik të Kosovës, a plotë gojën e kanë patriotizëm?! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputetja Sanije Alijaj.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë, Do të mundohem të jem shumë i shkurtër, pa e lexuar asnjë rresht ndoshta të raportit. Në fillim duhet konstatuar se gjendja aktuale në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, nëse krahasohet me vitet e mëparshme, është jashtëzakonisht e mirë dhe nga raporti mund të vijmë në përfundim se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nga koha kur ka kaluar në Kuvendin e Kosovës, ka luajtur tamam rolin për të cilin është i themeluar tani me rregullore, mirëpo tash së shpejti do ta ketë edhe Ligjin bazik mbi funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, por unë do të doja të diskutoj për tri çështje, se çka duhet të bëjë Kuvendi i Kosovës që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të jetë funksional dhe në interes të kategorisë për të cilën është themeluar për shërbimin civil të Kosovës.

Çështja e parë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës duhet të ndryshojë strategjinë dhe duhet që në momentet kur ka dhënë rekomandimet për të gjitha organizatat buxhetore, qoftë për mospërfillje të konkursit, qoftë për mospërfillje të vendimeve, qoftë për mospërfillje të rekomandimeve të Komisionit për çështjen e ankesave, apo parashtrësive që janë bërë, apo qoftë për rekrutim, duhet të veprojë me kohë, t'i ndalojë dhe të ngritë zërin që ato mos të marrin formën përfundimtare. Domethënë, ta ndalojë procesin, sepse në anën tjetër Kosovës dhe buxhetit të Kosovës po i kushton shumë.

Janë shumë me interes rekomandimet që kanë dalë për të gjitha organizatat buxhetore që i ka dhënë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, por do të ishte shumë me interes që ato të ndalohen në procesin deri sa janë duke u rekrutuar apo deri sa aty nuk kanë filluar punën shërbyesit civilë nëpër organizatat buxhetore.

Çështja e dytë, Shumë më intereson fakti dhe ndoshta do të duhej ta bëjmë krahasimin sa mjete janë harxhuar për shkak të asaj që organizatat buxhetore nuk i kanë ekzekutuar vendimet e organizatave buxhetore. Nëse e shihni me përqindje, është një numër shumë i madh, domethënë, i kontratave të punës të cilat mandej janë mbrojtur pranë sistemit të organeve të drejtësisë dhe këto në vete kanë marrë implikime buxhetore, domethënë me vete përveç asaj që kanë fituar të drejtën, kanë marrë edhe implikime buxhetore dhe ne duhet në këtë drejtim të fokusohemi që organizatat buxhetore rekomandimet t'i zbatojnë me kohë dhe të mos ndodh që pas vendimeve të gjykatës t'i zbatojnë jo vetëm vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, por të zbatojnë edhe atë pjesën materiale dhe shpenzimet të cilat krijohen mandej në gjykatë dhe shtesat të cilat i marrin për shkak të asaj që mjetet materiale nuk janë lëshuar me kohë, mirëpo janë lëshuar pas vendimit përfundimtar të gjykatave dhe kjo merr një kohë.

Dhe, çështja e tretë, unë shpresoj se do të rregullohet me ligjin që e kemi në procedurë dhe së shpejti do të jetë në Kuvendin e Kosovës, mirëpo është mirë që ndaj të gjithë zyrtarëve të lartë të shërbimit civil, duke filluar nga sekretarët e përhershëm dhe duke kaluar edhe në drejtorë të departamenteve, që janë për personel për administratë dhe personel në komunat e Kosovës, por edhe te kryeshefat ekzekutivë të agjencive të merren masa konkrete për mos ekzekutim të vendimeve. Dhe jo vetëm masat për qortim, jo vetëm masat për ta dhe për vendin e tyre të punës, por të shikohet edhe në aspektin e ndëshkimit penal. Kodi penal është shumë i saktë.

Të gjithë ata të cilët me vetëdije i shkaktojnë dëm material buxhetit të Kosovës apo i shkaktojnë implikime buxhetore buxhetit të Kosovës pa nevojë, duhet të kenë edhe përgjegjësinë penale.

Prandaj, si deputet i Parlamentit të Kosovës e përgëzoj punën që e ka bërë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, e përgëzoj sidomos për punën që ka bërë pas asaj që ka kaluar në Kuvendin e Kosovës, sepse po shihet ka arritur t'i zgjidhë pothuaj 70% të ankesave të cilat i ka pasur në dorë dhe si deputet do ta votoj raportin me dëshirën më të madhe që së shpejti ta kemi ligjin dhe në ligj është precizuar që vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës do të jenë të ekzekutueshme menjëherë pa e pritur atë fazën që duhet kaluar nëpër organet e drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj. Le të përgatitet deputeti, diskutues i parafundit, Bajram Kosumi!

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Raporti shumë qartë paraqet veprimtarinë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës. Raporti është përgatitur mirë dhe plotëson standardet duke i ofruar Kuvendit të Republikës së Kosovës të dhënat me të cilat dëshkohet se institucionet në nivelin qendror dhe në nivelin lokal, edhe pse vetë i miratojnë ligjet, nuk i respektojnë. Ky Këshill i Pavarur Mbikëqyrës është një ndër mekanizmat më të rëndësishëm në Republikën e Kosovës, sepse pasqyron dhe qet në dritë të bëmat e mira, por edhe të bëmat të cilat i dëmtojnë në përgjithësi institucionet e Kosovës dhe në veçanti shërbyesit civilë.

Formimi i Këshillit të Pavarur parashihet me nenin 102.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përbëhet prej shtatë anëtarëve me mandat pesëvjeçar – që vendimet e tij duhet të përfillen plotësisht

pa kurrfarë hezitimi. Funksionet e Këshillit janë: funksioni i shqyrtimit të ankesave; funksioni mbikëqyrës i zbatimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil të Kosovës; funksioni i vëzhgimit të zgjedhjes së nëpunësve civilë në nivelin e udhëheqësve të departamenteve.

Në raport pasqyrohet se Këshilli gjatë ushtrimit të funksionit të vetë ka konstatuar se në shërbimin civil ka një progres, por ende nuk është arritur profesionalizimi i duhur, paanshmëria, përgjegjësia, respektimi i kodit etik dhe zbatimi i procedurave ligjore dhe parimeve.

Me qëllim që Republika e Kosovës të ketë një shërbim civil efikas, të qëndrueshëm dhe profesional, të bazuar në merita dhe në Ligjin e shërbyesve civilë, Këshilli në raport pasqyron se jo çdo institucion i nëpunësit civilë rekrutohen sipas procedurave të ndershme të konkursit, avancimi nuk bëhet sipas meritës, kontratat e punës nuk lëshohen në pajtim me ligjin dhe parimet. Komisionet disiplinore dhe të ankesave nuk zbatojnë parimet, por shpesh bëhen instrument me ndikim dhe nën presionin e vendimmarrjes. Menaxherëve dhe personelit nuk i janë dhënë roli dhe përgjegjësia sipas ligjit. Nga vëzhgimet për zgjedhjen e drejtorëve të departamenteve, në raport pasqyrohet një përmirësim i dukshëm me kontributin e Këshillit, duke mos lejuar përzgjedhjen përfundimtare pa i plotësuar kushtet ligjore.

Numri i përgjithshëm i ankuesve në Këshill gjatë vitit 2009 ka qenë 288. Baza e ankimit të nëpunësve civilë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës ka qenë kontestimi i konkurseve, ndërprerja e kontratës së punës, degradimi nga pozita dhe suspendimi nga puna. Sipas pasqyrës tabelare, numri i përgjithshëm i ankesave ndaj ministrive është 81 raste, ku prinë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural. Sa i përket komunave, nga numri i përgjithshëm i ankesave prej 163 të pranura gjatë vitit 2009, prinë komuna e Gjilanit, Prishtina dhe Ferizaj.

Edhe me këtë rast, në këtë raport Këshilli në tabelën faqe 11 pasqyron se nga komunat ku janë të koncentruara komunitetet, nuk ka asnjë ankesë, që nënkupton edhe me këtë rast, në këtë fushë ligji nuk funksionon në pjesën veriore të Kosovës dhe veprimtaria e Këshillit nuk njihet nga këta qytetarë. Prandaj, kërkoj nga Qeveria që të krijohen mundësitë për shtrirjen e veprimtarisë së Këshillit në tërë territorin e Kosovës, duke e zbatuar Ligjin për shërbyesit civilë.

Numri i ankesave të përzgjedhura gjatë vitit 2009 është 358 në mënyrë retroaktive. Pra, 180 ankesa janë zgjedhur nga viti 2009 dhe 178 nga viti 2008. Raporti pasqyron të dhënat se vendimet e organit punëdhënës janë anuluar, sa ankesa janë refuzuar, sa janë hedhur poshtë.

Edhe pse vendimet e Këshillit të pavarur mbikëqyrës janë të obligueshme të zbatohen nga organet punëdhënëse, nuk janë zbatuar 57 vendime, në mesin e të cilëve prinë Gjilani, por edhe Zyra e kryeministrit nuk i ka zbatuar 6 vendime.

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli i pavarur ka hasur në vështirësi të theksuara, të cilat e kanë penguar këtë institucion për përmbushjen me përpikëri të tri funksioneve të cilat ia përcakton ligji.

Përkundër vështirësive financiare dhe mungesës së stafit profesional, ky institucion ka demonstruar përkushtim dhe vendosmëri për të qenë në nivel të përgjegjësive, prandaj e përkrah raportin me rekomandimet e komisionit funksional, me shpresë që shumë shpejt do të procedohet Ligji i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në mënyrë që Këshilli të jetë më funksional dhe në nivel të përgjegjësive të tij. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! Meqë kemi hyrë në orë të vona të punës së kësaj seance të sotme, ju kisha lutur që të jeni më të përmbledhur dhe më pak të zgjasin diskutimet, sepse edhe kemi të paraqitur të ri për diskutim. Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam parasysh që pak jemi lodhur, por jam i detyruar një fakt nga ky raport ta diskutoj këtu para jush.

Nuk ka dyshim se kjo përbërje e KPMK-së ka punuar më mirë, do të thotë, dhe e ka zgjidhur një pjesë të lëndëve jo vetëm të vitit 2009, por edhe të viteve paraprake. Por, për mua problemi është një problem që duhet ta diskutojmë diku tjetër. Nga 115 lëndë të zgjidhura, vetëm 25 janë zbatuar. 55 dihet se nuk janë zbatuar, ndërsa për 35 nuk ka fare informacion se çka po ndodh me to. Unë mendoj se ky fakt duhet të jetë i mjaftueshëm dhe Qeveria të vijë në Kuvend e ta diskutojë këtë fakt me Kuvendin, me deputetët. Ta gjejë mënyrën, ose të bëhet një debat, ose të bëhet një interpelancë me kryeministrin dhe ministrin e mjedisit, ministrin e Pushtetit dhe të Pushtetit Lokal, që të vijnë e të diskutojmë se si është e mundur që vendimet e KPMK-së, që brenda administratës është organi më i lartë vendimmarrës, vendimet e tij të mos ekzekutohen brenda administratës. Kjo është çështje brengosëse! Kjo është çështje që tregon se nuk po funksionon në brendi të vet, se shteti i Kosovës nuk funksionon si duhet. Administrata nuk funksionon si duhet. Ne kemi shpallur shtetin, por po kemi probleme serioze në krijimin e përmbajtjes së shtetit, në funksionalizimin e shtetit, në funksionalizimin e administratës së shtetit. Nuk është fjala më për gjykatat e jashtme dhe për qytetarët. Fjala është për palcën e shtetit, për administratën e shtetit. Kjo është çështje brengosëse dhe unë po e shtroj si problem dhe si kërkesë për Qeverinë, në radhë të parë për kryeministrin dhe për ministrin e Pushtetit Lokal që ta diskutojnë këtë çështje, që ta trajtojmë këtë çështje si është e mundur që vendimet e KPMK-së të mos ekzekutohen brenda vetë administratës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet deputeti i fundit i paraqitur deri tash, Ismajl Kurteshi.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të mundohem të jem shumë i shkurtër dhe shumë i saktë. Do ta bëj një hyrje të vogël në lidhje me disa diskutues këtu, të cilët edhe vetë kur kanë qenë në pushtet, kanë ndodhur këto dukuri, kanë ndodhur këto dukuri dhe nuk janë këto dukuri risi e Qeverisë aktuale. Dhe, duke u bazuar në këtë fakt, që është i pamohueshëm, unë propozoj që Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, meqë e kemi ligjin në procedurë dhe akoma nuk e ka kaluar leximin e dytë, t'i japim ingerenca të një gjykate të punës ose të një gjykate ku vendimet e këtij këshilli janë të formës së prerë dhe janë përfundimtare dhe të obligueshme për t'u zbatuar. Ne mund ta bëjmë këtë dhe nuk duhet të lejojmë si Kuvend që asnjë qeverie që do të vjen në pushtet nga vullneti i saj të varet fati i të punësuarve në administratën civile. Domethënë, ne nuk guxojmë më tutje, meqë ky fenomen, kjo dukuri është konstante, që nga viti 2000 e këndeje. Atëherë, ne si Kuvend, mendoj për t'i mbrojtur punëtorët nga arbitrariteti i eprorëve të vet dhe arbitrariteti i qeverive, duhet të shfrytëzojmë rastin, të shfrytëzojmë momentin që Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës t'i japim këto ingerenca. E para.

E dyta, që eprorët, të cilët... dhe ky është amendament tjetër që ia sugjeroj Komisionit të Administratës Publike. Eprorët të cilët konstatohet se në mënyrë arbitrare e kanë larguar punëtorin nga puna, pasi të verifikohet në gjykatë, të largohen nga puna, të trajtohet ky veprim si shkelje e rëndë në punë dhe të largohen automatikisht nga puna, kurse kompensimet që një institucion duhet t'i paguajë punëtorit për aq kohë sa ai ka qenë jashtë, do të thotë i dëmtuar, të jenë si detyrim i eprorit që t'i paguajë në buxhetin e Kosovës, domethënë për aq kohë.

Këto dy amendamente besoj se ne mund t'i aprovojmë dhe në këtë mënyrë t'i mbrojmë punëtorët, shërbyesit civilë si në administratën shtetërore, ashtu edhe private nga arbitrariteti, se arbitrariteti në Kosovë do të ekzistojë edhe një kohë të gjatë për shkak të vetëdijes së ulët të eprorëve.

Unë nuk po them për këtë qeveri ose atë qeveri, mirëpo ne duhet të tregojmë më shumë vullnet, si Kuvend, që t'i mbrojmë të drejtat e punëtorëve sepse, edhe pse nuk është në raport numri i të punësuarve në Kosovë, në administratën shtetërore, nuk është numër i madh 150 ankesa. Mirëpo, çdo punëtor mund të jetë objekt i arbitraritetit në të ardhmen. Kjo është shqetësuese. Jo numri 150, por çdo punëtor në Kosovë në të ardhmen mund të jetë objekt i arbitraritetit të eprorit të vet në punë. Kjo është e para, që desha ta theksoj.

E dyta, në kuadrin e Komisionit për Administratë Publike të krijohet një nën-komision i cili në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës vazhdimisht të na raportojë për zbatimin e Ligjit për shërbyesit civilë, si po shkon, e jo vetëm një herë në vit ne të informohemi. Unë propozoj që ne, si Kuvend, në raport me agjencionet e pavarura të jemi aleatë, në njërin anë, duke i mbështetur me aprovimin e buxhetit, që të kenë kushte sa më të mira për punë, por në të njëjtën kohë të jemi edhe vëzhgues të vëmendshëm dhe permanent në kontrollin e ligjshmërisë së veprimit dhe të zbatimit të atyre vendimeve që i marrin ato. Kaq, nuk desha të zgjas dhe besoj se ne mund të përmirësojmë ligjin shumë mirë për t'i mbrojtur punëtorët. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Mbaje në mend që këto rekomandime t'i bësh edhe kur të vjen ligji në debat. Vazhdojmë. Kemi diskutues që po paraqiten edhe tash, kur jemi lodhur mjaft. Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi, le të përgatitet deputeti Ibrahim Makolli, shef i grupit.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Unë pajtohem me vlerësimin e lartë që u dha për punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës sepse, bazuar në njohuritë që i kam, ky këshill vërtet është angazhuar që t'i kryejë punët ashtu si duhet dhe me përpikëri, por po ashtu, bazuar edhe në njohuritë e praktikave të punëve nëpër komuna dhe duke pasur parasysh se shpesh vendimet ky këshill i merr bazuar në vendimet e komisioneve komunale për ankesa dhe parashtresa, pa u lëshuar në hetime se a janë të bazuara në ligj vendimet e komisioneve të lartpërmendura komunale, e që shpesh ndodhë që komisionet komunale vendimet e tyre të mos i kenë të bazuara në ligj, por ato t'i marrin bazuar në ndikimet e ndryshme të autoriteteve ose për arsye të ndryshme, ndodh që këto vendime komunale ta vënë në lajthitje Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ndonjëherë të marrë vendime jo të drejta.

Prandaj, e kam vetëm një sugjerim për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës që në të ardhmen, para se të marrë vendime, të lëshohet edhe në ligjshmërinë e vendimeve të niveleve komunale, për të mos ndodhur që vendimet që i merr ky këshill të mos jenë të drejta dhe të pa bazuara në ligj. Shpresoj se ky sugjerim do të merret parasysh seriozisht dhe në të ardhmen nuk do të bëhen lëshime të tilla. Këtë po e them për arsye se e di, do të thotë, edhe nga praktika e Gjilanit, që u përmend si një komunë ku vërtet nuk janë respektuar ligjet, kjo ka ndodhur pikërisht jo për shkak të fajit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, por për shkak të papërgjegjësisë së lartë të komisionit komunal, i cili shumë vendime i ka marrë aspak të bazuara në ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryesues!

Po besoj se jam i fundit, sa do që njeriu nganjëherë përpiket që të mos flet, megjithatë po dua të them diçka që ka filluar të bëhet pjesë e Kuvendit, ose është mungesë e njohurive për ligjet në fuqi ose është për arsye të tjera. Ligji aktual që rregullon funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës i

precizon qartazi detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e këtij këshilli dhe, po ashtu, ndër të tjera në ligj që është aktual, në fuqi, thuhet që vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës janë vendime të obligueshme për autoritetet e tjera, çka nënkupton se me ligj vendimet e KPMK-së janë të pakthyeshme, ndërkaq në praktikë ndodhë krejt diçka tjetër.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës e ka njoftuar Kuvendin e Kosovës përmes kryetarit të Kuvendit për secilin rast, secilin vendim i cili nuk është zbatuar nga autoritetet e tjera, por që, për fat të keq, edhe fuqia e Kuvendit ka qenë shumë e vogël në këtë drejtim.

Nëse ju kujtohet, para disa javëve pikërisht këtu kemi debatuar përkitazi me moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës e që nga shumë prej nesh është shtruar edhe një pikëpyetje e madhe se nëse kësaj vazhdojnë të mos zbatohen vendimet e këtyre autoriteteve, atëherë shtrohet pyetja se a do të duhej të ekzistojnë institucione të tilla, vendimet e të cilave nuk zbatohen në praktikë, ndërkaq është një mashtim shumë i madh për ata të cilët pretendojnë që përmes këtyre mekanizmave t'i realizojnë të drejtat e veta.

Ligji që aktualisht është në punim e sipër, do të duhej të shikojë edhe një mekanizëm sanksionues për autoritetet të cilat nuk i zbatojnë vendimet e këtij organi shumë të rëndësishëm brenda shërbimit civil të Kosovës. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Meqë janë absolvuar diskutuesit e paraqitur, kalojmë në votimin e Raportit të punës të Këshillit të pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009.

Në sallë janë prezentë 62 deputetë, që do të thotë se kemi kuorum për votim. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

A ka votues pa kartela, “për”? 1. Faleminderit!

Konstatohet se me 53 vota “për”, 5 “abstenime” dhe 2 vota “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin e Punës të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2009.

Vazhdojmë me pikën e fundit të agjendës së sotme të punës:

10. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar kërkesën për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Kuvendit i ka rekomanduar, për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e komisionit funksional, meqë kryetarin nuk po e shoh se është prezent, që ta arsyetojë raportin me rekomandimet. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Për ta përshpejtuar pak procedurën, Komisioni për Buxhet dhe Financa, pa kundërshtim nga të gjithë anëtarët që janë pjesëmarrës, e ka përkrahur dhe rekomandon që të bëhet harmonizimi i pagave nga ky Bord për Hekurudha. Kuptohet, nuk i cenon parimet buxhetore dhe është brenda përbrenda buxhetit aktual dhe mendoj se duhet t'i japim përkrahje, në parim. Mbetet një brengë që harmonizimi i pagave të jetë në nivelin e përgjithshëm për të gjitha institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit. Me këtë

çështje do të merret Komisioni për Buxhet dhe Financa, i përkrahur sigurisht edhe nga administrata e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të grupeve parlamentare nuk kemi të paraqitur, përveç deputetit Haki Shatri, në emër të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të cilit mund t'ia japim fjalën. E keni fjalën, zoti deputet!

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, për shkak të parimit, nuk e mbështet këtë propozim, jo pse në këto shifra kemi ndonjë vërejtje “për” ose “kundër”, por na jemi për atë që në Kuvend mos të votohen pagat as të nëpunësve civilë, siç kemi këtu, as të bordeve. Kemi kërkuar gjithmonë që edhe çështja e funksionimit të bordeve edhe të pagave të personave të zgjedhur dhe të funksionarëve të zgjidhet me ligj dhe në bazë të saj me automatizëm të vendosen pagat.

Kemi këtu një praktikë jo shumë të pranueshme, ku pagat propozohen me këtë metodë të punës, propozohen në bazë të simpatisë. Një bordi i vjen paga 980 euro, një bordi tjetër që e kemi “më simpatik” i barazohet paga me deputetin dhe kemi, do të thotë, një mosharmoni dhe për shkak të principit të kësaj metode të punës jemi kundër. Pra, jo për shkak të këtyre njerëzve e as të këtyre shifrave që janë propozuar konkretisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

Deputetë të respektuar,

Grupi Kuvendor i AKR-së gjykon se është nevojë imediate që Qeveria të përgatisë një Projektligj për pagat ose për sistemin e pagave, ose mund të emërtohet edhe ndryshe, për kriteret e objektivizuar të pagave të bordistëve, në përgjithësi, dhe të bëhet një harmonizim i ligjshëm. Kjo është nevojë shumë e justifikuar, sepse ka borde ku, po e zëmë, për dy seanca i merr 3.000 euro në muaj, ju lutem! Dhe, shumë gazetarë të pa informuar, që në këtë rast i gjykoj se do të duhej të merreshin edhe me hulumtime, nuk dinë tjetër gjë pos ta atakojnë figurën e deputetit që e ka legjitimitetin e votuesit, një. Dhe, dy, krahasuar me deputetët jo në Evropë, por në shtetet përreth paguhet dy herë më pak. Do të thotë, kjo çështje... dhe theksimet e zotërinjve Zemaj dhe Shatri konsiderojmë se janë me vend. Prandaj, do të duhej në këtë drejtim të miratohet një konkluzion obligativ për ekzekutivin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk e përkrah këtë çështje, me arsyetimin se Kuvendi nuk përcakton paga. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti, dy janë: Xhezair Murati dhe Sadik Idriz. Atëherë, fjalën e ka deputeti Sadik Idriz!

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući! Mi nećemo glasati za ovaj predlog iz razloga što ne samo u ovom bordu, nego ni u jednom bordu nemamo svog čoveka. Znači, ne samo iz naše partije, nego i iz zajednice nemamo. Mislim to nije ušlo u zakon kada je Zakon o javnim preduzećima usvojen iz paketa

Ahtisarijevog, i tamo nije bila predviđena nikakva mera da se u te bordove uključe pripadnici zajednica i nismo u stanju da uguramo jednog čoveka u jedan bord, a ima ih toliko i ima ih u svim javnim preduzećima i van javnih preduzeća i kako da glasamo kad nemamo nijednog svog čoveka i ne samo našeg, verovatno nema ni iz jedne druge zajednice, osim većinske. Nikad nećemo glasati za ovakve stvari! Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit për integritet, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush!

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč!

Ja se javljam u ime Grupe a u svoje ime kažem da je ova tačka ostavljena namerno na kraju da, kada smo umorni, nemamo dobru koncentraciju, ne možemo da razmišljamo i da je jako lako da prođe.

Međutim, kod ove tačke, kada je u pitanju..., moramo malo više da obratimo pažnju. Prvo, podržavam u potpunosti kolegu koji je prethodno komentarisao. Znači, ne zastupanje nijednog člana iz zajednica, srpske i ostalih zajednica, mora više da se poštuje Zakon o zajednicama. Ne može da se krši.

Drugo, što imam primedbu. Jako važno je da pogledate, imamo tabelu budžeta Kosova za 2010. godinu, kada su autoriteti kao što su agencije, komisije, departmani i ostalo. Imamo 55 autoriteta, 14.000, 34.887 zaposlenih radnika. Ovo ja čitam iz tabele. Od toga, 14 miliona i 373... troši se na plate. Kada ovo pomnožite, podelite sa radnicima, to je 4.324 evra bruto dohodak po radniku. Kada je bruto dohodak, imali smo u prethodnom Zakonu o osiguravanju finansijskih autoriteta 1.000 i nešto puta 2. Nije ni 2.000. Znači, gde se prozivamo mi, a na listi smo prvo mi poslanici za ovo kršenje kada su u pitanju nivelizacija, sistematizacija i određivanje plata. Moramo više ovde, mi kao Skupština da vršimo pritisak na Vladu, da se izradi Zakon o zapošljavanju, Zakon o platama, o nivou, o razredu i da ne može neko ovde da dobija evropsku platu, a neko bolivijsku. Moramo da imamo jedan red, da se plate mimo ostalih država evropskih, ako ne može neko da ima standard u društvenom preduzeću ili polu kapitalizovanom, niti u agenciji da ima ako je to na skupštinskom, na centralnom nivou, gde ćemo moći, ja slobodno ću danas da kažem da počnemo ribu da čistimo ne od repa, nego od glave. Nemamo više vremena da je čistimo od repa! Ako hoćemo da uđemo u neki sistem, gde ćemo imati disciplinovane plate, gde ćemo imati kontrolu nad javnim novcem, gde se najviše troši na ime plata.... Ja neću iz ove tabele da čitam dalje, gde je autoritet isto za ove železnice uključen ovde. Evo vidite, ovaj autoritet je uključen isto „hekurudhore“ pod kodom 374 sa troškovima od 58.092. Znači, on je u ukupnom ovom zbiru, mi moramo više da analiziramo stvari, da čitamo, da vidimo šta nam se servira i da budemo mnogo ozbiljni i da ove stvari radimo na tome da suzbijamo i sprečavamo i da dajemo poruku Vladi da mora da radi, a posebno ljudi koji rade u funkcionalnim komisijama mogu da kažem da nisu u opšte aktivni. Meni je žao što ovo kažem za svoje kolege. Toliko od naše grupe, mi nećemo ovo da podržimo. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë te deputetët e paraqitur për diskutim. Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli, le të përgatitet deputeti Naim Rustemi.

BUJAR DUGOLLI: Edhe unë u provokova nga ky material dhe nga disa diskutime. Konsideroj që nuk duhet në këtë formë Kuvendi një nga një të përcaktojë pagat qoftë anëtarëve të bordeve apo të personelit tjetër ekzekutiv të këtyre autoriteteve apo ndërmarrjeve. Duhet të jetë një rregullim i përgjithshëm për këtë çështje. Duhet ta dimë se anëtarët e bordit nuk janë në marrëdhënie të rregullt të punës as në këta rregullatorë, as në ndërmarrje publike dhe kryejnë shërbime profesionale konform ligjit dhe për këtë punë që e bëjnë, ata duhet të kompensohen, por jo të jetë një kompensim i tillë që do të thotë se kryesuesi i bordit merr pagë sa një profesor i rregullt i universitetit publik apo anëtarët e bordeve apo të jetë kaq dallim i madh thuaja gati 100% me kryeshefin ekzekutiv, i cili nga aspekti i

punës profesionale që e bën, qoftë në autoritet, në këtë rast, apo në ndërmarrje të caktuara publike, thuaja barra kryesore e punës i bie mbi ta, mbi atë administratë, mbi ekzekutivin. Thjeshtë, është një dallim i madh dhe për mendimin tim është që Kuvendi nuk duhet t'i pranojë këto rekomandime në këtë formë, por t'i rikthejë dhe të bëjë një përmbledhje gjenerale për të gjitha bordet e ndërmarrjeve apo të autoriteteve rregullative dhe të ketë hierarki në Kosovë sa i përket çështjes së pagave dhe të kompensimeve nga niveli qendror, nga Presidenca, mandej Kuvendi, ekzekutivi, ndërmarrjet publike e kështu me radhë dhe të mos ketë dallime, siç u paraqitën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, le të përgatitet deputetja e paraqitur e fundit, e tash erdhi edhe një, Safete Hadërgjonaj.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit kryesues!

Po më vjen mirë që shumica e diskutuesve ishin në të njëjtat valë, në të njëjtën gjatësi valore, të gjithë e kritikuan në një formë apo në formën tjetër mënyrën se si është ardhur dhe proceduar ky rekomandim deri në Kuvend.

Është shumë e pakuptimtë, për shembull, nëse e këqyrim këtë detyrë dhe përgjegjësi – pjesëmarrjen në takimin e bordit, kurse bordi me pagesa marramendëse ndoshta i bie me qindra euro për një takim, deri në 1.200 euro, apo 1.280 euro për kryesuesin e bordit.

Unë kisha pasur dëshirë që edhe pas këtyre diskutimeve, nëse vjen deri te votimi, diskutuesit mos të ndërrojnë mendjen e vet dhe ta mbajnë qëndrimin që e patën konstruktiv gjatë diskutimeve dhe të kërkojnë në mënyrë të prerë nga Kryesia e Kuvendit, veçanërisht nga kryetari i Kuvendit që të procedojë me kërkesën për themelimin apo për krijimin e një sistemi, sistemi të pagesave posaçërisht për autoritetet rregullatore.

E di që vende – vende me ligj janë të përcaktuara, mirëpo saktë nuk e kemi lartësinë e pagesave të rregullatorëve të ndryshëm, por që duhet të kemi një unifikim apo varësisht nga rëndësia e rregullatorit, të ketë një hierarki në pagesë.

Edhe në rastet e bordeve të ndërmarrjeve publike ne kemi pasur disa vendime të Qeverisë, me të cilat kanë qenë të klasifikuara tri klasë pagesash të anëtarëve të bordeve, por ne tash edhe u mësua tjetër të themi, tjetër të veprojmë. Dhe edhe pse lartësia është përcaktuar, ata megjithatë vazhdojnë që të shfrytëzojnë edhe resurse tjera – anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike, por edhe lartësinë e pagesave ta bëjnë përkundër vendimeve që i ka marrë vetë Qeveria e Kosovës.

Këtë po e cek me të vetmin qëllim se edhe ky bord – rregullator, që në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi e ka vetëm një pjesëmarrje në takime të bordit, me fjalë të tjera nuk e ka detyra ose përgjegjësi shumë më të zhvilluara se ndonjë rregullator tjetër, lartësia është shumë – shumë më e madhe dhe nuk e di kujt i ka rënë ndërmend që ta bie e ta sjell një rekomandim të tillë në Kuvend dhe ne të votojmë diçka për lartësi të pagave. Ne krijojmë politika këtu në Kuvend, nuk flasim për detale veç e veç. Unë do të jam kundër kësaj dhe kërkoj që të votohet për të kërkuar një sistem të pagesave.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj. Deputeti i fundit, Armend Zemaj, i cili foli një herë, por ka diçka për të shtuar.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk e pash të arsyeshme dhe ne si Grup Parlamentar nuk e pamë të arsyeshme që të bëjmë çështje debati këtë çështje. Është një rekomandim krejt në vija normale. Është mirë që, bile na ka ardhur një kërkesë që ta miratojmë, sepse në të kaluarën janë shkuar miratimi i vendimeve të tilla për paga të

autoriteteve rregullative, të cilat i kanë dhënë, i raportojnë, zgjidhen nga Kuvendi dhe i raportojnë Kuvendit, janë miratuar në mënyrë paushall nga Qeveria në të kaluarën dhe e kemi të freskët atë vendimin që e kanë pas marrë për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, ku janë caktuar pagat pa e ditur Kuvendi se çka po bëhet fare. Megjithatë, këtu po futet diçka në sistem. Këto autoritete rregullative dhe borde të cilat i udhëheqin këto autoritete rregullative, të cilat zgjidhen nga Kuvendi dhe i japin llogari Kuvendit, duhet dalluar nga ato borde të ndërmarrjeve publike të cilat menaxhohen nga Qeveria dhe vendos Qeveria edhe për pagat e tyre dhe për buxhetin e tyre.

Të gjitha autoritetet rregullative të cilat zgjedhen nga Kuvendi dhe i raportojnë Kuvendit, buxhetin e këtyre autoriteteve e miraton vetë Kuvendi. Komisioni për Buxhet dhe Financa merret me buxhetin e këtyre dhe ia propozon direkt Kuvendit, për miratim. Edhe këtu Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar këtë kërkesë të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe njëkohësisht edhe pagat, sepse buxheti është i ndarë, nuk ka kurrfarë shtese në buxhet, domethënë që është i planifikuar, mirëpo Kuvendi duhet të zyrtarizojë pagat e këtyre meqenëse zgjidhen nga Kuvendi dhe njëkohësisht i japin llogari Kuvendit.

Sa i përket ligjit, është mirë që ligji të hartohet, të miratohet në Kuvend dhe vërtet të zgjidhet njëherë e përgjithmonë problematika e rregullatorëve, të cilët i japin përgjegjësi Kuvendit dhe zgjedhen nga Kuvendi, mirëpo ne me këtë rast nuk mund ta akuzojmë askënd, sepse edhe ne si deputetë, edhe komisionet parlamentare mund të hartojnë ligje, prandaj edhe ne mund ta bëjmë një punë të tillë, mirëpo ka obligim ndoshta edhe Qeveria të jetë më aktive në këtë drejtim. Është mirë që problemi i pagave të tyre të zgjidhet me ligj, mirëpo ky vendim, ky rekomandim i Komisionit për Buxhet është rekomandim i drejtë dhe unë i ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë këtë rekomandim. Pagat të cilat janë caktuar këtu, janë të harmonizuara me të gjitha pozitat me pagat e autoriteteve rregullative të cilat funksionojnë në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti kryesues,

Unë mendoj, tash në fund, mendoj se kjo çështje duhet të kthehet mbrapa dhe të mos miratohet nga ana e Kuvendit, sepse unë tashmë kam një pyetje për Komisionin për Buxhet dhe Financa: se në bazë të çfarë kritereve është mbështetur kur e ka caktuar këtë lartësi të pagave të anëtarëve të Bordit të Hekurudhave? Kësisoj, në këtë vendin tonë është punë më e leverdishme të jesh anëtar i bordeve të pavarura, se sa president i vendit.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së kësaj radhe po kërkoj që kjo çështje të kthehet dhe të shihen format se si të rregullohen me ligj pagat e anëtarëve të bordeve drejtuese. Është shumë e pa drejtë që anëtarët e bordeve për një ose dy mbledhje gjatë muajit të marrin me mijëra euro, ndërkaq në sektorët e tjerë të kemi këtë gjendje çfarë e kemi. Thjeshtë, ai që tash e jep përgjigjen në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, të na sqarojë se në bazë të çfarë kritereve është caktuar ky nivel i pagës këtu edhe pse ne, sikur u tha më herët, nuk kemi asgjë kundër anëtarëve të bordit, sepse këtu i kemi miratuar, por thjeshtë kjo gjendje nuk mund të tolerohet më në këto borde. Kemi borde që dallojnë pagat e anëtarëve të bordeve, ndërkaq kësaj radhe unë besoj se nuk do të duhej të lejohej që të kalojë diçka e tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Tash është paraqitur edhe deputeti Zemaj. Unë veç po dua të sqaroj diçka, që në fillim, në emër të komisionit deputeti Zemaj tha që ky propozim është unanimisht i mbështetur nga komisioni...

(Ndërhyrje)

Po, mirë. E kuptoj! Tash kemi edhe një propozim të shefit të Grupit të AKR-së për ta shtyrë këtë, mirëpo paraprakisht dua t'ju njoftoj që asnjërin propozim nuk mund ta hedhim në votim, sepse nuk kemi kuorum. Aktualisht, janë 58 deputetë në sallë, apo 56 në fakt, sepse edhe 2 e lëshuan tash, dhe kjo na bën që votimin për këtë pikë ta shtyjme për një seancë të radhës. Faleminderit juve që qëndruat deri në fund!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve